

Kuvendi

Qarku Vlorë

Arbjan Mazniku:

Të nderuar anëtarë të komisionit, të nderuar kryetarë të Bashkive të Qarkut të Vlorës, së pari për nderuar prezencën, ju urojmë ndjesë për vonesën, po duket se takimi i parë zgjati pak më shumë. Jemi në pjesën e dytë të dëgjimeve të Qarkut të Vlorës. Kemi prezent 5 kryetarë bashkish, nuk kemi prezent kryetarin e Bashkisë së Finiqit dhe kryetarin e Bashkisë së Vlorës, kanë kërkuar për pamundësi agjenda të jenë prezent. Siç kemi rënë dakord paraprakisht, do t'i japim të gjithë kryetarëve që nuk janë prezent mundësinë që të jenë në një takim tjetër, për t'u dëgjuar në një moment të dytë kur mbledhim në mënyrë specifike ato kryetarë që s'kanë pasur mundësi të vijnë të jenë prezent në dëgjime. Dy-tre fjalë të shkurtra për kryetarët që janë prezent, megjithëse besoj se janë të njohur me procedurën, pasi kjo është sot që bëjmë dëgjimin e 11-të. Fokusi i dëgjimit tonë është për reformën e administrative territoriale, me fokus të posaçëm në ato tema të cilat janë tre kolonat kryesore të reformës. Së pari, për kompetencat. Ne jemi të interesuar të dëgjojmë nga ju çfarë ka funksionuar dhe çfarë jo në raport me kompetencat dhe funksionet që bashkitë kanë, mundësia për t'i zbatuar ato si nga kuadri rregullator, ashtu edhe nga kuadri financiar, ashtu edhe nga burimet njerëzore. Kolona e dytë lidhet me financat, me mundësitë financiare që bashkitë kanë, qofshin këto nga targat e veta, qofshin këto nga granti dhe mekanizmat financiarë që bashkitë kanë për të pasur mundësi për t'i zbatuar këto financime dhe këto investime në territor. Dhe kolona e tretë lidhet në mënyrë sistematike me territorin dhe qeverisjen e tij, dhe ndërlidhjen e tij si me funksionin dhe me kompetencat, të nisur nga qëllimi kryesor për t'i ofruar shërbime efikente qytetarëve në territorin tonë. Nga ana procedurale, kam dy elementë të rëndësishëm për t'i përmendur. Së pari, ky nuk është një komision hetimor, pra kryetarët e bashkive janë ftuar këtu si palë të interesuar për të dhënë mendimin dhe opinionin e tyre, si e mendojnë ata. Kjo nuk është një moment që kërkohet llogari për mënyrën si funksionon bashkia. Kryetarët janë zgjedhur nga drejtoret e qytetarëve dhe i japin llogari para qytetarëve të tyre. Ky është një mekanizëm bashkëpunimi, ndërveprimi, komunikimi ndërsjellë, për të kuptuar si mund të bëjmë më mirë elemente rregullatore, ligjore, për t'i dhënë mundësi kryetarëve që të funksionojnë në mënyrë më optimale. Nga ana procedurale, kryetarët e deputetëve, anëtarët e komisionit, bëjnë pyetje për një ose për disa nga kryetarët, dhe më pas kryetarët përgjigjen. Kërkesa jonë sistematike është që edhe deputetët dhe kryetarët, me sa është e mundur, të jenë koncizë në përgjigjen e tyre, në mënyrë që brenda kohës që kemi, rreth dy orë, të sigurojmë maksimumin e mundshëm të komunikimit dhe maksimumin e mundshëm të informacionit. Së fundmi, për informacion të cilit ju mund të mos dispononi sot, që ka elementë specifike apo të dhëna specifike, ne në zbardhje, pyetjet që kanë ngelur pa përgjigje, do t'ia çojmë gjithashtu në mënyrë shkresore, që të kemi mundësi që të marrim përgjigje më pas dhe t'i administrojmë nga komisioni në një moment të dytë, kur nuk ka një përgjigje të numrat mund të mos jenë të qartë sot, apo përgjigja mund të mos jetë e plotë sot. Këto janë pak a shumë nga ana procedurale, dhe unë mendoj që jemi

shumë të interesuar të gjithë të dëgjojmë opinionin tuaj për mënyrën se si mund të sistemojmë gjërat për t'i ofruar shërbime të mira qytetarëve. Faleminderit shumë.

Luçiano Boçi:

Dhe unë dua të përshëndes anëtarët e komisionit dhe kryetarët e bashkive që janë prezentë në Qarkun e Vlorës. Për ato që nuk janë prezentë, jo do t'u japim një mundësi, nuk jam dakord me shprehjen kaq butë, duhet të vijnë patjetër para këtij komisioni. Nuk është hetimor, vërtetë është dëgjimor, por kryetarët e bashkive e kanë për detyrë, sepse bëhet fjalë për një reformë që prek drejtpërdrejt punën e tyre dhe përfaqësimin e tyre. Çdo shmangie është krejtësisht e papranueshme nga komisioni, sepse ajo që vërej unë është që kryetarët e bashkive të mëdha kanë shmangur pothuajse në unison dëgjimin, e kam fjalën këtu për Elbasanin, për Shkodrën, i shtohet edhe Vlora, dhe ky lloj fenomeni duket që përputhet me një lloj dëshire të tyre për të mos qenë prezentë dhe për të mos bërë këtë dëgjim që ndoshta e kanë keqkuptuar si kërkesë llogarie. Është dëgjim që kryetarët e bashkive paraqesin para nesh kërkesat e tyre në raport me ushtrimin e detyrës së tyre. Kemi dëgjuar në dëgjimet publike dhe qytetarët dhe pjesën e administratës suaj, nuk besoj se mjafton. Është munduar të ruhet një me një, nuk është barazim në fakt, është luajtur si lojë barazuese, pavarësisht se s'është e tillë, dhe patjetër në opinione zoti Tavo, që qytetarët paraqesin shqetësime të tjera, e paraqesin realitetin ose të vërtetën ndryshe, ndryshe e paraqesin administratorët, dhe në këtë lloj përplasje ne kemi gjykuar që është shumë e domosdoshme të dëgjojmë ata që kanë marrë përsipër mbi shtëpinë funksionimin e pushtetit lokal, që jeni ju, sepse është edhe vullneti politik, por është edhe vullneti juaj personal. Në këtë dëgjim duhet të jemi shumë të qartë që ne nuk kemi si qëllim që të shohim se çka ndodhur para 2014-tës dhe të na paraqisni ato deklaratat vetëlavdëruese se ç'është bërë që s'do bëhesh para 500 vitesh, para 50 vitesh, para 100 vitesh. Jemi ngopur me këto që në rini të hershme dhe mendoj që t'i shmangim këto klishe të komunikimit tonë këtu në këtë komision dhe të dalim në zemër të problemit. Jemi në reformë, dhe kur themi që jemi në reformë do të thotë që ka një problem, ka një problem shumë të madh që lidhet me funksionimin e pushtetit lokal, që duhet të ndryshojë në themelin e tij, duhet të ndryshojë sigurisht në funksionalitet, që nuk përputhet me kompetencat dhe nuk ka edhe një përputhje me anën financiare, me mekanizmin financiar, sikurse nuk ka shërbime të formës, të natyrës, të cilësisë që sot i kërkon qytetari, sikurse nuk ka përfaqësim të shumë zonave të cilat janë lënë në arresë në shumë drejtime dhe për të cilat ka një reagim. Reagimi është popullimi, i cili dhe mohohet në shumë raste dhe devijohet në shkak dhe nuk pranohet pastaj edhe si pasojë. Por në fakt është një reagim real, konkret, i prekshëm, sepse zonat e juaja e vuajnë shumë dhe Shqipëria e vuan shumë. Dhe një nga arsytet, një nga arsytet themelore dhe kryesore është patjetër mënyra se si lidhet qytetari me pushtetin lokal, me shtetin, me pushtetin, përderisa në përkufizime themi që reforma territoriale është arkitektura e shtetit në territor, është mënyra si qytetari shërbehet, përfaqësohet, si ushtrohet demokracia lokale dhe elemente të tjera. Prandaj unë do të doja që të gjithë ju të paraqisni të gjitha kërkesat që mendoni se lehtësojnë punën tuaj në funksionin që keni. Për të dalë pastaj tek territori. Kur flasim për territorin, sigurisht nuk flasim thjesht për hartën, territori duhet të jetë funksional. Sa arriti 2024-ta ta bëjë funksional, domethënë këtë e tregojnë, e kanë treguar dhe do e

tregojnë dhe dëgjimet e tjera në vazhdim. Për mendimin tonë nuk është kaq funksional dhe patjetër që gjithsecili prej jush është i lutur që të shprehë këtu qëndrimin e tij, që bashkitë e vogla mund të performojnë, mund të ofrojnë shërbime, apo duhet të shkrihen, thotë maxhoranca, ndërkohë që ne si parti demokratike, si opozitë, jemi për variantin tjetër që jo vetëm duhet të qëndrojnë, por ne duhet të shohim mirë brenda bashkive tash të quajtura të mëdha sipas konceptit të 2014-s, nëse ka mundësi që dhe aty të rrisim numrin e bashkive për të plotësuar ato elemente themelore që lehtësojnë punën e funksionimit të pushtetit lokal dhe e bëjnë atë performante dhe që në fund fare e përputhin me qëllimin që ka ai, që është shërbimi ndaj qytetarit. Dhe e di që ka vështirësi në këtë drejtim, kam marrë opinione dhe kërkesa nga Konispoli, kemi dhe një kërkesë si komision për të realizuar dëgjime në Konispol, është shumë e mirë, sikurse pres dhe jam besimplot që edhe kryetarë të tjerë të bashkive tash të quajtura të vogla, që nuk janë kaq të vogla, dhe ato mund të paraqesin kërkesën e tyre pa fshehur dhe qëndrimin në raport me territorin e tyre. Dhe kjo gjë është shumë kryesore dhe shumë themelore. Presim me padurim t'ju dëgjojmë. Fjalën po e kërkon me insistim zonja Zhupa.

Iva Zhupa:

Faleminderit kryetar. Në fakt e kërkoja për procedurë. Qendra lexo pjesëmarrjen. E di, e keni problem të vërtetën, po s'kam ç'skam çfarë t'ju them. E kam qartësisht procedurën dhe jam anëtare e këtij komisioni. Pi një kafe, një çaj dhe qetësohu. Në lidhje me dëgjimin që kemi me kryetarët e bashkisë së Qarkut të Vlorës, gjithë e dimë që qendra e Qarkut dhe bashkia më e rëndësishme e Qarkut është Vlora. Për mua është e papranueshme se si kryetare e bashkisë së Vlorës nuk dënon të paraqitet në ditën e lajmëruar në komisionin parlamentar. Unë e kam parë zonjën Mersini që nuk dënon t'i takojë tregtarët e Vlorës, e kam parë që nuk dënon t'i takojë operatorët turistikë në Vlorë, e kam parë që i bëjnë protestë qytetarët dhe nuk i takon, por këtu që është një detyrim për të ardhur dhe për t'u paraqitur në komision për të folur për reformën territoriale, përsëri fshihet. Sigurisht, frika ka qenë e madhe, sepse sjellja që bëjnë me qytetarët edhe pak ditë më parë, duke i marrë qytetarët në sytë të policisë bashkiake dhe të shtetit, duke i rrëmbyer nga banditë me uniforma të zeza, patjetër që zonja ka pasur frikë që të vinte dhe të pyeste këtu edhe për atë situatë atje. Zonja ka pasur frikë që të vinte dhe t'i jepte llogari komisionit se si përdoren taksat e qytetarëve të Vlorës, se si ndahet buxheti i Vlorës, ku vetëm lajmi i fundit ishte dy dronë ishin 74 milionë lekë në bashkinë e Vlorës dhe çfarë bën zgjedh të mos vijë me idenë që duke e shmangur do të harrohet bashkia më e rëndësishme e Qarkut. Unë uroj që të dy bashkëkryetarët ta vendosin me detyrim që të mos mbyllën dëgjimet me kryetarët e bashkive pa dëgjuar të gjithë këta që zgjedhin të kenë një punë tjetër ditën që janë thirrur nga komisioni parlamentar. Aq më tepër kur nuk është një bashki e vogël, një bashki e cila kuptohet edhe nga materialet e tjera, qëndrimet edhe paratë publike, por është një bashki qëndërqarku siç është bashkia e Vlorës. Zonja e ka shmangur përgjegjësinë në të gjitha drejtimet dhe sot po e shmang përgjegjësinë në komisionin parlamentar. Kështu që sidomos zoti Mazniku, kërkoj nga ju që të vendosni një datë tjetër për zonjën Mersini dhe të vijë të paraqitet në komisionin parlamentar për reformën territoriale, që të kuptojmë dhe ne si funksionon ajo bashki, si iu përgjigjet territorit vetë, si i përdor taksat e qytetarëve dhe cilat janë planet e tyre për zhvillimin e Vlorës. Po të vij më shpejt këtu para se të shkoj

te SPAK-u, se e di që do ketë punë te SPAK-u, po të vij njëherë këtu edhe pastaj të shkoj te SPAK-u.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Zonja Zonja Zhupa, së pari ju falenderoj për fjalën. Unë jam dakord dhe e kam shprehur këtë gjë në disa takime, që kishte qenë e udhës që të gjithë kryetarët që për arsye të caktuara s'kanë dalë të vijnë, t'i japim një mundësi tjetër për të qenë prezentë dhe të vijnë të thonë mendimin e tyre. Por teksa them këtë, është shumë e rëndësishme t'ju shpjegoj qartësisht dy gjëra. Që i thashë fjalën time të hapjes, po edhe ngaqë megjithëse jeni anëtarë i komisionit, nuk keni qenë prezentë shpesh. Ky është një komision dëgjimor, nuk është një komision hetimor. Ky komision nuk e ka tagrin të thërrasë me zor dhe të paraqiten, të detyrohen kryetarë të bashkive. Kryetarët e bashkive të Republikës së Shqipërisë janë pushtet autonom, ju keni folur rregullisht për autonominë vendore dhe fuqinë e kryetarëve të bashkive, të cilët janë të zgjedhur nga qytetarët e këtij vendi. Kryetarët e bashkive në fjalë, fjala që bie, qëllon që kanë marrë vota në emrin e tyre më shumë se shumë deputetë këtu ke emrin e tyre specifikisht, sesa shumë deputetë në sallë, edhe në qarkun respektiv. Patjetër, patjetër. Patjetër, patjetër. Edhe unë i votuar jam. E pra, patjetër, patjetër. Aritmetikë, por janë, por kjo thotë, tregon një element, tregon elementin e autonomisë vendore dhe si element thelbësor i autonomisë vendore, ne kemi detyrë t'i ftojme kryetarët e bashkive të vijnë. Kryetarët e bashkive kanë një oportunitet. I ftojme. Të lutem, them. Po them, ne sërish i ftojme në dëgjim. Njerëzit ftohen, i jepet një oportunitet.

Iva Zhupa:

Ne i thërrasim. Edhe ku vendi ka drejtë t'i thërrasë, edhe në komision.

Arbjan Mazniku:

Jo, jo, të lutem, o zonja Zhupa, të lutem, zonja Zhupa, së pari njëherë, së pari njëherë, për çështje etike komunikimi, unë ju dëgjova nga fillimi në fund dhe nuk ju ndërpreva. Kërkoj. Po dakord, po unë s'e bëra, kështu që si kryetar dhe mu drejtuat, po ju them. E them dhe njëherë fjalën: i ftojme në dëgjim. Në dëgjim. Në dëgjim, njerëzit ftohen. Tani, unë po vazhdoj të them një gjë, ti mund të thuash çfarë të duash, unë po të them: komisioni, komisioni fton njerëz të vijnë në dëgjim, se është dëgjim. Është një oportunitet, një mundësi për palët e interesit, grupe të interesuara, deputetët, kryetarët, më fal, kryetarët e bashkive do të thërrasin, që ftuam qytetarët në një dëgjim që bëme atje. Ftojme njerëzit të vijnë të japin mendimin e tyre. Njerëzit që s'duan të japin mendimin e tyre, humbasin mundësinë për t'u dëgjuar. Por dhe më pas komisioni e ka të gjithë drejtën ta bëjë si mendon vetë. Por ky qartësisht nuk është një komision hetimor. Kjo logjika për të ardhur këtu dhe për t'i kërkuar llogari kryetarëve që kanë ardhur, është logjikë e gabuar dhe nuk na çon në tentativën e objektivit që kemi si komision, për të kuptuar gjërat që shkojnë mirë ose s'shkojnë mirë, për të pasur mundësi për t'i zgjidhur, jo për t'i bërë gjyqin kryetarëve të bashkive. Kryetarët e bashkive gjyqin ia bëjnë qytetarët, të jenë katër vjet, t'i votojnë dhe i kanë votuar dhe do i votojnë prapë pas pak kohe për pjesën e realizimit

të detyrave, objektivave, angazhimeve që kanë marrë, mënyrën se menaxhojnë buxhetin. Ia bëjnë gjyqin. Nga njëra anë, qytetarët janë katër vjet. Nëse bëjnë gabime, ia bëjnë institucioneve të tjera që kanë përgjegjësi këtë punë. Parlamenti ka detyrë të rregullojë kuadrin rregullator për t'ia bërë punën më të thjeshtë ose më të mirë. Dhe le t'i rrimë detyrës tonë, mos të bëjmë as prokurorinë, as hetuesinë këtu, sepse është detyrë dhe krijojmë dhe një marrëdhënie jo të qëndrueshme, veçanërisht kur jo rrallëherë kam dëgjuar nga kjo anë mbrojtjen e madhe të autonomisë vendore. Pjesë thelbësore e autonomisë vendore është respekti, është respekti ndaj të zgjedhurve.

Luçiano Boçi:

Atëherë, një opinion timin. Po, patjetër, autonomia vendore është shumë mirë e qartë e përcaktuar dhe në Kushtetutë dhe në atë çka ne kërkojmë ndaj funksionimit të pushtetit vendor, por mos ngatërrojmë autonominë e pushtetit vendor me autonominë e kryetarit të bashkisë. S'ka autonomi të kryetarit të bashkisë në konceptin e thjeshtë të autonomisë vendore. Dhe fakti që ne i thërrasim, nuk është i ftojme, i thërrasim. Parlamenti thërret, e ka në rregulloren e tij. Thërret përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave, përfaqësuesit e institucioneve të pavarura, se janë të pavarura ato. Dhe sigurisht që thërret dhe kryetarët e bashkive, dhe kur bëhet fjalë për një reformë që prek drejtpërdrejt, e kanë detyrë absolute funksionimi i tyre të vijnë para këtij komisioni. Dhe patjetër, dhe unë nuk, shumë mirë që jeni kaq të prekur për autonominë, unë jam shumë i prekur. Unë, kur kryeministri i ka thënë atyre: "Ndërroni drejtorët", jam çuar nga karrigia. Edhe besoj edhe ju, rrezik ju keni kapur tavanin me kokë nga reagimi i fortë, se ju shoh sot që e mbron shumë autonominë e kryetarëve të bashkive, po mirë, po pse s'reaguat ju atëherë kur kryeministri jo i mori kompetencat, autonominë, pavarësinë? S'pyeti as kush i ka zgjedhur, janë të majtë apo të djathtë? I tha: "Ndërroni drejtorët, ndërroni këto." Pse bëni ju? Pse me dy standarde vini dhe vini flisni me dy standarde? As është. Nuk është e sigurtë dhe e vërtetë kjo. Edhe njëherë, mos e rrisim kot temperaturën kur zonja Zhupa foli me fjalor parlamentar. E kam për detyrë dhe unë habitem se ne këtë gjë e kemi thënë dhe për Elbasanin dhe për Shkodrën dhe kemi rënë në unison të dyja palët që po, e kam për detyrë që po, ne do të caktojmë një datë tjetër. Pse sot paskemi parashtrim të kundërtë? Pse e tha zonja Zhupa për zonjën Mersini? Po ne kështu e kemi lënë dhe unë po do lëmë një ditë tjetër. Kështu është dakordësia e këtij komisioni. Duhet të vijnë këtu kryetarët e bashkive. As nënkryetarët kemi pasur raste ne që kanë ardhur nënkryetarët dhe si kemi dëgjuar, i kemi refuzuar ndoshta edhe duke u sjellur pak keq me tasët. Kanë bërë kilometra të tëra për të ardhur këtu. Kështu që mos e bëjmë këtë debat kot. Duhet të vijnë, është shmangje. Dha qëndrimin e vet zonja Zhupa. Kemi kryetarët e tjerë, jo vetëm për zonjën Mersini, edhe për kryetarin tjetër të Tiniqit, dhe ai patjetër duhet të vijë. Dhe të tjerët që nuk kanë mundësi apo mendojnë se s'duhet të vijnë këtu, duhet patjetër të vijnë, sepse është detyrim. Kur thërret ku vendi për dëgjim, për opinion, duhet të paraqitesh. Nuk është çështje dëshirash këtu, është çështje detyrimi komplet. Kështu që pa humbur kohë, unë mendoj që të nisim. Po, patjetër.

Arbjan Mazniku:

Atëherë, shkurtimisht, për të qenë korrekt me publikun, por dhe me përzgjedhjet ballet, po, kemi rënë dakord që do t'i japim një mundësi kryetarëve të bashkive që nuk kanë qenë prezentë në mbledhjet e mëparshme të vijë dhe të jenë prezentë. Po, është e vërtetë, parlamenti ka të drejtën të thërrasë anëtarët e kabinetit, të thërrasë edhe institucionet e pavarura, sepse pushteti i tyre buron nga parlamenti. I voton parlamenti. Kryetari, kryetari, kryetari i bashkisë, kryetarët e bashkisë, pushteti i kryetarëve të bashkisë buron nga njerëzit dhe kur vijë në dëgjim, thriten në dëgjim. Ndër të tjera, patjetër. Patjetër. Dhe ndërkohë që kryetarët e bashkive, patjetër, kur ka raste të caktuara që parlamenti krijon një komision hetimor, të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë, përfshirë në komisionin hetimor, për këtë po them. Po të them dhe njëherë, po të them dhe njëherë, po të lutem se mos u hyshni, ka zgjedhur, ka dashur të vijë dhe ka ardhur. E ka thirrë pra dhe ka dashur të vijë dhe ka ardhur. Po të them dhe njëherë, jo një pushtet autonom, zonjë e nderuar. Vazhdojmë gjënë. Zoti Mziu, keni si zakonisht mundësinë të filloni pyetjen e parë. Pas shansit. Direkt, s'ka problem. Le ta bëjë zoti Mziu. Zoti Mziu, ju lutem.

Xhelal Mziu:

Faleminderit. Për të mos u zgjatur shumë, për të mos u zgjatur shumë, besoj që kjo ftesë e kryetarëve të bashkive do t'i shërbejë reformës territoriale për të përfituar një reformë që të jetë më autonome, që të jetë më afër qytetarëve dhe që të ketë një pavarësi financiare. Nëse plotësohen këto tre kushte, absolutisht që do të ishte një zgjidhje shumë oportune. Kështu që po prapë do të kërkoja që mos t'i shikojmë pyetjet që bën opozita thjesht politike për t'i devijuar, por për të dhënë substancën e problematikës që ka, meqenëse jemi në prag të një reforme territoriale që t'i shërbejë Shqipërisë. Dhe për të filluar konkretisht, po bëj disa pyetje, të cilat do të doja opinionin tuaj dhe që i shërbejnë ndonjëherë pushtetit vendor dhe ajo çka është kryesorja, i shërbejnë qytetarëve dhe decentralizimit. Janë kaluar 7 kompetenca në vitin 2015 dhe këto kompetenca ishin një zgjidhje e mirë. Sa më shumë kompetenca t'i kalohet pushtetit vendor në këndvështrimin tim dhe si ish-kryetar bashkie, aq më shumë i shërbeu qytetarëve. Në këto kompetenca që janë kaluar, financat kanë qenë të pamjaftueshme për t'i mbuluar këto kompetenca dhe pyetja ime është: ose këto kompetenca janë lënë pa zbatuar, ose i keni përdorur buxhetin e bashkisë për t'i mbuluar. Bie fjala, nëse ndodh një zjarr që jo pak herë ndodh, a keni pasur mjaftueshëm mbështetje financiare për pagat dhe mjetet zjarrfikëse? Së dyti, së dyti, ka kaluar vadija dhe kullimi. Po prapë, dy kompetenca të cilat ndikojnë në mënyrë drejtpërdrejtë tek bujqësia. Bujqësia, sjell në vëmendjen tuaj që është indikator kryesor i bujqësisë dhe i ekonomisë, pavarësisht se ka patur një regres këto 4-5 vitet e fundit, por është punëmarrësi më i madh dhe ndërkohë kontributori po aq i madh. A keni patur mjaftueshëm fonde për të krijuar standardin e vaditjes dhe të kullimit, sidomos në zona të cilat përmbytën dhe sjellë efekte të jashtëzakonshme negative? Një pyetje tjetër, po prapë në lidhje me këto kompetenca është: ka kaluar, po themi, mirëmbajtja e shkollave, ka kaluar pjesa e administratës ndihmëse të arsimit parauniversitar dhe ndërkohë, financat, me aq sa shohim ne nga buxheti që vjen në fillimin e vitit, janë shumë të pakta. Bie fjala, kudo që shkosh nëpër bashki, sidomos në zonat periferike të saj, sheh shkolla të cilat janë pa dyer, pa dritare, pa rrethim, pa ujë të pijshëm dhe. Jo se kryetarët e bashkive janë të pandjeshëm, por financat që janë deleguar janë të pamjaftueshme për t'i mbajtur

standardin e këtyre shkollave dhe pyetja ime është: do të kishit nevojë për të patur më shumë mbështetje financiare në lidhje me këtë sektor shumë të rëndësishëm? Edhe për të shkuar përtej kësaj, vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian kanë kompetencë, jo vetëm thjesht mirëmbajtje, si këto mirëmbajtësit, po themi, por kanë kompetencë për arsimin parauniversitar deri tek emërimi i drejtorit apo kompetenca të tjera, siç i kanë Kosova, por edhe vendet e Bashkimit Evropian. Pyetja ime po prapë: do të ishte më mirë që arsimi parauniversitar të kishte një ndërvaresi tek pushteti vendor? E njëjta gjë duhet të ndodhë dhe e kanë dhe vendet e tjera. Shërbimin parësor ju kanë lënë ato qendra shëndetësore thjesht për t'i mirëmbajtur, kanë ngelur si gabina elektrike të atyre viteve dhe ndërkohë, në fakt, kompetenca është shumë e paktë, asnjë lloj ndërvaresie, pavarësisht se në dyert tuaja trokasit qytetarët për të gjetur një zgjidhje, madje përtej kësaj dhe qarkullimi rrugor i qytetit në të gjithë Evropën janë bashkitë ato të cilat bëjnë menaxhimin e tyre. Ndërkohë, ju nuk e luani këtë rol, madje edhe brenda qendrës së qytetit nuk e keni këtë rol. Një tjetër sfidë është kadastra urbane. Të ardhurat që merr buxheti i shtetit në Shqipëri janë minimaliste, janë me herë më pak sesa vendet e rajonit dhe disa herë të tjera më pak sesa vendet e Bashkimit Evropian. Pra, është një ardhur shumë e rëndësishme, por për shkak të informalitetit dhe për shkak të centralizimit të saj, duke kaluar jo vetëm te pushteti qendror, por duke e centralizuar në Tiranë apo në qendra të qarqeve e diku tjetër, e ka pamundësuar këtë standard dhe pyetja ime është konkrete: jeni për të patur kadastrin urbane siç e kanë vendet e tjera të Bashkimit Evropian? Sepse në këndvështrimin tim, nuk besoj që Evropa është vite mbrapa, por është dekada para nesh, sepse çdo qytetar vjen tek bashkia dhe e ka më të kollajtë për ta zgjidhur konfliktin. Pra, edhe kjo është një tjetër çështje të cilën ndonjëherë opinionin tuaj. Paluir, pastaj të ardhurat që duhet të merren, të ardhurat që duhet të merren nga taksat kombëtare, të ardhurat që duhet të merren nga rentat apo të tjera të cilat i mungojnë. Për të shkuar më tej, meqenëse një pjesë e mirë e bashkive që ju drejtoni janë dhe bregdetare, një kryetar bashkie nuk ka kompetencë për të dhënë atë menaxhimin e rërës apo të çadrave. Duhet të jetë ministria dhe pastaj bëhet një mishmash aty midis bashkisë dhe ministrisë dhe jo pak herë krijon konflikte. Kudo, menaxhimi bëhet, po themi, nga bashkitë. Një tjetër element shumë i rëndësishëm janë. Dhe njëherë, ndërhyrja në kompetencat e bashkive. A ju duket normale që kryeministri, pavarësisht kajeve politike që keni, të ndërhyjë për të hequr sekretarin e përgjithshëm nënkryetar, drejtor? Ç'lidhje ka? Edhe nëse duhet ta bëjë politikisht, mund ta bëjë në kështu takime elektorale ose takime partiake, por që t'i japë urdhër, kjo është e papranueshme. Pushteti qendror dhe ai vendor janë absolutisht të pavarur. Një tjetër çështje janë paratë që i vijnë në dispozicion. 1% e GDP-së vendoset në dispozicion bashkë me këto të tjera shpenzime, maksimumi shkojnë te 2.5% apo 3%. Vendet e rajonit e kanë 6%, vendet e Bashkimit Evropian e kanë 12%. Pra, kjo do të thotë që e keni diku te 3 herë apo 4 herë më pak sesa vendet e tjera dhe e keni të pamjaftueshme. Do të ishit për këtë 1%? Apo për të patur, po themi, një qasje të barabartë si vendet e tjera të rajonit për t'i shërbyer qytetarëve, për të patur më shumë investime, për të patur më shumë shërbime ndaj qytetarëve? Një tjetër element ka ndodhur, është decentralizuar, po themi, pushteti vendor kudo që shkon. Në Shqipëri ndodhi e kundërta, ndodhi centralizimi. Bie fjala, Kroacia, para sesa shkonte në Bashkimin Evropian, rriti numrin e njësive vendore e vajti në 556. Mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian është

diku te 6 mijë apo 7 mijë banorë. Ne e kemi 70 mijë, teorikisht, praktikisht, sipas atyre që janë këtu, e kemi 40 mijë. Pra, kjo do të thotë e kemi me deri në 10 herë më shumë dhe çfarë do të thotë që ka ndikuar negativisht tek shërbimi ndaj qytetarëve dhe për pasojë ka sjellur që të rrënohet bujqësia, që të mbyllen disa shkolla periferike, të mbyllen disa qendra shëndetësore dhe për pasojë të ikin qytetarët. Ndërkohë, pyetja ime është: a do të ishit dakord ju? Bie fjala. Që të ishte edhe Bashkia e Urkumit. Ka qenë një ndër 65 bashki që ka pasur Shqipëria, sot nuk është më. A do të ishit dakord, po themi, që nga 7 bashki që ka sot, të ishin 10 apo më shumë bashki, apo do të kishit qasjen siç ka mazhoranca për t'u përqendruar në ato 26 rrethet apo 36 rrethet? Pra, çfarë do të thotë që të kemi vetëm dy bashki? Të kemi një bashki të Vlorës dhe të kemi edhe një bashki të Sarandës dhe do të mjaftonin. Ndërkohë që gjithë Evropa ka si sfidë të saj me minuta për ta patur afër bashkinë dhe jo për ta patur me orë të tëra për të shkuar, po themi, tek qendrat dhe kjo pastaj ka sjellur, po themi, atë centralizimin duke ikur në zonat urbane dhe duke e lënë mënjanë. Pra, edhe në këtë drejtim do të doja opinionin tuaj: jeni për të patur më shumë bashki për të mbajtur këtë standard, apo për ta kufizuar në ato 26 komitetet e partisë apo që kanë qenë ato 26 rrethet e asaj kohe? Nuk po zgjatem në aspektin tjetër, është ishte edhe një kauzë që nuk është mbajtur, bie fjala. Do të shkurtohesh, administrata do të kurseshin 80 milion euro. Në fakt, çdo bashki, bashkia që ka qenë më kursimtare, e ka dyfishuar fondin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore dhe ka shkuar deri në 8-fishimin e saj. Kjo ka ardhur nga dy indikatorë: rritja e pagës dhe rritja e fuqisë punëtore. Për rritjen e pagës nuk kam ndonjë kundërshti, madje mund të rritet dhe më shumë niveli i pagës, por jam absolutisht kundër rritjes së pajustificuar të administratës, e cila shkon në drejtimin e kundërt të ekonomisë së shkallës e për pasojë krijon kostoshtesë. Ju kujtoj që në vitin 2015, kur kishim 373 njësitë vendore, 37.5% e buxhetit shkonte për investime kapitale. Sot, që kemi 61 bashki, kemi vetëm 18% që shkojnë, pra dy herë më pak investime kapitale. Pse? Sepse vendin e parë e kanë zënë pagat dhe sigurimet shoqërore dhe pothuajse në shumicën e bashkive, pra pushteti vendor po përdoret edhe nga qeveria si një instrument elektorale për të rritur numrin e të punësuarve dhe për pasojë, edhe kur bëhen rankime nga Eurostat apo BNB, Shqipëria del me rentabilitetin më të lartë të fuqisë punëtore, po themi, në Evropë, me disa herë më pak sesa mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian, por edhe më pak sesa mesatarja e Ballkanit. Këto ishin pyetjet e mia dhe do të doja për të qenë konciz, thjesht për të rikthyer përgjigjet e atyre që unë ngrita. Faleminderit!

Luçiano Boçi:

Po, atëherë shoh që Moisi Zjarti është te zoti Tavo, me zor po pret ta marri fjalën edhe ia kaloj atij.

Vangjel Tavo:

Nuk e kuptova ku e pe atë zjarrin tim, por megjithatë faleminderit që ma dhatë fjalën.

Luçiano Boçi:

Zoti Tavo, ti the ku e pe...

Vangjel Tavo:

I fshehu një pak, nuk besoj që specialisti e kupton.

Luçiano Boçi:

Jo, jo, the ku e pe dhe je shumë i saktë, se nuk thashë e dëgjova. Se ti gjithë atë gjesti kuracion për çfarë e bëre?

Vangjel Tavo:

Jo, unë isha kështu se...

Luçiano Boçi:

Ishte pozitiv zoti Tavo, pse ke qasje negative ndaj çdo elementi që shpreh opozitë?

Vangjel Tavo:

Ajo çka në fakt, që nëse më lejoni ta bëj komentin që mua realisht më ka krijuar një shije negative edhe në dëgjesën e Vlorës dhe në dëgjesat që ju kam ndjekur edhe me kolegët tanë kryetarë bashkish këtu, edhe sot është fakti që ky komision është kthyer në arenë përplasjesh dhe debati politik. Në fakt, thelbi nuk besoj se është ky. Megjithatë, ju jeni politikanë, ju do vendosni sepse është normale që të bëni politikë dhe falenderoj shumë zotin Mziu që e futi këtë mbledhje në shinat e, në fakt, të qëllimit të kësaj mbledhje, të këtij takimi, kësaj dëgjese.

Luçiano Boçi:

Zoti Tavo,

Vangjel Tavo:

Ju kërkova ndjesë për komentin, kërkova ndjesë për komentin.

Luçiano Boçi:

Dhe njëherë, një minutë, se këtu jemi, ju keni qenë parlamentarë dhe keni qenë në pozitën edhe timen, edhe të zotit Mziu dhe deputetëve të tjerë dhe këtu, domethënë, nuk jemi në vendin e leksioneve të parlamentarizmit. Secili e ushtron mandatin.

Vangjel Tavo:

Jemi këtu, po ku jemi?

Luçiano Boçi:

Leksionet, leksionet tek administrata. Jo, unë ju kërkova ndjesë kur bëra këtë ndërhyrje, sepse sot... Po ja, prit se jo, ka një gjë, prit se dhe unë do bëj një ndërhyrje dhe do të kërktoj ndjesë në fund të parë. Patjetër, bëjeni, bëjeni, do ta bëni në fund. Po pra, po do të

kem të drejtën e replikës. Siç e bëre ti dhe... Të drejtën e replikës, sepse në fakt sot çfarë dëgjova këtu, çfarë dëgjova sot këtu?

Luçiano Boçi:

Ke të drejtën e përgjigjes, ja një minutë ta, domethënë, ta mbaroj, ta mbaroj, sepse thashë që siç e bëtë ju, që thatë ato që kishit për të thënë dhe në fund kërkuat një ndjesë, e latë me një ndjesë. Po pra, dhe në rastin konkret unë po them që jemi të përcaktuar në pozicione dhe pa paragjykime dhe gjykime që ti, paske dhe post dëgjesave që ne kemi bërë në qarqe, jo me kryetarët e bashkive, i kemi bërë me administratën tuaj dhe me njerëz që kishin ardhur për të thënë mendimet e tyre dhe në këtë rast, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, unë ju orientoj që, sepse në fund zoti Mazniku e mbyll për çështje që nuk shpreheni, mund të dërgoni një letër pranë komisionit tonë dhe te pjesa juaj, si e gjykoni ju që do të jetë më mirë modaliteti që ne të zhvillojmë dëgjesat me kryetarët e bashkive, se kemi ende, apo si të zhvillojmë dëgjesat me komunitetet, se si kemi bërë, apo si të zhvillojmë dëgjesat në rang qarku, se besoj ndërthuret edhe përvoja si parlamentar edhe përvoja si drejtues i pushtetit lokal dhe do e mirëpresim, të jesh i bindur, do e lexojmë me vëmendje, do e studiojmë, do nxjerrim, po, do nxjerrim dhe mësim me pika dhe do t'i zbatojmë në fund fare. Faleminderit, tani pa humbur kohë, vijoni me përgjigjet e pyetjeve që u bëjnë nga të gjithë.

Vangjel Tavo:

Do jua jap dhe këtë, vërtetë do jap dhe këtë këshillë, po ajo që dëgjova sot ishte dhe për lindshmërinë që unë jam ginekolog edhe thashë, nëse dhe kjo kompetencë i kalon pushtetit vendor, lum si ne.

Luçiano Boçi:

Atëherë, pak këshilla, pak këshilla.

Vangjel Tavo:

Atëherë, unë mendoj që kjo reformë administrative duhet patjetër që të ketë parasysh disa indikatorë dhe pastaj, mbasi të shikohen të gjitha indikatorët, padyshim që ajo qëllimi politik është, me sa kemi parë, është territori. Indikatorët kryesorë që duhet të shikojmë, të ndjekim për të arritur në një përfundim të reformës, për të arritur ju, në fakt, po që me siguri neve do ju, meqë na keni thirrur, ne na pyetët, ne do ju përgjigjemi. Janë e para, shërbimi ndaj komunitetit. Bashkitë, njësitë administrative, funksionin e tyre, misionin e tyre kanë shërbimin ndaj njerëzve, ndaj komunitetit dhe padyshim kjo është e lidhur ngushtë me kompetencat që duhet të ketë pushteti vendor, por po aq e lidhur ngushtë me financat që duhet të ketë pushteti vendor dhe po aq e lidhur ngushtë pastaj dhe me kapacitetet njerëzore që duhet të ketë një pushtet vendor për të ushtruar ato kompetencat e veta, por për të bërë detyrën e vet për të shërbyer komunitetit. Nëse do më pyesnit në përgjithësi, ose më lejoni t'ju them në përgjithësi se çfarë ndikimi ka pasur reforma administrative e 2014-s në pushtetin vendor, mund t'ju them që po, ka pasur ndikim pozitiv në shumë drejtime, ashtu sikurse ka shumë vend për të korrigjuar dhe për të rregulluar,

por kjo nuk ka të bëjë me territorin. Unë nuk e kam votuar reformën, edhe pse isha pjesë e mazhorancës, për arsye të tjera, por atëherë isha deputet, sot që jam kryetar bashkie dhe e provova se ç'do të thotë të drejtohesh pushtetin vendor, do ta votoja me të dy duart. Nuk është autokritikë, aspak, i qëndroj vendimit të atëhershëm. Kështu që nuk është shembull i marrë, në fakt, për të folur se sa financa ka një bashki dhe sa mundësi financiare ka e marra për të plotësuar kërkesat e komunitetit, sepse i marra nuk është ky shembull. I kemi të gjitha mundësitë dhe po i shërbejmë komunitetit në mënyrën më të mirë të mundshme, edhe me investime dhe në shërbime. Pra, nuk është i marra për t'u marrë shembull, por gjithsesi dua t'ju them vetëm kaq: çfarë të mirë ka pasur reforma e 2014-s, duke bashkuar disa njësi administrative, disa ish-komuna, të cilat e kishin të pamundur të mbijetonin, financiarisht flas, dhe normalisht financa është indikator kryesor kur flasim për shërbimet. Mund t'ju them që po, absolutisht, dhe ju kam dhënë një shembull që juve ju është dukur si bardhë-colletë, zoti Boçi, por nuk është e vërtetë, është fiks siç e kam thënë unë. Vetëm njësi organisht, në vitin 2025, nga Bashkia e Imarrë ka marrë investime 10 milion euro, ndërkohë që të ardhurat e kësaj njësie për Bashkinë e Imarrës janë 18 mijë euro gjithsej dhe kjo është llogari e thjeshtë për të arritur të mbledhësh, të investosh 10 milion euro me të ardhurat e tua të njësisë. Është e pamundur, duhen vërtetë 555 vite, është kollaj për ta bërë atë llogari. Pra, nuk ishte bardhë-colletë dhe nuk e kisha për, më mirë kuptoni, domethënë, për të ngacmuar ndonjërin në atë sallë. Të vazhdojmë më poshtë. Jo, Dulja është atje. S'kemi qenë ju. Do kthehem konkret te pyetjet, do kthehem tani te pyetjet, sinqerisht. Do kthehem direkt te pyetjet.

Xhelal Mziu:

Mund të bëj një ca hartime unë me leksionet e rrinja 11 orë.

Vangjel Tavo:

Po lëri hartimet Luçjanos që është i fushës së burrë. Po, më falës.

Xhelal Mziu:

Unë kërkoj që të ketë përgjigjet e atyre pyetjeve. Kur të mbarosh pyetjet, pastaj mund të fillosh të bësh relatime të tjera.

Luçiano Boçi:

Atëherë, zoti Tavo, meqenëse unë bëhem hartime, ti je ginekolog. Kush është në pozitën e gabuar në këtë rast? Më duket se je ti. Po, po, po, unë jam. Dëgjo, vendi i fjalës është parlamenti. Unë jam tek fjala. Po që se performon mirë si ginekolog, shko atje më mirë, më dëgjo mua, se je në rregull me veten. Vazhdo. Po mirë, pra mirë, po kur je atëherë është shumë mirë. Jo, jo, dakord, po i lëmë. Po ka një gjë, zoti Tavo, sepse zoti Tavo, duhet të kthehesh, duhet të kthehesh tek përgjigjet për një arsye. Po, për një arsye të vetme. Nuk jemi këtu për të bërë ballafaqimin e 2014-s me 2005-ën. Ka kaluar ajo kohë. Po sigurisht më e kam sqaruar që në fillim edhe unë, edhe ndoshta dhe bashkëkryetari. Unë e kam sqaruar që në fillim. Këtu jemi për pritshmëritë që u ndërjuan në 2014-n dhe ajo që është realizuar dhe çfarë kërkonte ju nga ne që ne të ndërhyjmë, se jemi në reformë.

Një reformë bëhet sepse diçka e madhe nuk shkon. Nuk bëhet reforma, është bërë mirë, po do e bëjmë më mirë. Reforma është, nuk shkon. Çfarë nuk shkon? Çfarë nuk shkon tek puna juaj? Ku e keni pengesën? Në qoftë se jeni kaq të lumtur, nuk ka problem fare, sepse jeni. Ka bashki të mira, performojnë dhe unë jam shumë dakord. Ka të vogla, të mesme dhe nuk duhen zmadhuar, se ne këtë duam të nxjerrim në vazhdimësi. Dhe në fund fare, nuk e kam përmendur atë për barsaletë fare, sepse barsaletat i bën populli, nuk i bëj unë. E kam përmendur për një fakt që ai tregon që po, Bashkia e Imarrë ka mundësi të grumbullojë para nga taksat e njerëzve, sikurse qeveria ka mundësi. Dhe po të dojë, qeveria nuk të sjell ty 10 milionë, se këtë po kërkojmë që të financohen bashkitë e tjera nga buxheti i shtetit, të sjellë 50 milionë prej herë i tunelit, 50 milionë mbani. T'i sjellë ty edhe të bësh ti, jo rrugën e fratarit, po të bësh gjithë rrjetin rrugor që imagjinon që e do. Nuk e vë në dyshim që e doni. Kështu që mos dalim kot, hidh e prit, ndërkohë se unë e kam fushë, ti e ke përvojë, unë e kam dhe përvojë, etj., etj. Nuk nxjerrim gjë në dritë. Pyetjet i ka bërë zoti Mziu. Vazhdojmë dhe përgjigjesh, shqetësimet, problemet.

Vangjel Tavo:

Po pra, pyetjet, pyetjet që bëri zoti Mziu, që janë realisht në temë, e thashë që në fillim, ka të bëjnë pikërisht me ato që po flas unë. Me reformën e '14-s ka të bëjnë dhe a jemi apo jo ne të kënaqur me këtë reformë. Dhe po i përgjigjesha pyetjes së financës që bëri zoti Mziu, sepse në çdo pyetje...

Arbjan Mazniku:

Po në fakt, zoti Tavo, vetëm një fjalë i kam. Dëgjo, unë mendoj që nuk është e drejtë nga ana jonë që pasi ne i bëjmë pyetjet siç i mendojmë ne, t'i ndërhyjmë në përgjigje kryetarëve. Kryetar, po tani kemi bërë një pyetje, ne do i lëmë kohën respektive kryetarit të japë përgjigjen që do ai dhe si e mendon ai. Dhe nëse s'përgjigjet më mbrapa, bën një pyetje tjetër dhe themi: "Nuk mora përgjigje për këtë." Por ndërhyrja në mes të fjalisë se mendojmë ne ç'do të thotë më pas kryetari, kryetarët janë njerëz, e thashë dhe çfarë, përveçse janë njerëz adultë, janë të votuar në qytetarë shqiptarë, menaxhojnë qytete, dinë vetë t'i japin përgjigje. Përgjigjes t'i japim përgjigje kur të mbarojmë, kemi pyetje tjetër, s'ka problem. Po ndërprerja në mes e njerëzve nuk është pjesë edhe një etike që kemi vendosur, besoj, në këtë komision. Kështu që zoti Tavo, ju lutem përgjigjen tuaj. Faleminderit shumë. Ju urojmë ndjesë për ndërprerjen.

Vangjel Tavo:

Faleminderit. Ndoshta, ndoshta unë u keqkuptova, por në fakt po përgjigjesha pyetjeve të zotit Mziu, sepse zoti Mziu në çdo pyetje që bëri, duke e nisur nga zjarrfikëset, a keni pasur mbështetje financiare, duke vazhduar te vaditja, financa, duke vazhduar te mirëmbajtja e shkollave, financa, duke vazhduar tek shërbimi parësor, tek pra çdo pyetje që bëri zoti Mziu ishte për financat. Që unë mos t'i merrja një nga një përgjigjet, u përgjigja në total për financat. Nëse doni një nga një, unë mund të përgjigjem. Mbështetja për zjarrfikëset, meqë e nisi zoti Mziu me zjarrfikëset, ka qenë sinqerisht, domethënë, mbresëlënëse. Po jua them sinqerisht, sepse Imarra vitin e kaluar është përballur me një

numër zjarresh që sinqerisht, domethënë, na gjeti deri diku të papërgatitur. Dhe nëse nuk do të ishte qeveria qendrore, Ministria e Mbrojtjes dhe emergjencat, ne realisht do kishim probleme jo vetëm dëme në prona, në pasuri, por ndoshta dhe njerëzore. Po ishte pikërisht ndërhyrja e pushtetit qendror, pra e Ministrisë së Emergjencave, që e evitua këtë. Kanë ardhur në Imarrë, ka ardhur helikopter disa herë, avion disa herë, pra nuk mund të them që s'kemi pasur mbështetje. Çfarë duhet të zjarrfikëset? Patjetër duhet, për Imarrën flas gjithmonë, Imarra ka një numër të caktuar zjarrfikësesh në bazë të numrit të popullsisë. E njëjta gjë vlen edhe për policinë bashkiake, por numri i popullsisë së Imarrës gjatë sezonit turistik, kur problematika e zjarreve është në sezon, shtohet 10 a 20 fishohet. Këtë po, kjo është një gjë që duhet të thuhet, por nuk është pjesë e kompetencave të bashkisë për reformën territoriale. Kjo është thjesht një çështje që rregullohet me VKM, duke na dhënë të drejtën neve për të marrë sezonal disa punonjës shtesë, zjarrfikësesh apo polici bashkiake. Pra, për sa i përket shkollave, mirëmbajtjes së shkollave, padyshim që kemi pasur investime nga qeveria qendrore. Unë kam, nuk kam as dy vjet akoma, s'kam mbushur dy vite në pushtetin vendor, por vjet, për shembull, dhe është në proces, 2025-ën kemi investimin e rikonstruksionit, pra të shkollës së Imarrës. Si vjet për 2026-ën është vendosur nga Bashkia rikonstruksioni i shkollës së Dërmiut. Janë bërë rikonstruksione më përpara, vite më përpara, edhe në Kuç, edhe në Vranisht, edhe në Lukovë. Pra, ka pasur mbështetje nga qeveria qendrore për rikonstruksionin e shkollave. A duhet patjetër që Bashkia të ketë kompetencë më shumë për sa i përket sistemit parësor dhe sistemit parauniversitar? Po, më po, duhet të ketë më tepër. Nuk themi jo. Patjetër që duhet të kemi më tepër kompetencë dhe jo vetëm në mirëmbajtje, edhe në pjesën e personelit të mesëm. Pra, nuk na gjen kundër kjo. Nëse do të flasim në përgjithësi për kompetencat, përgjigjja ime, kompetencat e pushtetit vendor, përgjigjja ime është me një përgjigje, me një fjali: Po, të zbatohen kompetencat e pushtetit vendor, janë parimet e Kartës së Autonomisë Vendore që është ratifikuar nga Parlamenti në 1999. Unë e kam votuar, kam qenë deputet, s'ka asgjë më shumë, mos diskutoni më tepër. Vendoseni ato kompetenca dhe mbyllet kjo histori. Kështu që nuk është, kam përshtypjen, ngërçi i reformës nuk vjen thjesht tek kompetencat apo tek financa. Patjetër që duhet më tepër financë për ato bashki që s'kanë mundësi që të menaxhojnë, të mirëmbajnë veten, ndoshta shprehja s'është e drejtë. Pra, për t'u ofruar ato shërbime ndaj qytetarëve nga pushteti qendror, por padyshim që ka dhe shumë hapësira. Secila bashki dhe aq sa më e madhe të jetë territori i bashkisë, aq më shumë hapësira ka bashkia edhe për të mbledhur më shumë fonde, por edhe për të ndihmuar nëpërmjet skemës së solidaritetit, për të ndihmuar ato njësi ose bashki që nuk e mbajnë dot veten financiarisht. Pra, kjo është çështja juaj. Ju do ta vendosni në fund se si do të jetë reforma e re, duke patur parasysh nëse unë personalisht po të isha deputet, patjetër do të kishim parasysh lidhjet historike, traditat, zakonet e shumë e shumë gjëra të tjera gjatë riformatimit të njësive administrative, të njësive të reja administrative. Nga ana tjetër, a duhet të bashkëpunojmë? A kemi bashkëpunuar me njëri-tjetrin? Padyshim që kemi bashkëpunuar. Kemi raste edhe tek zjarret, edhe me zjarrfikëse, me njëri-tjetrin. Kemi raste në Ujësjellësa që kemi. Burimi është në Delvinë dhe ne do marrim ujën për Himarrën. Patjetër që duhet bashkëpunim, e po bashkëpunojmë. Rasti i mbetjeve që është një shembull i mirë bashkëpunimi me Qarkun, a ka vend akoma? Patjetër që ka vend akoma. Ne presim nga ju që ta miratoni

reformën administrative dhe po ju them prapë: shkruani në reformë Karta e Kompetencave, pra Karta e Autonomisë Vendore e ratifikuar në 1999 dhe ne jemi shumë të kënaqur. Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Faleminderit! Një nga kryetarët e tjerë i përgjigjet pyetjeve që kishte zoti Mziu.

Oltion Çaçi:

Përsëritje të gjithëve! Në fakt, edhe Saranda, ndoshta jo si Himarra, por paraqitet një nga qytetet me të ardhura financiare shumë të shëndosha. Është një nga qytetet që të ardhurat për frymë janë nga më të lartat në Shqipëri dhe në fakt shumë nga këto pyetje këtu ndoshta nuk ka vend për Sarandën, se një pjesë si qytet nuk është se ka shumë pyje zjarre. Problematika që në fakt ne na ndodhin gjatë sezonit të verës dhe ne kemi qenë në ndihmë të gjitha bashkive të Konispolit, të Delvinës, të Himarrës në rastin konkret, bashkë me ndihmën se këtu kemi dhe deputetin që ka qenë ministër. Ndërkohë, ne kemi pasur një bashkëpunim të shkëlqyer, sidomos për kohën e zjarrit në Sarandë dhe në zonën përreth. Por është pyetje që ndoshta në Sarandë nuk është se ka shumë zjarre. Kjo edhe për vetë faktin se qyteti është shumë i vogël dhe le të themi nuk është se ka shumë pyje. Unë po mundohem që t'i jap përgjigje pothuajse për të gjitha, të jem më konkret në rastin konkret, sepse nuk dua të bëj këtu ndoshta politika duhet të jetë më e madhe, duhet të jetë më e vogël. Këtë besoj që komisioni e ka aftësinë për të vendosur a duhet të jetë më e madhe apo duhet të jetë më e vogël në rastin konkret të reformës territoriale. Por patjetër që të gjitha bashkitë kanë nevojë për më shumë, më shumë buxhet për këtë. Jam i bindur, jo vetëm Saranda që ka të ardhura, por duke qenë se ka të ardhura, ka dhe zhvillim ekonomik shumë të lartë, ka dhe turizëm, ka dhe shtim popullsie, siç tha dhe kryetari i Himarrës. Dhe ne shtatëfishohemi gjatë sezonit të verës dhe këtu kemi nevojë për shërbime më të më të forta. Patjetër që këto kanë dhe kosto si në njerëz, por dhe në financa. Për menaxhimin e plazheve, ne kemi pasur një takim së fundmi bashkë me gjithë kryetarët e bashkive bregdetare dhe pak a shumë kemi rënë dakord që në mënyrë natyrale këto menaxhimi i plazheve të kalojë prapë bashkive. Por duke qenë se ka një efekt kontraktual, pretendojmë që të mbarojnë këto efekte dhe pastaj të kalojnë. Ka një dakordësi tashmë që bashkitë kanë aftësinë e duhur për t'i menaxhuar plazhet me resurset lokale. Për mirëmbajtjet, shkolla, kopshte, për financat, Bashkia Sarandë pothuajse ka mbaruar procesin e gjithë financimit të gjithë kopshteve, shkollëve dhe çerdheve. Brenda këtij viti, besoj, mbarojnë të gjitha këto. Një pjesë nga Bashkia Sarandë, një pjesë nga pushteti qendror, nga Ministria e Arsimit. Pastaj, pyetja e orikimit, bashkia besoj nuk i takon Sarandës që të kthejë përgjigje. Financat, besoj, Saranda është një nga qytetet që ka financat më të shëndosha në nivel lokal. Nuk besoj që ka ndonjë pyetje tjetër që mund të kthejë përgjigjen, përgjigje konkrete, meqë ishte biseda konkrete. Kurse pjesën politike, besoj, Evangjeli me eksperiencën e duhur e dha këtu sot. Kështu që ne si qark jemi të përfaqësuar shumë mirë nga mendimi politik i Evangjelit, por teknikisht, në qoftë se ka diçka tjetër, unë mund të kthejë përgjigje për Sarandën. Por do t'i hyja, do t'i hyj

pak më shumë bashkive më të vogla, duke qenë se kanë specifika, duke qenë se kanë specifika më të përcaktuara nga pyetjet që ka bërë deputeti. Kështu që besoj.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Çaçi, zoti Veli.

Besmir Veli:

Atëherë, përshëndetje! Të nderuar bashkëkryetarë dhe anëtarë të komisionit, shumë faleminderit për ftesën në një komision kaq të rëndësishëm, siç është ndarja administrative territoriale. Bashkia e Delvinës, unë po e nis diskutimin tim, Bashkia e Delvinës, në ndarjen e vitit 2014, ishte bashkuar dhe ishte komuna e Vergojit. Pra, përbëhet nga Bashkia e Delvinës, atëherë, dhe ishte komuna e Vergojit. Që po të krahasojmë buxhetin e atëhershëm me buxhetin që ka sot bashkia, është gati dyfish më shumë. Dhe e them këtë që gjatë funksionimit si bashki e madhe, ka pasur në fokus shërbimin sa më të mirë ndaj qytetarëve dhe po ashtu për investimet e bëra në të dyja këto zonat që unë nuk dua t'i ndaj dhe po i marr në një në tërësi, në fakt, si nga bashkia, por edhe nga pushteti qendror, ku ka pasur investime të në infrastrukturë të destinuar kryesisht. Po t'i marrim, në qoftë se do ishte komunë apo bashki, do ishte shumë herë më e vështirë për t'i realizuar këto investimet. Nuk dua të hyj në sa vite do t'i duheshin, por do t'i duheshin realisht shumë vite ish-komunës për të realizuar atë infrastrukturë që ka sot. A kemi nevojë ne për buxhet më shumë? Patjetër që po! A kemi nevojë të rishikohet formula e financimit të bashkive? Patjetër që po! E them këtë që zhvillimi që po merr zona, duke patur që Bashkia e Sarandës është afër me Delvinën dhe turistë të shumtë po vizitojnë nga viti në vit këtë bashki, dhe ata duan të kalojnë dhe përtej detit. Përtej detit, të kalojnë Delvinë edhe më gjerë. Dhe pikërisht ata vijnë për të vizituar Sarandën e bukur dhe detin, padyshim, por duan të vizitojnë edhe zona të tjera që, siç janë zonat malore në Delvinë. Duke nisur dhe nga pyetjet që bëri zoti Mziu, a ka pasur mbështetje financiare për zjarret, në paga e të tjerë e të tjerë në Bashkinë e Delvinës? Po, ka pasur mbështetje si për pagat dhe shpërblime për punonjësit e zjarfikëses, shpërblime për dëmtuarit nga zjarret. Dhe më lejoni të përgëzoj edhe një nisëm tjetër nga Ministria e Mbrotjtjes dhe nga AKMC-ja, ku së fundmi është rishikuar formula e buxhetimit të emergjencave civile për bashkitë. Bashkia e Delvinës ka qenë një nga bashkitë më të prekura nga zjarret dhe sot kemi një shtatëfishim të atij buxheti, krahasuar me një vit më parë. Qeveria shqiptare, a keni patur mjaftueshëm fonde për ujitje e kullimin? Po, Bashkia e Delvinës ka një karakter bujqësor. Kemi mjaftueshëm fonde për kanalet ujitëse dhe vaditëse dhe jemi gjithmonë në shërbim të qytetarëve për t'i pastruar dhe për t'i mirëmbajtur. Për t'i mirëmbajtur ato. A ka nevojë për më shumë? Patjetër që po! Investime në ujitjen, vetëm vitet e fundit në Delvinë janë bërë mbi afërsisht 1 milion euro dhe kjo nga buxheti i shtetit. Mirëmbajtja e shkollave, një investim që ka marrë Bashkia e Delvinës në vitet e fundit ka qenë ai i rikonstruksionit të shkollës së mesme "Sulejman Delvina" dhe aty po bëhet një rikonstruksion dhe duke i dhënë një dhe duke kthyer në identitet atë shkollë të mesme, e vetmja në fakt në gjithë qytetin e Delvinës. Nga buxheti i bashkisë, padyshim parashikohet edhe një fond ku bëhet mirëmbajtja e të gjitha shkollave që janë funksionale dhe i japin

shërbime nëpër fshatra apo edhe në bashki. Edhe gjithmonë bashkia ka qenë në vëmendje të këtyre, duke i dhënë vëmendjen e duhur që arsimit parashkollor edhe ai parauniversitar të ofrohet më së miri. A ka nevojë për ndryshimin e taksave? Bëri një pyetje zoti Mziu. Patjetër që po! Duke nisur nga renta minerare edhe të tjera, që padysim në qoftë se do jepej më shumë, më shumë buxhet bashkive, por kjo është e lidhur dhe me atë çfarë unë thashë më parë te rishikimi i formulës edhe më tej. A kanë funksionuar bashkitë apo duhet zgjerimi i tyre? Ishte një nga pyetjet, ashtimi i numrit të bashkive. Në opinionin tim, bashkitë kanë funksionuar. Unë po marr shembull atë të Delvinës dhe besoj dhe është dhe duhet të vazhdojnë të shërbejnë sa më afër qytetarëve dhe duke ruajtur gjithashtu edhe vlerat e tyre historike, por edhe traditat e tyre që janë të rëndësishme, që edhe duhen marrë parasysh edhe nga komisioni. Një shqetësim tjetër që ngriti zoti Mziu ishte urdhri i kryeministrit për shkarkimin e drejtorëve apo të sekretarëve të përgjithshëm. Unë mendoj se ishte një rekomandim për të bërë detyra më mirë. Nuk besoj se unë po shikoj Bashkinë e Delvinës edhe nuk ka pasur ndonjë ndryshim as në drejtorë, as në kryetarë, as në... Ishte, ishte, unë mendoj se ishte një rekomandim kështu që nuk po... Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Faleminderit!

Nertil Bellaj:

Përshëndetje të gjithëve! Të nderuar bashkëkryetarë të komisionit, anëtarë të komisionit të reformës territoriale, unë si kryetar i bashkisë së Selenices, ndihem këtu i vlerësuar. Me si zëri i qytetarëve të asaj bashkie, do të flas për problematikat dhe çështjet që duhet të adresojmë në këtë komision, i cili është shumë i rëndësishëm për bashkinë e Selenicës. Bashkia e Selenicës përbëhet nga bashkia e vetë dhe nga pesë njësi administrative, të cilat ju bashkuan në vitin 2014. Ka një territor rreth 561 km² dhe është një bashki tipike bujqësore blektorale me zhvillim turistik-malor. Duke mos ju vonuar dhe duke ju përqendruar te pyetjet që bëri zoti Mziu, pika e parë e cila ka të bëjë me çështjen e zjarreve dhe të emergjencave civile, bashkia jonë është një bashki e cila, për shkak të territorit, ka rrezik sepse është bashki kodrinore, e cila ka pyje, ka fusha dhe e vërteta është që vitet e fundit qeveria ka pasur një fokus të veçantë për mjetet civile. Këtu kemi ne, është deri mund të themi që është një ish-ministri, i cili vërtet, duke e parë nga afër këtë problematikë, këtë vit ka ndryshuar dhe mënyra se si fondet specifike kanë harruar më ndryshe. Pra, në qoftë se ne mirrim X, këtë herë marrim trefishin, katërfishin. Pra, mënyra se si është formuluar rishpërndarja e granteve të kushtëzuara ka ndryshuar dhe besoj në këtë pjesë ku është bërë për emergjencat civile, ka nevojë dhe për disa sektorë të tjerë që mund të jetë edhe sektori i bujqësisë. Thashë që ne jemi bashki bujqësore blektorale dhe sot që flasim, kemi të paktën mbi 15.000 hektarë toka bujqësore. Kemi mbi 300 km kanale dhe sot që flasim këtu në komision, tokat bujqësore, një pjesë e madhe e tyre janë në ujë, duke vaditur. Ishin më mirë këto para reformës së 2014-s. Qytetarët që na dëgjojnë e dinë shumë mirë që jo vetëm unë si kryetar bashkie, por të dy ish-kryetarët e bashkive, ku një ka qenë i majtë, një ka qenë i djathtë, e ka pasur në fokus, në fokus mirëmbajtjen e

kanaleve vaditëse, të kanaleve ujitëse dhe po u them që janë hedhur rreth 2 milionë euro nga taksat e bashkisë për mbi 25 km kanal vadac me beton. Këtu bëhet fjalë për fushën e Armenit, bëhet fjalë për fushën e Shkozës dhe një pjesë në fushën e Trashovicës. Tani, për sa i përket pyetjes për mirëmbajtjen e shkollave, unë po ju them që këto pesë vite, pothuajse të gjitha shkollat e mesme në bashkinë e Serenicës kanë pasur një rikonsultim total. Pra, nuk ka sot në bashkinë e Serenicës shkolla të mesme të bashkuara pa u ndërhyrë dhe kjo është bërë falë mbështetjes së qeverisë në bashkëpunim me bashkinë. Për sa i përket të ardhurave nga qeveria, e cila është 1% e gjithëbijës për bashkitë, a duhet më shumë? Po, patjetër më duhet më shumë. Duhet të jetë më shumë se 1%. Jemi pikërisht të gjithë ju, si komision, ne si bashki, si përfaqësues të bashkive, që të ardhurat si pjesë e grantit të pakushtëzuar duhet të jetë më e lartë për bashkitë. Për bashkitë rurale, si bashkitë tona, duhet që të shikohet, të shikohet dhe mundësia që të kompensohen financiarisht edhe më shumë, sepse burimi i të ardhurave tona është pikërisht për tokën bujqësore, sepse atë kemi bazën dhe ne nuk mund të rrisim taksat ndaj barrës fiskale për tokën bujqësore. Është e politika jo vetëm në Shqipëri, por në gjithë, në gjithë Europën, në gjithë botën, është që të subvencionohen fermerët dhe ne nuk mund të urrisim taksën. Për sa i përket çështjes së kadastrës, unë mendoj që bashkitë duhet të kenë rol në kadastrë. Duhet të kenë rol. Mund të ketë te regjistrimi i AMTP-ve, mund të ketë rol te regjistrimi i shtëpive të vjetra, mund të ketë dhe rol te, mund të ketë dhe një rol të rëndësishëm dhe te legalizimi. Pra, nuk duhet të jenë vetëm duke sugjeruar, por duhet të jenë dhe, duhet të jenë dhe vendimmarrësit. Për sa i përket të ardhurave të tjera që mund të jetë tapi dhe renta minerare, ne jemi një bashki ku Serenica njihet në të gjithë Europën dhe botën për bitumin e Serenicës. Njihet edhe për, si pjesë tani integrale e saj, edhe ka pjesë edhe naftën e ngorrështit dhe ne marrim nga renta minerare 5% të 10%-shit, pra 0.5%, ku në fakt në vitin 2013, mos të gaboju, ka qenë 25% që mirrte pushteti vendor. Kështu që ne do kërkojmë përsëri që të paktën të shkojë 25% e rendës minerare të kontribuojë pikërisht në atë vend ku ajo nxirret, sepse ne atë kemi pasuri. Siç kanë qytetet bregdetare, kanë detin dhe pastaj ato zhvillohen me ndërtime dhe marrin taksë nga ndikimi i infrastrukturës. Ne kemi pikërisht, kemi këtë mundësi financiare dhe ne duhet ta kërkojmë dhe duhet të besoj që duhet vendosur për bashkitë. Për sa i përket hartës territoriale, unë po ju them që në vitin 2025, të ardhurat e bashkisë së Serenicës janë 1.2 milionë euro. Të ardhurat e bashkisë së Serenicës dhe të njëësive administrative në vitin 2014 ishin 320 milionë të vjetër, që do të thotë nga viti 2014 në vitin 2025 ne i kemi katërfishuar. Nuk kemi rritur asnjë taksë, asnjë taksë. Pra, barra fiskale ka qenë pikërisht ajo që ka qenë në vitin 2014. Bizneset nuk mund të themi që lulëzojnë në Serenicë, sepse dihet, sepse aktiviteti kryesor ka qenë aktivitet bujqësor. Pikërisht këto janë këto fusha, këto male, këto kodra, por mënyra e menaxhimit që bashkia ka bërë ka qenë e mirë. Borxhi publik që flasim sot është 3.7% në vitin 2025. Ka qenë mbi 20%. Kështu që këto dy, dy fakte ekonomike bëjnë që bashkia e Serenicës të ketë një stabilitet financiar dhe si e tillë, duke qenë stabiliteti financiar dhe duke qenë një bashki tipike bujqësore blektorale, ne nuk mendojmë, duke marrë dhe çështjen e gjeografisë së saj, pra 561 km², mendojmë që funksionon, është mistiçioze dhe nuk mund të jetë një bashkim i një, i një njësi tjetër. Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Faleminderit zoti Dule! Jo, e kemi me Dulen e Konispolit, rrëfimdhjesë. Prapë nga Trezën. Jo, mbiemrin e kemi vetë.

Ergest Dule:

Përshëndetje dhe nga Konispoli. Atëherë, duke qenë se mbas 10 apo 11 vitesh tashmë nga 2015-a, jemi këtu për të diskutuar që bashkitë apo bashkia Konispol që unë drejtoj ka performuar për mirë, qytetarët kanë marrë shërbime më mirë apo jo. Atëherë, kjo s'ka diskutim fare. Pa drejtë, pa dyshim që jemi drejt pozitives, por jemi këtu që Konispolin dhe të gjitha bashkitë e vendit si të mund t'i bëjmë më të fuqishme, më me kapacitete, më me burime, më me pavarësi ekonomike që t'u shërbejmë qytetarëve nga të cilët ne jemi zgjedhur. Dhe nuk jam këtu për të diskutuar që Konispoli do jetë apo s'do jetë bashki. Ajo do jetë pa diskutim, sepse i bën nder të gjithë atyre banorëve që jetojnë dhe punojnë atje, po i bën nder të gjithë atyre shqiptarëve që Konispolin e kanë si pikë pelegrinazhi për diçka që ju është mohuar nga kufiri i 13-të. Atëherë, kthehemi tek reforma dhe tek pyetjet që bëri zoti Mziu. Vetë organizimi në vite e ka treguar që Konispoli nuk është një bashki e krijuar nga 2015-a. Ka qenë aty për vite me radhë. Që në 1919, është krahinori i Konispolit me 28 fshatra, 22-shin nënprefektura e Çamërisë me 34 fshatra dhe në maj të 22-shit, 1922-shit, bashkia e Konispolit që përfshin Mursiçi, Flikë, Butrint, Dhërvë, Dishatë dhe Janjër. Kthehemi te reforma e 2015-s që bëri bashkë Konispolin, Markatin dhe Njësinë Xharë. Ishin tre njësi minimalisht vetëm për ekzistencë, numri i fuqisë punëtore. Këtë ua them me bindje, sepse kam qenë drejtor ekonomik i bashkisë Konispol nga 2015-ja dhe në vazhdimësi. Pa dashur që të mohojmë punën e ish-kryetarëve të komunave apo të bashkive, e kemi me fakte që mbas 2015-ës punët në Konispol kanë ecur për mirë. Uji 24-orë, rrugë dhe drita në Konispol nuk kemi ç'ofrojmë më, përveçse një aksi rrugor rural Shalës, Dishatë, Dhërvë, që nëse mbetemi bashki, që pa diskutim do mbetemi dhe ajo do të jetë e realizuar. Uji 24-orë në të 13 fshatrat, madje dhe pompa rezervë nëpër stacione. Këto i kemi dorëzuar tek subjekti i kompetencave të përbashkëta që ne krijuam: Konispol, Xharë, Shëndëlli, Lagjere Mursi, Markati, Dinat, Janjar, Çiflik. Me investimin më të fundit, janë në 10 vitet e fundit rikonstruksione totale dhe me ujë 24-orë, ndërsa Shalës, Dishati dhe Dhërva janë bërë me të ardhurat e vetë bashkisë dhe ofrojmë ujë 24-orë në 13 fshatra. Tek fusha e arsimit, shkolla Konispol, Xharë dhe Shalës janë me kushte optimale mësimdhënie të tre të rikonstruara. Dy kopshte të reja në Konispol, një në Shëndëlli, terrene sportive në të treja shkollat. Në shkollat Markat dhe Ninat, në të cilat sot ofrojnë mësim pesë apo gjashtë, ose marrin mësim pesë apo gjashtë nxënës, për pjesën e gjimnazit, bashkia Konispol ka vendosur me të ardhurat e veta dy furgona apo mikrobuzë dhe mbledh të gjithë nxënësit dhe i sjell në Konispol, Palas, pa pagesë. Në infrastrukturën rrugore, po përmend disa në 10 vitet e fundit: rruga Shkallë-Butrint, loti i parë, Konispol, aksi nacional, rruga nacionale, fshati Markatë, fshati Markatë, Ninat, Janjar, 10 km, rruga e Digës Mursi, rruga Hirse dhe sheshi qendror Mursi, si pjesë e programit 100 fshatrat dhe sheshi qendror Konispol. Te pjesa e Mursisë dua të ndaloj pak si pjesë e programit 100 fshatrat dhe investimi që është bërë tashmë janë sot mbi 30 iniciativa ose bujtina, shtëpi private, vila të futura në Airbnb apo në Booking. Dhe kjo tregon që në qoftë se

investohet, po, aty përkthehet në ekonomi, përkthehet në jetesë, përkthehet në qëndrim në zonë dhe mos largim nga vendi. Ndryshim publik të 12 fshatrat, 100% mbulim të territorit, pastrim në 10 nga 13 fshatrat, mjet teknologjik dhe kazane për ofrimin e shërbimit dhe depozitimi në bajkaj. I them këto pasi në 2014-ën apo deri mëbrapa në 2015-ën nuk konceptohej për shërbime publike, nuk konceptohej për ndryshim publik, nuk konceptohej për shërbim pastrimi, pasi ishin vetëm dy punëtorë me çfurg dhe me një makinë gjysmë të shtrembër dhe nuk konceptohej fare si shërbim. Te funksioni i ujitje-kullimit është një nga funksionet më të mira ose më të financuara nga qeveria shqiptare, të paktën për Konispolin. Flota e ekskavatorëve për bashkitë ishte zgjidhja më e mirë për të gjitha bashkitë. Kemi bërë një punë kolosale dhe sot ekskavatori i Konispolit ka numrin më të madh të orëve të punës në republikë. E kemi të verifikuar, të verifikuar nga orët nga konçensionari që ka pasur mirëmbajtjen e të gjithë mjeteve të bashkive. Flasim për ujitjen, një investim për 10-12 milionë dollarë nga Banka Botërore Est, faza e parë, dhe është gati dhe faza e dytë për ujitje në sistem presioni në çdo parcelë dhe përdorimi i teknologjisë dhe sensorëve në ujitje. 5 km rrugë bujqësore të asfaltuara. Dhe pra, këtu jemi në Konispol, nuk jemi jashtë shtetit. Pjesa tjetër dhe më e rëndësishmja, tërë kohës në Konispol është diskutuar premtimi vit pas viti, qeveri mbas qeverie, energji elektrike. Sot po investohet nga shteti shqiptar me nënstacion 20 dhe pesë nga 13 fshatrat me rrjet shpërndarje dhe kabina të reja, i cili përfundon investimi tani. Biles, në katër nga fshatrat ka përfunduar dhe e ka dhënë efektin e vetë. Prandaj thashë që në fillim që uji, rrugë dhe drita nuk do premtojmë dot më, por do premtojmë zhvillimin e ekonomisë në një aspekt tjetër, një model tjetër: agroturizmi, turizmi dhe pse jo dhe detar, kur i kemi të gjitha kushtet për ta ofruar atë. Dhe të gjitha këto janë bërë nga stafi jonë, sepse presupozohet që bashkitë e vogla s'kanë staf, s'kanë inxhinier, s'kanë arkitekt, por ama ne kemi arritur ta bëjmë të mundur dhe këtë, dhe me rritjen e pagave kjo bëhet e mundur që ne të kemi stafin më të ri, ndoshta dhe në republikë, 30-35 moshë mesatare e stafit. Nëse do flasim për shifra, foli kolegu Nertili nga raporti i monitorimit të fundit miratuar dhe raportuar në Këshillin Bashkiak. Jemi te 2% detyrime. Të ardhurat janë dy trefishuar më saktë, sepse në vitin 2014, të treja njësisit bashkë gjeneronin 22 milionë lekë të reja, duke përfshirë këtu dhe tarifën e ujësjellësit, e cila në atë kohë në Konispol paguhej në bashki, sepse s'kishte shoqëri aksionare. Sot janë trefishuar po ashtu dhe investimet nga të ardhurat në ato shifra minimale që mund të jetë për Konispolin. Ajo që dua të theksoj më tepër është i raporti i performancës ose grandit i bazuar në performancë, i cili e renditi Konispolin të tetin. Shtatë më shumë bashki se Konispoli kanë marrë më tepër fonde dhe gjashtë kanë marrë njësoj si Konispoli. Dhe kjo, pa diskutim, besoj se jep përgjigje të gjitha atyre pyetjeve që bëri zoti Mziu. Por ajo që dua të shtoj është tek pjesa e kadastrës urbane. Nuk dua ta quaj kadastrë urbane, por dua ta quaj kadastrë rurale, pasi bashkia që përfaqësoj unë është bashki rurale. Të mendohet që çertifikimi i tokës bujqësore të ketë një variant që bashkitë rurale ta ofrojë vetë si shërbim në bashki. Transferta 1% nuk është e mjaftueshme, por ajo që do të jetë mbi 1% të jetë e kushtëzuar për investime. Mos të shkojë as për paga, as për shpenzime operative. Çfarë do të jetë mbi 1%? Të jetë vetëm për investime e kushtëzuar dhe pastaj vendimmarrjen ta bëjë Këshilli Bashkiak në bazë të prioriteteve dhe dëgjësive publike nëpër takime. Ishte pyetja në lidhje me numrin e fuqisë punëtore që është bërë një rritje e pajustificuar dhe fondi i pagave i rritur, të cilën e

diskutoi dhe vetë që është rritur nga rritja e pagave, por dhe nga rritja e numrit të fuqisë punëtore. Tani, të gjitha këto shërbime që përmenda unë më lart hyjnë tek kodi ekonomik 600 e ditë. Të gjithë, një pjesë e mirë këtu e dinë: pastrimi, ndriçimi, mirëmbajtja, ku di unë, të gjitha me radhë hyjnë tek shpenzimet operative. Natyrisht që duhet të ketë rritje. Tek pjesa e MZSH-së si zjarrfikëse, pa dyshim që Konispoli hynte ato bashkitë që u krijuan stacione zjarrfikëse më mbrapa, por realisht nuk u shoqëruan në atë kohë me fonde mjaftueshme për të krijuar stacione për të blerë mjetet e duhura. Por ama a jemi më mirë kur e kemi një stacion me 16 veta efektive aty, apo ishim më mirë kur na e ofronte Saranda si rreth, gjithë rrethin e Sarandës si shërbim? Pa dyshim që jemi më mirë. Nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, ne kemi aplikuar dhe marrë projekte në lidhje me parandalimin e fatkeqësive natyrore. Ajo që dua të shtoj këtu është që bashkitë e vogla mos të kenë të njëjtin garë me bashkitë e mëdha. Nuk mund që Konispoli të garojë në një thirrje kombëtare, po them me Tiranën. Kjo është asimetria. Në lidhje me pyjet dhe kullotat, ato u transferuan nëpër bashki dhe bashkitë gjenerojnë të ardhura ato minimale vetëm nga qeradhënia e kullotave, sepse plani i mbashtrimit për pyjet është i kushtueshëm për bashkitë sot. Por ama, kur u transferuan në 2016, në mos gabo, u transferuan me plane menaxhimi të skaduar ose ishin drejt marrimit. Te rrugët rurale duhen më tepër fonde. Konispoli, në inventarin e rrugëve rurale, kishte gati 27 km rrugë dhe financohet me 16 apo 19 milionë lekë të vjetra. Kjo duhet të barazohet financimi një për kilometër, njësoj siç e bën RSH-ja, prokurimi për mirëmbajtjen e rrugëve të saj. Të njëjtën gjatësi rruge, RSH-ja e prokuron shumë herë më tepër nga ne dhe ne duhet t'i përgjigjemi vetëm me paga dhe sigurime shoqërore për stafin e fuqisë punëtore të transferuar në atë kohë nga këshillat e qarqeve. Po të vazhdoj, do lodheni dhe ju, se e kam 10-12 vite eksperiencë aty dhe nuk dua që t'i konsumojmë kështu në apriori. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Ëh, zoti Vëngu ka kërkuar fjalën.

Pirro Vengu:

Faleminderit, kryetar. Faleminderit që i thatë dhe një një trajtë kuptimplotë të gjithë bisedimeve. Duhet të falenderoj dhe të gjithë kryetarët nga qarku për sinqeritetin në identifikimin e problematikave, por edhe të rekomandimeve të tyre. Ëh, një koment dhe dy pyetje për grupin tonë nga Vlora. Komenti i parë u përmend nga të gjithë kryetarët e bashkive dhe nga vetë eksperiencia ime në këtë fushë. Ëh, përta i përket përlllogaritjes së fondeve të kushtëzuara, kemi tashmë dy modele. Kemi një model sipas përlllogaritjes në bazë popullsie dhe kemi një model sipas përlllogaritjes në bazë risku apo në bazë nevojë. Ëh, a e gjykoni të gjithë? Besoj se ky model duhet të shpërndahet dhe në fushat tjera. E dëgjova nga njëri prej kryetarëve ta përmendin. Është personalisht dhe mendimi im, sepse ë duhet kuptuar që një investim në infrastrukturën parandaluese të Delvinës është dobiprurës dhe në pjesën parandaluese në Sarandë dhe për pasojë nuk duhet të shohim vetëm konkurrencën mes bashkive për t'i marrë këto fonde, por duke ndihmuar një bashki mund të ndihmojmë në mënyrë të qëndrueshme të gjithë pellgun. Elementi i dytë, nëse kryetarët gjykojnë se na duhet të kemi një nivel të dytë të ndërmjetëm përta i përket

menaxhimit të krizave dhe emergjencave, ë kam parasysh faktin që bashkia është patjetër ajo që reagon e para, është më pranë, ka përgjegjësinë e parë dhe pastaj kemi reagimin fundor nga Ministria e Mbrojtjes dhe forcat e armatosura. Mos ka ardhur momenti që të kemi një nivel të ndërmjetëm që shkon përshtat edhe me debatin e iniciuar në vetë komision përta i përket krijimit, pse jo, të rajoneve, duke pasur parasysh edhe njëherë që patjetër kam parë solidaritet të lavdërueshëm midis bashkive, veçanërisht në jug të qarkut për menaxhimin e emergjencave, por ndoshta ka ardhur koha që ta institucionalizojmë këtë pjesë dhe pse jo të institucionalizojmë dhe qeverisjen e këtij lloj bashkëpunimi. Ëh, dhe për ta ilustruar, kemi në qarkun e Vlorës ndoshta bashki që kanë të ardhurat më të larta për frymë në nivel, në nivel vendi pas Tiranës, por kemi dhe bashki me financa shumë modeste, rasti i Selënicës dhe rasti i Delvinës. Pra, ndoshta duhet solidariteti, ky solidaritet duhet institucionalizuar dhe duhet mirëqeverisur, sepse besoj dhe unë që në qoftë se Saranda ndihmon të financojë projekte në Delvinë, është në interes të Sarandës, sepse gjithë fuqia punëtore që mbështet turizmin në Sarandë vjen dhe nga Delvina, gjë që vlen po ashtu edhe në rastin e Vlorës dhe të Selënicës. Dhe një përgjigje të shkurtër për kolegun që përmendi kohën e lavdishme kur njësia e tanishme e Orikumit ishte bashki, patjetër që edhe mua si vlonjat dhe si deputet posaçërisht i zonës Çagjaz, Dukat, Orikum, Radhim, më përkëdhel sedrën, pa dyshim. Por fakti është që në këtë dekadë të fundit, pas reformës 2015-s, në qoftë se shohim investimet për frymë dhe në qoftë se shohim investimet nga njësitë vendore, por kryesisht dhe nga agjencitë qendrore si Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ka një rritje eksponenciale përta i përket financimeve në këtë zonë, pavarësisht se ajo nuk është më një bashki më vete, por është një njësi, një njësi e Vlorës. Sikundër, bie dakord patjetër dhe me kolegë të opozitës që nënvizuan faktin që tashmë kemi një sfidë tjetër. Kemi sfidën ku kemi patjetër një radhim dhe një Orikum ndoshta më të zhvilluar për efekt të turizmit, për efekt të këtyre financimeve qendrore, dhe sfida tani është të hyjmë në interland, të hyjmë në ato zona ku sjellim, sjellim cilësinë e shërbimeve që ka bregdeti dhe në të njëjtën mënyrë edhe për bashki siç janë Konispoli, Delvina dhe Selënicë. Ju falenderoj.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Ëh, kryetarët, cili do të përgjigjet?

Nertil Bellaj:

Meqënëse, po, zoti, meqënëse unë e nica, edhe unë, edhe unë jam shprehur dakordësinë me mendimin të deputetit ku transfertat e kushtëzuar sektoriale duhet të ndryshojnë dhe duhet të jetë në bazë të riskut dhe të nevojave. Po u kthehem vetëm një fakt, është mirëmbajtja e rrugëve rurale. Rrugë rurale, bashkia e Selënicës mund të ketë mbi 200 km, mbi 200 km, dhe fondi që ne marrim është 3 milion, 3 milion lekë ose 30 milion lekë të vjetra. Nuk mundet që me këtë fond ne t'i mirëmbajmë rrugët rurale. Rrugët rurale janë jetike, janë jetike, sepse lidhin, lidhin fshatra, lidhin toka, lidhin njerëz, lidhin jetën. Kështu që besoj që duhet që fondet duhet të kushtëzuar, duhet të jenë në bazë të nevojave që kanë vërtetë bashkitë dhe duke i selektuar. Pra, edhe llojet e bashkive, bashki rurale, bashki turistike, nuk më duhet mua lekë për det e shumë lekë për gjëra të tjera, mua më

duhen lekë për, pra, fonde për rrugë rurale, për toka, për vaditje dhe për zhvillimin e bashkisë në aspektin e zhvillimit të turizmit malor. Përsa i përket pikës së dytë që ka të bëjë me një nivel të dytë që ne sot kemi qarkun, po nesër mund të ketë një opsion tjetër, mund ta quhet rajon. Ne sot kemi një fond 2%. Pra, 2% e të ardhurave tona duhet t'i shkojë në qarkun. Unë mendoj që kjo 2% duhet ta bëjmë me thesar t'ua marrim bashkive. Ne të voglat i japim, ndonjëherë të mëdhatë nuk i japin. Mendoj që këtë 2% duhet automatikisht, pra, në qershor, gjashtëmuorin, t'u kalojë, t'i kalojë qarkut dhe qarkut të arrijë shpërndarje te bashkitë që kanë më shumë nevojë, sepse vërtetë ne, ne nuk kemi të ardhura, po qytetet e mëdha si Saranda, si Vlora, si Himarra, po edhe ata fshatarët e hanë vera, djem, lahen në det dhe ata hanë bukë dhe ata në restorant. Pra, nuk popullohet vetëm nga banorët aty, pra, popullohet, popullohet dhe nga banorët tanë, po dhe shumë banorë të këtyre qyteteve kanë tokat, se kur i shndanë në vitin '92, '93. Toka, një fshat ka pasur 300 familje, pra ka 300, të paktën ka 300 AMTP. Tokat i kanë atje, i ka mbjellë ulli, i ka mbjellë frutikulturë, i ka mbjellë Jonxhi, i ka mbjellë misër. Verën, fundjavë, dhe ata, dhe patjetër që edhe ata kontribuojnë në qytet, dhe është një mënyrë që bashkitë e mëdha të bëhen pak më altruiste dhe ne bashkitë e vogla të na ndihmojnë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Po, zoti Veli,

Besmir Veli:

Duke pa dashur të të përsëris ato çfarë tha kryetari i Selënicës, edhe unë jam dakord për ato çfarë tha ministri, ish-ministri, më falni, deputeti i qarkut të Vlorës. Ëh, ëh, një gjë që ne kemi ngritur një mekanizëm të bashkisë së Sarandës, po dhe Himarës, ëh, këtu me këshillin e qarkut të Vlorës, është që bashkia e Sarandës, që ka dhe buxhet më të madh, i ka, i ka kaluar fonde e këshillit të qarkut të Vlorë, po ashtu edhe bashkia e Himarës, dhe kemi bërë të mundur që në bashkinë e Delvinës të bëjmë një investim. Pra, dhe ky është një mekanizëm që ne e kemi aplikuar jo vetëm këtë vit, por edhe gjatë tre viteve të tjera që unë kam qenë në krye të kësaj bashkie. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Çaçi.

Oltion Çaçi:

Po, dhe unë do të shtoja diçka, në fakt, nga problematika që ka zona jonë. Në vitet e fundit është bërë e ndjeshëm, të thoj, zjarret që po ndodhin në zonë. Kjo vjen dhe si efekt i, le të themi, i numrit të vogël të popullsisë në zona malore dhe jo mirëmbajtjes së, duke pasur pemë të shtuara. Ëh, ne, në fakt, nisëm, ne nisim një bashkëpunim bashkë me qarkun dhe edhe me AKMC-në dhe me Ministrinë e Mbrojtjes për të krijuar një qendër rajonale emergjencash. Ëh, meqë këtu do kërkoj edhe ndihmën tuaj, në fakt, si deputet, që ajo qendër të realizohet, sepse është shumë efektive për të bashkëpunuar të gjithë të katër-pesë bashkitë që jemi në zonën, duke qenë që zjarret në atë zonë sa vijnë dhe shtohen, jo sa vijnë dhe pakësohen. Kjo është shumë e rëndësishme për ne. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Po, mbaruam. Atëherë, ëh, e ka zoti Leskaj.

Bujar Leskaj:

Të jem i sinqertë, unë erdha për të dëgjuar, po u motivova dhe do bëj nja dy dhe replika miqësore, pak kështu. Së pari, njerëz, do ta filloj me shumë seriozitet. Më vjen mirë që të gjithë ju, kryetarët e bashkive të qarkut të Vlorës, e keni vlerësuar këtë dëgjim të komisionit edhe deputetët e qarkut të Vlorës. Për këtë, sinqerisht, më vjen mirë. Besoj dhe kryetarja e Vlorës do ketë ndonjë arsye pune. Ëh, këtu tani, të nderuar deputetë, kryetari i bashkisë i Selënicës, me të drejtë, artikuloi që tarifa, taksa, renta minerare nga 5% duhet të kalojë në 25% në të ardhurat që kalojnë për bashkitë, për njësitë vendore. Dua t'ju kujtoj këtu që unë kam paraqitur këtë ndryshim, e kam paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë, dhe ai ndryshim shkon në dy projektligje paralelisht që kërkohet, dhe ju nuk e keni votuar, për fat të keq. Ndoshta duhet të shikojmë një formulë që ta paraqesim së bashku, me shumë dëshirë, me zotin Lajo, mund ta paraqisja që ta votoni. Por në rast se ju do jeni vërtetë aq deputetë i fortë si jeni dhe në jetë te kryeministrit e te qeveria, që ta kalojnë bashkitë, e kërkojnë, dhe sidomos bashkia si Selënicë e ka shumë të nevojshme. Vërtet, ajo e ardhura nga renta minerare s'ka kuptim të jetë 5%. Duhet patjetër 25%. Bashkia e Selënicës është një bashki e pasur, në qoftë në bitum, po qoftë edhe në naftë. Jo, tani e dyta, me zotin Tavo, që është një, po them, një drejtues me përvojë, se po të thoja lojtar me përvojë, mund të keqkuptohej, po i drejtues me përvojë, deputet me përvojë, dhe unë ju kam vlerësuar. Po, kisha një pyetje të drejtpërdrejtë. Në rast se partia juaj do, se këtu jemi dhe në një sallë me kështu, emër me konotacion shumë negativ të vjetër, por në mënyrën si po e formuloj unë, në rast se partia juaj do vendosë që numri i bashkive të ulet dhe të kalojë në 32 bashki, dhe me këtë formulë bashkia e Himarës bashkohet me Vlorën, ju do thoni: "Partia ime e di si mos të kalojë te, te, te qoftë largu, të sjellë një paralelizëm që nuk qëndron," dhe do votoni pro. Dhe një të dytë, prapë, edhe kjo është shumë, shumë kështu, se ju folët edhe vërtetë unë ju përgëzoj për atë që keni investuar në njësinë e Vranishtit, në Kuç Vranisht, në njësinë e orë Vranishtit, 10 milion euro, thatë, në mos gabo, dhe pa dyshim keni bërë shumë mirë, se ishin, si me thënë, premtime të pambajtura në vite e vite ndaj kësaj zone nga partia juaj. Po kaloj gjithmonë, ju s'jeni shumë partiak, po. Shumë më pëlqen mua t'ju drejtojem. Po keni bërë ndonjëherë llogari? Po të futemi me atë filozofinë e te tregtari i Venedikut, e Shekspirit, meqënëse e brendtë janë bërë në modë sot. Po keni bërë llogari sa kushton ai uji që ju po i merrni, po i grabisni lumit të Vlorës për oligarkët në Himarë? Meqënëse ju jeni dhe i mirë në llogari që të nxorët dhe këtë 455-vjeçin, që ajo qëndron dhe vlera në kohë e parasë, se është formulë ajo, t'ju ndihmoj unë. Po këtë tjetrën. Tani, përse ne, dhe këtu dua të vazhdoj me një nga qëllimet kryesore që kam unë, të paktën si deputet i Vlorës, dhe që e kam artikulluar dhe më kryesorja si qytetar i Vlorës, qarku jonë ka nevojë të shtohet numri i bashkive, dhe nga më e para, nga më e para, në shtimin e numrit të bashkive për të shkuar te qytetari, është bashkia e Orikumit. Dhe përse shumë mirë që është Himara bashki me ato resurse, shumë mirë, përse mos të jetë Orikumi bashki, së bashku me Tragjasin, Dukatin, Gadishullin e Karaburunin, etj.? Përse, përse mos të jetë? Çfarë kuptimi ka? Ne në 2015-ën, kjo është një nga gabimet kryesore

që është bërë te reforma. Është një nga gabimet kryesore, dhe Himara me rreth 10 mijë banorë, pa dyshim, duhej bashki, ashtu si duhej bashki dhe Konispoli, që nuk diskutohet, Delvina tradicionale, dhe është shumë mirë, edhe kryetarët dhanë shembuj, dhe janë qytete të shënuara në historinë e Shqipërisë, ashtu dhe Selënica. Po përse mos të jetë Orikumi? Dhe në rast se ju flisni dhe thoni: "Kanë qenë investimet në rritje eksponenciale në Orikum," në fakt, në fakt, e heqja si bashki, kalimi në një status më të ulët, njësi administrative e bashkisë, me bashkinë në Vlorë, Orikumin dhe gjithë zonën e ka kthyer mbrapa, edhe turizmin në këtë zonë. Unë ato, të paktën këtë të Orikumit, e kam patur edhe ose dhe të zonave, dhe kur kam qenë në detyra të tjera, po duke filluar nga 2021-shi, kam qenë permanent, edhe rikthimin tim në politikë e fillova me një artikull që e kam botuar te gazeta sot, "Domosdoshmëria e kthimit të Orikumit në bashki." Nga ana tjetër, në ato projektet tona dhe që kemi artikuluar në këto vite, në takime të ndryshme, edhe në qoftë në fushata elektorale, apo dhe kur nuk kemi qenë në fushata elektorale, takime zyrtare partiake, dhe me pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve, janë që edhe zona e Topalltisë ka nevojë për bashkinë e vetë. Novosela dhe gjithë ato fshatrat kanë nevojë për bashkinë e vetë. Dhe lumi i Vlorës, gjithë, po themi, krahina e lumit të Vlorës, ka nevojë për atë, për bashkinë e vetë, me qendër në njësinë administrative Kotë, po bashkia Amantja. Bashkia Amantja. Këto janë propozime që ne i kemi artikuluar, i kemi artikuluar në Kuvend, i kemi artikuluar në takime me qytetarët, kemi gjetur atë mbështetje tek qytetarët. Nuk kemi patur mundësitë, pse nuk kemi patur fonde, nuk kemi patur votat, nuk kemi marrë votat e mjaftueshme, për të qenë të sigurtë. Po unë do t'ju kërkoja juve, të nderuar anëtarë të komisionit, të nderuar bashkëkryetar, t'i keni në vëmendje këto propozime tona, këto propozimet tona. Ja u përcjell si qytetar i Vlorës, si qytetar, unë jam lab, në fakt, ndonjëherë e përdor, jam lab boçam, edhe ti, së bashku me atë propozimin tonë për Ksamilin bashki, t'i keni në vëmendje, t'i trajtoni me përgjegjshmëri të lartë për të arritur në atë që ne, dhe formula gjendet dhe në variantet që ka, që unë kam lexuar në fillim, në mos gaboj, një duhet të ketë qenë shkrimi i bashkëkryetarit Mazniku. Gjendet ajo formula e përbashkët që mund t'i bashkojë të dy qasjet tona, që dhe të shtohet numri i bashkive, në atë numër 94 apo 95 që ne kemi kërkuar, si Parti Demokratike, si deputet, si anëtarë të parlamentit, dhe ato objektivat, qëllimet që ju keni me këtë reformë, e cila, për hir të së vërtetës, është reformë e domosdoshme, është reformë për të gjithë bashkëqytetarët tanë, se në fund të fundit, njësoj kur themi ne që Orikumi, Dukati, Tragjasi ka pësuar regres, nuk janë vetëm ata që janë demokratë, kuptohet, janë dhe socialistët, janë dhe ata që janë pa parti, që janë dëmtuar në këto vite. Në rast se do kuptohet kjo nga ju, deputetë të nderuar, unë mendoj që edhe produkti i komisionit tuaj do jetë, do jetë një produkt progresiv, do jetë një produkt që vërtet, vërtet do ketë, ju do jetë i dobishëm për shoqërinë. Ju i keni zhvilluar aktivitetet shumë mirë, falë bashkëdrejtimit të dy kryetarëve, pavarësisht që unë, si deputet, kam patur një mendim tjetër, por nuk ka, i keni, e keni zhvilluar këtë proces shumë mirë. Reforma, përderisa është domosdoshmëri, duhet, domosdoshmëria nënkupton që duhet të shkojë tek qytetarët, tek zhvillimi i zonave tona. Ju faleminderit dhe ndjesë nëse u zgjata. Kuptohet, ato të fillimit ishin miqësore, edhe mund të mos të përgjigjesh, Tavo, mos u vij në pozita. Mirë, s'ka problem.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Leskaj. Fillimisht kam përshtypjen që po, zoti Tavo. Jo, ishte zoti Balili, sikurse një, apo zoti Tavo, njësoj, s'ka rëndësi, se si u përmend Selincë në fillim, në rregull, s'ka rëndësi. Z

Vangjel Tavo:

Jo, meqë, meqë më përmendi, besoj se rregullat e parlamentarizmit ndiqen dhe në komision, domethënë, kam të drejtën e replikës, apo jo? Jo, kisha dhe pyetje specifike.

Arbjan Mazniku:

Edhe të përgjigjes, patjetër.

Vangjel Tavo:

Do përgjigjem mirë, do përgjigjem mirë, do përgjigjem. Dhe do e nis, dhe do e nis, do e nis nga fundi, në fakt, nga pyetja: sa kushton uji? Uji nuk ka vlerë. Uji nuk ka vlerë, është elementi, është, ja po jua them unë, është, është, është i paçmueshëm, pra, atë po them pra. Nuk ka çmim, pra, atë po them pra, është i, pra, nuk ka nivel vlere, se më pyetët sa kushton, është i paçmueshëm. Atëherë, atëherë, atëherë, vetëm, vetëm, vetëm të kuptojmë një diçka, se është keqpërdorur fakti i ujësjellësit të lumit për gjithë Himarën. Nisi si proces para se unë të shkoj kryetar bashkie, dhe kur u bëra kryetar bashkie, pjesë e së cilës është dhe Kuçi, dhe kam pasur jo një herë, po disa herë takime me Kuçin, asnjëherë Kuçotët nuk kanë qenë kundër bërjes së ujësjellësit të, le ta quajmë, të Kuçit, atë të lumit, në rregull, s'ka rëndësi emri, asnjëherë nuk kanë qenë kundër, përkundrazi, patjetër, me të drejtën e tyre, thoshin që ore të bëhet ujësjellësi, ta marrin patjetër ujin, s'është, uji nuk është privat, por ama duam dhe ne, por ama duam dhe ne, me të drejtë, me të drejtën e tyre, thamë duam dhe ne këtë gjë, pra ujësjellësin tonë, duam dhe ne ujësjellësin e buronjave, duam dhe ne kanalën e vaditës, të gjitha këto që i kërkuan, të cilat sot kanë përfunduar, janë, buronjat jo vazhdojnë, por dua të them të tjerat kanë mbaruar, me shumë të drejtë, por është keqpërdorur, instrumentalizuar shumë keq fakti që jo, nuk duan ata, nuk është e vërtetë. Kështu që, nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme dhe zhvillimi ekonomik, sepse nëse uji nuk do shkojë në Himarë, ky zhvillim ekonomik që ka ajo zonë, pjesë e këtij zhvillimi janë këto të ardhura që ne po mbledhim vazhdimisht dhe po investojmë në këtë zonën tjetër, pra në njësinë e orë Vranisht, pra janë të ndërlydhura njëra me tjetrën dhe të pandara, është e pamundur t'i ndajmë. Tani, përse i përket Orikumit, që nuk është, në fakt, nuk më takon mua, por thjesht, megjithëse dëgjova regres, unë kam qenë para ca ditësh rastësisht me një mikun tim në Orikum, dhe më bëri shumë përshtypje, qoftë investimet madhore që janë bërë në infrastrukturë, por qoftë dhe investime private në Orikum, kështu që realisht mund të them që ka pasur progres në Orikum. Tani, se çfarë duhet, si duhet, nuk është çështja ime të flas për Orikumin. Tani do vij, tani do vij, tani do vij tek pyetja e parë e juaja, dhe besoj nga renditja e pyetjeve, kjo do të jetë e më kryesorja, apo jo? Atëherë, e ujit, e ujit, besoj, kam qenë shterues. Tani të vijmë tek pyetja nëse Himara nuk do të jetë më bashkithat, apo jo? Pra do të ndahet, do të kalojë me Vlorën. Atëherë, atëherë, atëherë, faleminderit që e thatë dhe ju, që unë nuk jam vërtetë shumë partiak, sepse për mua partia ime janë njerëzit, edhe kur kam qenë

deputet, dhe tani kur jam kryetar bashkie, dhe po ju them, unë e thashë pak në fjalën time në fillim, që padyshim komisioni duhet të ketë parasysh, dhe e kam parasysh, tek kur të vijë momenti i ndarjes administrative, duhet të kem parasysh historinë, traditat, shumë e shumë elementë, të cilat janë shumë të rëndësishme dhe për t'i quajtur edhe të domosdoshme për të bërë ndarjen e re administrative. Thashë dhe çfarë kam bërë në 2014-ën, dhe nuk dua ta përsëris, por do them diçka tjetër. Mua më vjen kategorik kundër ndarja, pra heqja e Himarës, emrit Himarë, nga harta e bashkive të Republikës, dhe jo thjesht, dhe jo thjesht, dhe jo thjesht, dhe jo thjesht, jo, nuk ka lidhje fare me shkurtimin e numrit. Jo, jo, jo, jo, absolutisht jo. Flas Himarë, flas Himarë, Himarë. Tjetër gjë të shkurtosh numrin, dhe tjetër gjë të flasim Himarë. Jo, jo, jo, jo, jo, më mirë kuptoni. Tjetër gjë shkurtimi i numrit, se janë, nuk e vendosim ne këtu sot do shkurtohet, apo jo. Është një analizë, besoj që komisioni do ta bëjë i pari, pastaj parlamenti, se çfarë do bëhet me numrin e njësive administrative, pra të bashkive, më falni. Kështu që unë flas për Himarën, dhe po ju them që nëse kjo do të ndodhi, meqë më pyetët se çfarë do bëj, a do respektoj vullnetin politik të partisë, apo jo, mua, domethënë, unë do largohem, jo nga Himara, por nga politika përfundimisht. Besoj jam i qartë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Po, po një replikë mund ta bëni.

Bujar Leskaj:

Prapë jemi te, jemi te replikat miqësore, zoti Tavo. Ajo deklarata ishte shumë e fortë, po s'ka gjë, ja u besoj. Po tani do ju një gjë tjetër. Mbas gjithë atyre ëndrrave që pati Galileu Galilei në fund, që tha: "Epur si muave," më falni për theksin, ë? E megjithatë ajo rrotullohet. Tani unë ju them një gjë, pavarësisht edhe deklaratat tuaja ishin shumë të mira, këto sqarimet, rrrrr, ju falenderoj, po megjithatë, zoti Tavo, ju e grabitët ujin e lumit të Vlorës. Fshatarëve të lumit të Vlorës, ja u keni grabitur atë pasuri, dhe ajo ka pasoja në të gjitha fshatrat e lumit të Vlorës. Tani këtu po e mbyll unë, dhe nuk bëjmë më replika.

Klevis Jahaj:

Për ta vazhduar pak, një pyetje kam unë. Ju, zoti Tavo, në qoftë se zgjerohet bashkia Himarë, do të ishit pro apo kundër e kësaj?

Vangjel Tavo:

Për të ardhur, sepse paraprin replika, besoj se mos harrohet pastaj. Meqë thatë, megjithatë rrotullohet, me sa shikoj unë, opozita e ka në plan që ta shkrijë Himarën. Kështu që tani, tani, fjala grabitje, po jua them sinqerisht, po jua them sinqerisht, uji, uji, jo vetëm që nuk është grabitur, por përkundrazi, ujë, ujë në lumë ka bollë, edhe për nevojat që pretendonin ambientalistët, të cilët nuk i pashë gjëkund këto kohët e fundit, nuk e di nga u zhdukën, nuk i pashë gjëkund sepse janë zhdukur. Sinqerisht po ju them dhe arsytet pse pretendonin dhe protestonin, besoj janë të qarta, mos t'i bëj unë këtu publike. Kështu që uji i domosdoshëm për njësinë e Himarës, dhe jo vetëm për Himarën, nëse do duhet, por pse nuk pretendon dhe Borshi, që po ia jep ujin që parojë? Nuk flet një Borshi, pse

nuk flet? Çka ka të keqe, domethënë, që uji, uji si burim natyror, që nuk është pronar as fshatari në të cilin është burimi, as, as, po jo, po kështu është. Pra tani, jo, jo, nuk flas më, domethënë, nuk është absolutisht, nuk pajtohem me fjalën grabitje. Uji, uji, ujësjellësi i Himarës, i cili akoma nuk ka filluar të funksionojë, pra është në test, është në provë, është në provë, për ditët e ardhshme pritet që të futet në funksionim. Është për mua vepra më e mirë që është bërë ndonjëherë në atë bashki, dhe që do t'i shërbejë jo vetëm komunitetit, por edhe investimeve dhe turistëve dhe vizitorëve të ndryshëm që janë shumëfish në Himarë gjatë sezonit të verës.

Edhe njëherë, mos më vjen keq që kompetencat tuaja po ia kaloni kryetarëve të bashkive. Nuk besoj se është ky qëllimi i mbledhjes që të na pyesni: "Ju jeni dakord me bashkimin apo me zgjerimin apo zvogëlimin e bashkisë?" Mua unë ju përgjigja diçkaje sepse sepse ka të bëjë me votën time të 2014-s. Kjo ishte arsyeja pse u përgjigja.

Luçiano Boçi:

Atëherë, ëh, ja një një sqarim të vogël. Sepse u fol në emër të opozitës, ndërkohë që në emër të maxhorancës refuzoi të flasë, apo jo? Jo, po s'ja dhe përgjigjen. Tani në emër të opozitës nuk mund të flasësh, të rrekesh. Po mirë mor, burrë, je pa mikrofon tashi. E bëjmë, e bëjmë, pasi të mbarojë mbledhja. Tani ti rrekesh të gjesh çka në mendje opozita dhe të na japësh këtu si formulë që ne do shkrikemi Himaren. Së pari, ne qëndrimin tonë politik e kemi shprehur qartë. E shprehu dhe Bujari. Jemi për shtimin e bashkive. Pra, jo për shkrirje. Shkrirjen e ke nga ky krahu këtej i jot, megjithëse ti je apolitik. Harrova. Por përgjigjen e shmang nga krahu jot. Sqarojmë dhe opinionin se do me bë lajm. Ti e kuptoj shumë mirë unë këtë gjë se po jo lajm që opozita kërkon shkrim i marrë. I di dhe flukset e kësaj deklaratë dhe nuk është e mirë dhe e drejtë që, domethënë, bën deklaratë të tilla. Aspak edhe e mirë, aspak dhe e mirë. Jemi jo vetëm për të shtuar i marrën, por edhe orikumin, edhe mifolin, për trujt, edhe konispolin, për trujt, edhe selenicën, sepse dhe atë pyetjen që bëjmë ne është kompetencë e juaja të përgjigjeni. Jeni për bashkim bashkish apo për shtim apo për ruajtjen e statukuos që është? Është e drejta jonë t'ju bëjmë pyetje dhe është, besoj, detyrë morale, qytetare, politike, bashkiake që të na përgjigjeni. Pra, t'i sqarojmë gjërat këtu. Dhe pyetjet e Bujarit ishin shumë të sakta, por dhe qëndrimi i opozitës është shumë i saktë. Ndërkohë që keni dëgjuar dhe opinionin politik të maxhorancës për bashkimin e bashkive, për përthithjen e bashkive të vogla nga bashkia e madhe ose kalimi tek niveli i rretheve dikurshme 25, 36, nuk ka rëndësi sipas viteve. Dhe në këtë rast, edhe pyetja që erdhi nga ana e maxhorancës ishte në këtë drejtim dhe duhesh një përgjigje shumë e saktë, sepse sot ju keni njësi administrative, jeni kryetarë bashkish dhe ata kryetarët e njësisive, domethënë, as i pyesni fare, asgjë. Dikush do i pyetë, nuk po them, po në tërësi po them gjithë Shqipërinë, se ato emrohen nga ju, nuk zgjidhen nga populli, s'kanë autoritetin, s'kanë kompetencat e mëdha, etj., etj. A e mendoni që kur të ndodhi ai bashkimi, bashkitë e juaja, s'po themi ju se nuk e kam personale, do jenë njësi bashkiake administrative dhe kryetari i njësisë bashkiake administrative, po presupozoj selenicën, se ka temperaturë shumë të lartë konispoli dhe kurrsesi s'e mendoj që mos ekzistojë? Do jetë i emëruar, mos do ketë asnjë lloj kompetence, do jetë në këtë nivel. A e kuptoni? Ne duam, ne po ndajmë këtë shqetësim me ju, sepse sigurisht edhe

Ksamili, pse mos jetë më vete me logjikën e i marrës, sepse ka të ardhura, ka të zhvillohet, mo, që ka fleksibël, që ka shumë mirë ajo që të ekzistojnë me 10.000 banorë, njësi bashkiake me të ardhurat e veta, me mbështetje nga grantet, zhvillohet. Orikumi janë bërë investime, por pyetja është: po sikur të ishte më vete me të ardhurat e veta, nuk do bënte më shumë investime, po më do bënte më shumë, sepse mesatarizohet investimi në Vlorë, futet dhe orikumi dhe Vlora. Qytetari që është në Vlorë, nivelin e investimit e ka më të madh se ai që është në orikum. Po kur e bëjmë mesatare, ne del e lartë. Jo, mo, mund të qëndrojmë më vete dhe ta ketë dhe ai po aq lartë sa ai i Vlorës apo sa ai i Himarës. Pra, e bëra për sqarim të deklaratës suaj për Himarën. Jo, jo fare, se ka opozita të shkrijë Himarën. Do ekzistojë Himara, sepse e insiston dhe opozita dhe është logjike, por duhet të rregullohen ca elementë që ne do i nxjerrim nëpërmjet pyetjeve. Largësia, se s'na folët për lartësinë për qytetarin, për nivelin e shërbimeve, për përfaqësimin, se këto janë elementët kryesorë. Më ju i dini shumë mirë. Tashi, hajde të rrudullohemi nëpër të kapemi degë pas dege. Nes, hajde të bëjmë deklarata politike. Nuk, nuk na vlen. Domethënë, kështu që ju lutem na i kurseni edhe këto qëndrimet që ne vazhdojmë t'i mbajmë të tilla, ndërkohë që jepini përgjigje pyetjeve pa paragjykime. Faleminderit.

Vangjel Tavo:

Tani, diçka që është në tagrin e Kuvendit, të Komisionit dhe të Kuvendit, mos na pyesni neve se ju thoni njësi të administrative, kryetarët i emëroni ju. Po bëheni më me zgjedhje? Ju e keni në dorë. Bëheni më me zgjedhje? Çfarë keqe ka? Zgjidhen. Ju e keni në dorë, mo. Bëni këshilltarët, po të doni me zgjedhje, mo, siç i ka bota. Bëjeni. Çfarë problemi ka? Ky është problemi. Po nuk besoj se ngërçi është e kjo si do bëhen me zgjedhje apo jo. Ju problemin e keni politikën, vëlla. Si do bëhet, si do i marrin votat, si do ndryshojë, se po të ishte interesi për njësitë administrative dhe për bashkitë, sinqerisht, ja më e po ja them unë, ju, ju opozita, këtë kam dëgjuar unë gjatë gjithë kësaj kohe. Në rregull, 14-ta është bërë reformë vetëm për vota. Po s'është e vërtetë se 14-ta sollti ato që unë i përmenda. Nëse keni diçka ju për të pyetur konkretisht se çfarë ka ndodhur me shërbimin e qytetarëve, po ja them unë, edhe me largësinë sa përdieni. Janë bërë aq shumë investime saqë nëse më përpara për t'u nisur, Bujari e di se e njeh zonën. Nuk e di sa e njihni ju. Më falni, ju drejtova në emër, zoti Leskaj. Ëh, atëherë e di shumë mirë zonën. Për të vajtur në Himarë duheshin katër dhe pesë orë dhe s'kishte rrugë se kaloje nga rruga e vjetër, qoftë edhe me me kafshë. Sot, sot nga Kuçi në Himarë do vetëm 20 minuta. Dakord? Kështu që ku i mungon shërbimi i qytetarit? Ndërkohë, përkundrazi, jo vetëm s'i mungon, për të vajtur vetëm nga Tërbaçi për të zbritur në njësinë administrative në qendrën e komunës, duhej të paktën dy orë. Sot, me rrugën që po bëjmë, që do përfundojë shumë shpejt, do vetëm 10 minuta. Pra, ja pra ndryshimet që kanë ndodhur. Ja pra pse duhet të bëhej reforma dhe duhet të gjithë njësitë ish-bashki, domethënë, që kanë qenë të vogla, u zgjeruan, sepse kanë mundësi. Flas për Himarën gjithmonë, që të investojë në infrastrukturë, ka investuar dhe e ka bërë këto ndryshime dhe këto zhvillime në njësi. Edhe shërbimet nuk i mungojnë qytetarit dhe atje në njësinë administrative, sepse njësi administrative, të paktën, flas për Himarën, i ka të gjitha kompetencat, i ka të gjitha zyrat, të gjitha shërbimet. Asgjë s'i mungon. Ne atë që kemi bërë, kemi lehtësuar aksesin e qytetarëve ndaj qendrës së njësisë administrative dhe ndaj bashkisë. Këtë kemi bërë ne.

Luçiano Boçi:

Po, zoti Tavo, po, shumë e saktë dhe kjo shkon në favor të tezës sonë që e kemi shumë të qartë dhe ne nuk e kemi fare për politike. Për politike u bë 2014-ta, sa përdieni, që mori dhe fshatra, e zona, u bë harta salamandëre. Hajde ty, debate shumë të gjata. Ti e di shumë mirë që unë i përkas dhe asaj periudhe. E kam njohurinë shumë të plotë, e kam përjetuar dhe bashkë kemi qenë, domethënë, jo aprovust të asaj reforme. Për këto arsye, për arsye, debat tjetër, për arsye të hartës politike, për bashkitë që sot kanë 10.000 banorë, ne jemi shumë pro. Mos mendo ti që këtu ka kundërvënie me bashkinë që janë me 10.000. Jemi pro, super pro, dhe madje duam të argumentojmë që bashki të tilla duhet të ekzistojnë në këtë nivel. 6.000, tha Xhelali, se iku mesatarja evropiane. Nuk jemi ne kundër këtyre. Ne e duam ta orientojmë në këtë pikë. Sa mirë e thatë, në zona me identitet të fortë. Orikumi, a ka identitet fortë? E ka. Lumi i Vlorës e ka? E ka identitetin. Mifoli e ka? E ka. Territorial, kulturor, shpirtëror, ekonomik. Selenica e ka? E ka. Është bujqësore, tha kryetari. Ka identitetin ekonomik vetin dhe prandaj ne jemi drejt kësaj dhe i gjithë parashtrimi juaj ndihmon këtë pjesën e parashtrimit tonë. Ne duam bashki fleksibël që ushtrojnë kompetencat, kanë burime të ardhura edhe nga vetja. Prit, prit, se ka dhe me ndryshim formule, sepse Selenica nuk i ka në raport me ty, po duhet ndërhyrë buxheti i shtetit në format dhe të fondit të barazimit nga qeveria, jo nivel qarku, se ju e thatë vetëm nivel qarku. E tha ministri se iku. Jo fond barazie nivel qarku, mund të bëhet nivel qendror që e shpërndan. Pastaj, kur e organizojmë me dy nivele, mund ta realizojë qarku edhe bashkëpunimin ndërbashkiak që ju e keni, por e keni me dëshirë. E bëni shumë mirë që e bëni. Unë e dëgjova dhe e fiksova dhe më pëlqeu, sepse nuk e kemi dëgjuar te te tjerët. Ju e keni këtë bashkëmarrëdhënie, po kjo duhet të sanksionohet. Pra, gjithçka që thuhet këtu, zoti Tavo, për ta konkluduar, mos më e bëj, mos e bëjmë replikë që ne e kemi në tagër. Po pra, prandaj ju kemi thirrë që ne tagrin tonë ta ushtrojmë në bazë të asaj që ju kërkoni, që puna juaj të lehtësohet dhe të bëhet sa më mirë. Pra, prandaj e kemi këtë lloj komunikimi. Nuk e kemi të kundërt. Ne vijmë këtu edhe themi se sa mirë keni punuar ju. Jo, o sa dëshirë keni? Keni, mo. Ne duam çfarë problematikash që ju mbajnë duart e lidhura që keni, që nuk ju bëjnë ju që të performoni ashtu siç e keni menduar, siç e keni thënë atij qytetari. Ne për ju do bëjmë këtë, këtë, këtë premtime, se në politikë jemi që janë dëshira, por që kufizohen nga mundësitë. Pastaj, kur gjendesh përballë, po mundësia. Këtë duam dhe kur flasim për Imarën, duhet të kemi përgjegjësi edhe për konispolin, edhe për selenicën, se ne jemi në gjykim global. Nuk e kemi të përqendruar Imarën dhe këtu gjithçka arrijmë. Prandaj duhesh, pra, ky komunikim është i vlefshëm, i domosdoshëm për ato që s'janë si Imara. Buxheti i shtetit 3%, 4% thotë PD-ja i pakushtezuar për vendet e varfra, fond veçantë, sepse taksa janë dhe ato. Dhe, dhe për Himarën, pse mos këtë dhe Sarandën shtim në buxhet të trajtohen, sidomos në mënyrë specifike për sezonin turistik? Ti 10-fishon mbetjet, nuk i menaxhon dot mbetjet, zoti Tavo, në sezon. Me burimet që ke, ty nuk të del. Duhet të shtosh, duhet të kesh staf, po duhet të kesh dhe para. Po pse mos i sjellë buxheti i shtetit? Se ti i shërben me turizmin, apo jo? Edhe shtetit. Ja pra, ku jemi. Këtë duhet të kërkoni ju, edhe Saranda, edhe ti, sepse 10-fishohet edhe Durrësi. 10-fishohet trajtim në fondin e barazisë së qeverisë. Po më merr Himara dhe nga të vetat, por i duhet dhe ky buxhet, mo, se shtatëfishohet, 10-fishohet

popullsia. E ka sot gazetarët dhe ty ta kanë thënë se të mbajnë me hadhër. Sarandës nuk ia pas, kam thënë, mbajnë me të mirë, jo me hadhër, se me hadhër është tjetër gjë. Sanksionohet, thashë, në buxhet të shtetit. Jo, jo, jo, të sanksionohet, të sanksionohet. Kur them sanksionohet, të jetë kriter i transferteve, kriter më i shënuar. Jo, e dua unë, ja jap. Pse dua unë, s'ja jap? A e kupton? Shumë e thjeshtë. Ne duam ta bëjmë ligjat, realitetin, edhe ta sanksionojmë, se qëllimi i reformës ky është. Po qemë ne kaq mirë, s'duhet reforma. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Ëh, po, po.

Vangjel Tavo:

Jo, s'ka. Nuk ka lidhje fare. Atëherë, atëherë, atëherë vetëm kaq. Atëherë, këtë buxhet, këtë buxhet, edhe nga qeveria, edhe Imara, dhe Saranda, dhe të gjitha bashkitë bregdetare e kanë të sanksionuar. Po është në buxhet, ma miratoni, siç që kanë i sanksionuar. Miratojnë parlament.

Luçiano Boçi:

O zoti Tavo, dhe njëherë, po e keni më në parlament, ju e miratoni. O zoti Tabo, po ngatërron. S'ka buxhet, thotë ova. S'ka buxhet nga qeveria. Po ngatërron ca gjëra që s'dua t'i them këtu si i ngatërron, se s'dua e bëjmë, domethënë, kështu replikë, replikë. Ëh, dhe një herë tjetër, në qoftë se e ke marrë një vit, e ke marrë dy vite, se ke marrë tre vite, se ke marrë ai para teje, se ka marrë. Ne po themi që të bëhet që të jetë e marrshme përgjatë gjithë kohës. Ti të kesh një kriter, Selenica, një kriter sipas specifikave që ju keni në zhvillimin ekonomik. Dhe pjesa tjetër, zoti Tavo, nuk jam këtu për të bërë replikë me ju fare, sepse është dëgjesa e disa që bëjmë dhe nuk i kemi ndërpersonale replikat dhe politikat. I kemi në raporte shumë më të gjëra. Dhe tani e kam në raport me qarkun, as s'e kam fare as me ju, as me kënd tjetër, dhe në raport me reformën territoriale, se nuk jam as banor i Himarës, as deputet i Himarës, por jam anëtar i Komisionit të Reformës Territoriale dhe dua që të konkludojmë mbas shqetësimeve tuaja, jo a priori, që unë mendoj se, unë mendoj se shumë mirë ne i marrim këto natë. Mos mendo që nuk shënohen dhe pozitivet dhe negativet, edhe pozitivet që i thoni. Mos mendoni që ne i refuzojmë, se s'i ka refuzuar kush, por sidomos ne duam ato që janë negative, thonjëza, që nuk shkojnë, që pengojnë punën e mirë të një kryetari bashkie. Se s'mund të jetë përkufizimi i reformës territoriale Himara ose Tirana, për shembull. Jo, nuk është ky përkufizimi. Kemi 6000, është gjithë kjo hapësirë. Sqarohemi, se gjithmonë të marrë replikën e tolerojmë, se ke qenë deputet, se je kryetar bashkie, pikë, ke ardhur këtu, ne flasim. Çfarë replike?

Arbjan Mazniku:

Ka dikush nga kryetarët diçka tjetër? Zoti Bido kishte për të thënë diçka.

Ardit Bido:

Faleminderit të nderuar kryetar, të nderuar kolegë, të nderuar drejtues të pushtetit vendor për qarkun e Vlorës.

Arbjan Mazniku:

Sapo bëri pyetjet, zoti Leskaj u përgjigj, zoti Tavo, dhe kalojmë një në të majtë, një në të djathtë, një në të majtë. Një pyetje të thjeshtë mund të... Jo, unë ju bëja një pyetje për 20 sekonda.

Ardit Bido:

Zoti Dule, unë jam duke folur dhe nuk e kuptoj këtë.

Arbjan Mazniku:

Jo, jo, se më pyetët pse s'e mori zoti Dule fjalën. Thashë, pyetja e fundit kanë qenë nga zoti Leskaj në krahun e djathtë. Po tani unë për një arsye të thjeshtë, zoti bashkëkryetar, unë jam këtu me juve njësoj si ju. Nuk mbaj agjendën.

Vangjel Dule:

Zotërinj bashkëkryetarë, po siç në çdo komision, besoj se prioritet kanë anëtarët e komisionit dhe pastaj geststarët e komisionit.

Arbjan Mazniku:

Patjetër.

Ardit Bido:

Faleminderit. Mundet që... Po, jua mora. Po. Faleminderit, zoti kryetar. Mirë e kërkuar, quhur. Në radhë të parë, më vjen keq që kolegë të cilët kanë vite që janë në parlamentin e Shqipërisë, ëh, në radhë të parë nuk ndjekin procedurën parlamentare dhe ndërhyjnë në fjalën e një kolegu. Së dyti, pastaj që, ëh, nuk respektojnë statusin e të qenit deputet, i cili përcakton në mënyrë të qartë që mundet të marrësh pjesë në çdo komision pa qenë gest, as gest, as star. Ndoshta kjo vjen dhe prej faktit që kanë vite që nuk janë zgjedhur me votat e tyre, po janë të importuar në këtë parlament dhe e shprehin këtë edhe në këto seanca. Dua që të flas në lidhje me qarkun e Vlorës, ëh, dhe të ngre një pyetje pastaj edhe për katër kryetarët e bashkive që kemi sot këtu. Ëh, dua të qëndroj në fakt në një çështje specifike, duke qenë se kam pasur fatin e mirë që kam qenë në reformën e fundit territoriale në vitin e 2014, në cilësinë e një eksperti të jashtëm të komisionit të atëhershëm, ëh, parlamentar të drejtuar nga zoti Fino. Dua të vendos në vëmendje të këtij komisioni, ëh, një memorie të caktuar të ecurisë së ngjarjeve të asaj kohe. Ëh, bashkitë e Pellgut të Sarandës, pra Saranda, Delvina, Finiqi, Konispoli dhe Himara, ëh, janë krijuar duke marrë parasysh edhe një situatë e cila është sui generis. Ëh, ato u krijua një bashki, Bashkia e Finiqit, së bashku me Bashkinë e Dropullit dhe të Pushtetit, jashtë kritereve të përcaktuara të reformës territoriale, duke marrë për bazë faktin që ato janë bashki në të cilat shumica e banorëve i përkasin një pakice të caktuar etnike. Duke qenë të tilla, ëh,

krijimi i këtyre tre bashkive, po veçanërisht i Bashkisë së Finiqit, për arsyen që do ta sqaroj pak më vonë, krijoi një deformim të kriterëve të përgjithshme të reformës. Pra, kriteri bazë i reformës ka qenë një qytet dhe gjithë territori, tregu në kuptimin ekonomik, ëh, hapësira kulturore në kuptimin, ëh, e traditës, të cilat mundësonin që të krijoheshin zona kompakte. Në këtë kuptim, Saranda, për shembull, ka mbetur bashkia me diferencë më e vogël në Republikën e Shqipërisë, e cila përbëhet vetëm nga qyteti i Sarandës, nga Ksamilli dhe nga fshatrat Shelegar, Metoq dhe Gjashtë dhe Çukë. Në ndërkohë që kur flasim për Sarandën e parametrave të asaj reforme, do të duhet të kishte ish-komunën Aliko, ish-komunën Dhivër, që janë territore sarandë në kuptimin e mirëfilltë. Njësoj kur vjen fjala për Konispolin, që nëse i kthehemi edhe në traditën historike dhe në kuptimin ekonomik dhe në atë kulturor, ëh, Livadhjaja ka qenë pjesë e nënprefekturës Çamërisë dikur. Njësoj Delvina, e cila Finiqi, Mesopotami, dy prej nisive administrative të bashkisë së sotshme Finiq, kanë qenë pjesë të, ëh, të janë Delvinë, pra në kuptimin tradicional krahinor të tregut ekonomik e kështu me radhë. E bëra këtë parashtesë për të thënë specifikën sui generis që ka kjo zonë në tërësi, ku krijimi i një bashkie e cila u bë me dy komuna nga rrethi i Delvinës dhe tre nga rrethi i Sarandës, për të krijuar këtë lloj bashkie jashtë kriterëve të tjera të reformës, krijoi një situatë të tillë ku, le të themi, Bashkia e Delvinës, për shembull, qyteti i Delvinës është cepi i Bashkisë së Delvinës, ku Bashkia e Sarandës është shumë e vogël, ku Bashkia e Konispolit është e pamjaftueshme. Për memorien e këtij komisioni, dua t'ju kujtoj që harta, e cila është miratuar nga Komisioni Fino 10 vite më herët, ëh, në reformën territoriale, parashikonte dy ndryshime që për shkak të pazarit të votave nuk arritën që të miratohej në Kuvend. Janë miratuar në komision. Ky ka qenë propozimi i komisionit dhe unë dua ta rikthej këtë çështje dhe të kërkoj nga komisioni që ta marrë parasysht. Në radhë të parë, njësitë, ëh, fshatrat Pec Muzin Kardikaq, ku përfshihet edhe Syri Kaltër, ishte planifikuar si një pjesë e një debati të gjerë ekspertësh dhe një debati të gjerë politik nga ai komision që t'i përkisnin Bashkisë së Delvinës, sepse kjo e bën Bashkinë Delvinë një bashki e cila mund të qëndrojë me të gjitha mundësitë në këmbët e veta ekonomike. Në ndërkohë që Bashkia e Finiqit ka tjetër natyrë, ka natyrën e ekonomisë bujqësore e kështu me radhë. Nga ana tjetër, për Bashkinë Konispol është miratuar në atëherë në komision pas një debati të gjerë të ekspertëve dhe debati të gjerë të deputetëve, ëh, që fshatrat Sopik, Vagalat dhe Pandelejmon, pra një fushë e dytë krahas fushës së Vrinës, do të ishte pjesë e Bashkisë Konispol si një mundësi që dhe Bashkia Konispol të qëndronte në mënyrë shumë të shëndetshme në këmbët e veta ekonomike. Së treti, është propozuar asokohe, nëse i kthehemi arkivave të Kuvendit, është bërë një debat i gjerë në lidhje me zgjerimin e Sarandës drejt fshatrave Nivicë dhe Shën Vasilë, që përbëjnë hapësirën gjeografike të territorit. Kushdo që ka kaluar për t'ju kujtuar, Shën Vasia dhe dhe Nivica janë fshatra të cilat, nga e cila duket Rrëzoma, e cila përmbyllin pra një territor të plotë gjeografik të gjithë zonës së Pellgut të Jugut, mundësojnë zgjerimin territorial të bashkisë me diferencë më të vogël siç është Bashkia e Sarandës dhe njëherazi mundësojnë që të ketë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik pa konflikte sociale. Më lejoni thjesht t'ju kujtoj që Nivica, si zonë kadastrale, ka qenë deri në, ëh, në portin e peshkimit të Sarandës, që me hartën në reformën territoriale u spostua deri në bregun e Kakomezës, por të gjitha debatet sot, të cilat ndodhin mes niviciotëve, më shumë ndodhin me Bashkinë Sarandë sesa ndodhin me Bashkinë Himarë, sepse të

gjitha lidhjet organike të Nivicës dhe Shën Vasisë janë me Sarandën dhe nuk janë me Himarën. Në këtë kuptim, është e domosdoshme që ne të korrigjojmë një gabim i cili erdhi si produkt i mospasjes së një vote, i një pazari politik, i një pazari i cili nuk ishte ekspertësh, i një pazari i cili nuk ishte politikanësh në kuptimin e nevojës politike, por ishte një pazar. Dhe ne duhet të shohim që në këtë zonë që është sui generis, që është e veçantë për shkak të ekzistencës së një bashkie e cila u krijua jashtë, ëh, normave, ëh, normave krahinore dhe ekonomike, po u krijua në bazë të një kriteri që unë e respektoj, atë të ekzistencës së një bashkie me shumicë minoritare që ne t'i rikthehemi dhe të bëjmë atë korrigjim sot që i kemi votat të gjithë bashkë, 140 deputetët e parlamentit të Shqipërisë. Është e domosdoshme që Delvinën ne ta kthejmë në madhësinë e vet me atë që i takon. Dhe dua të theksoj këtu për çfarëdolloj paranteze, kjo s'prek minoritetin. Pra, Muzina, Peca janë fshatra me shumicë shqiptare. Kardikaqi është fshat me shumicë, ëh, arumun ka qenë në regjistrat, rumun ka qenë në regjistrat e gjendjes civile. Pra, vëllesh ka dhe shqiptarë dhe grekë kardikaqi, por shumica është fshati i vetëm në fakt në Shqipëri që ka shumicë rumune. Janë fshatra të cilat kanë qenë pjesë e komunës Mesopotam që në sondazhet që janë bërë asokohe kanë qenë fshatra që kanë shprehur qartazi dëshirën për të qenë me Delvinën, që Delvinën e mbajnë ekonomisht dhe që nuk e dëmtojnë Finiqin. Njësoj për fshatrat Sopik, ëh, dhe Pandelejmon. Të Sopik dhe Pandelejmon, ju lutem, ju lutem, zoti, zoti, zoti Lajo, zoti Lajo, zoti Lajo, ju lutem, ju lutem, prisni radhën tuaj, zoti Lajo, prisni, prisni radhën tuaj, zoti Lajo, prisni radhën tuaj, zoti Lajo, ju lutem, prisni radhën tuaj, zoti Lajo, prisni radhën tuaj dhe keni të drejtën për të folur. Të zoti Lajo, prisni radhën tuaj dhe keni. Zoti Lajo, ju lutem, prisni radhën tuaj.

Arbjan Mazniku:

Zoti Lajo, të mbarojë, zoti Pito, dhe pastaj do keni ju fjalën tuaj. Ju kërkoj ndjesë për ndërprerjen.

Ardit Bido:

Prandaj, ajo që unë dua të theksoj është nevoja që komisioni të marri parasysh nevojën e Delvinës për t'u zgjeruar drejt Syrit Kaltër, nevojën e Konispolit për t'u zgjeruar me një fushë të dytë e cila do t'i mundësonte zgjerimin ekonomik dhe të Sarandës për të zgjeruar drejt Nivicës dhe Shën Vasisë, siç ka qenë ajo çfarë është miratuar. E theksoj dhe njëherë në Komisionin e Reformës Territoriale të vitit 2014. Ëh, përtej këtij momenti që besoj se është e domosdoshme edhe nga, ëh, nga balanca edhe ekonomike, por edhe nga balanca e, ëh, e identitare e zonës, ku për kujtesë të të gjithëve, ëh, kemi të bëjmë me Bashkinë e Konispolit që ka shumicë të shqiptarëve të Çamërisë, me Bashkinë e Finiqit që ka shumicë minoritare, me Bashkinë e Delvinës që ka shumicë, ëh, ëh, ëh, labe, të cilat kanë identitetin e tyre. Ne duhet që të ruajmë dhe trajtën ekonomike. Prandaj, pyetja që unë kam ndaj kryetarëve të bashkive të zonës së të qarkut të Vlorës është, ëh, duke parë parasysh strukturën buxhetore të sotshme, cilat janë ato kompetenca që ju mendoni se nuk janë të mbuluara me buxhet nga buxheti i shtetit? Pra, ato kompetenca të cilat janë deleguara, por që nuk janë të mbuluara me buxhet, dhe cili është gjykimi juaj se si ne duhet të shkojmë drejt tyre? Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. O, o, s'lutem, s'lutem, Ardit. Ëh, nga kryetari i bashkive, kush e për një përgjigje? Zoti Dule.

Ergest Dule:

Tani, pas gjithë kësaj paranteze që bëri zoti Bido, në qoftë se këtu lozen pazare për vota në parlament apo jo, të jeni të bindur që unë votat e konispolanëve të mi do t'i çoj deri në fund dhe nuk bëj pazare në kurriz të Konispolit. Kështu që, si zoti Bido, si zoti Lajo, që janë deputetë të votuar në Bashkinë Konispol, këtë le ta shprehin me votë ditën që do të vijë ora e votimit në parlament. Për sa i përket çështjes Sopiku, Vagalatit dhe Pandalejmoni, ne nuk kemi problem në Konispol. Jemi shembull i bashkëjetesës si i vëllezërve të shkallës, si i malësorëve në fshatin Shëndëlli, të ardhur mbas '94-ës, si i mallakastriotëve në fshatin Vrinë, si i të krishterëve, si të muslimanëve, dhe absolutisht nuk jemi kundra, apo dhe zvarret nga ne. Por edhe nëse kjo është, atëherë ne nuk jemi kundra, kundra, sepse kemi një shembull bashkëjetese aty në Konispol, po thuajse pa dallime fetare apo etnikare. Në lidhje me kompetencat për buxhet shtesë, ajo që do të specifikojë unë është ujitja, kullimi dhe rrugët rurale që nuk janë të mjaftueshme me buxhetet aktuale që ne kemi. Të bëhet shpërndarja e buxhetit në bazë të distancave kilometrike, në bazë të analizave, në bazë të studimeve, dhe mos të ngelemi pjesë e asaj formulës së Franit që në 2015. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Dule. Një nga kryetarët e tjerë. Po, zoti Veli.

Besmir Veli:

Ëh, do nis nga e fundit ajo që tha zoti Bido. Në qoftë se do të duhet buxhet shtesë, dhe besoj në sektorin e arsimit, te rrugët dhe te pijorja, patjetër do ishte e nevojshme për buxhet shtesë. Sa i përket territoreve apo atyre fshatrave që sot janë në Bashkinë Finiq, kjo gjë është fakt. Ëh, dhe nuk jemi ne këtu për ta, për ta ndoshta për ta distruar, por jo për ta vendosur. Ëh, këto tre fshatra i përkasin ish-komunës Mesopotam, ëh, dhe sot pjesë e Bashkisë Finiq. Nuk e di se si do ishte e realizueshme kjo që një komunë të ndajë në mes. Megjithatë, këto janë çështje teknike që besoj, besoj, jo, nuk jam kundër, po flasim për një gjë që është fakt. Sot, ëh, unë nuk kam frikë në qoftë se do jem në drejtimin e Bashkisë Delvinë, të kem edhe një territor dyfish sa ai që kam, se besoj te aftësitë, edhe te kapacitetet, e burimeve njerëzore që kam, që do ja dal mbanë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit.

Nertil Bellaj:

I përsërisim, po edhe unë do të thosha që duhet më shumë fonde për, jo, pas pyetjes emergjencas, duhen më shumë fonde për rrugët rurale, duhen më shumë fonde për

bujqësinë dhe për sektorin e pyjekollotave për shkak të territorit që ne kemi, dhe flasim për bashkinë që u mbuloi. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po, zoti Çaçe, a do flisni ju?

Oltion Çaçi:

Patjetër që ndoshta formula është mirë të rishikohet, patjetër, sepse si Bashkia Sarandë, ndoshta dhe Bashkia Himarë, kemi specifike që në sezonin e verës, që tashmë po rritet, po shkon gjashtë muaj, ne, ëh, shumëfishohemi si bashki dhe kemi nevojë për për shërbime të shumëfishta. Kështu që ndoshta formula do ishte shumë mirë të të shikohet, të rritej kaq.

Luçiano Boçi:

Këtë e bëra replikë, zoti Çaçi, me zotin Tapo, po ju s'ishit prezent edhe ju inkludova, dhe ju patjetër që keni nevojë për rritje buxheti, mbështetje në sezonin turistik, sepse 10 fishoheni, shtatë fishoheni. Po, pra, po, edhe unë kështu e trajtova në këtë rast, meqënëse jemi këtu ke. Ke, jemi keqarku, jemi tek qarku. Po e që i doni lekët ju, e di unë, ju i doni shumë, po çështja është, domethënë, që t'i sjellë buxheti i shtetit për shërbime, për edhe unë për atë po them për shërbime pa keqkuptime, për shërbime dhe investime pa keqkuptime. Po, zoti Tavo, se s'keni dhënë përgjigje. Rrezik do bashkoheni siç siç po shkoni ju të dy. Do bashkoheni, më duket. Qarkut i zonës aty Vlorën nuk e ke kështu që. Mos u mërzit, po ja ka ndodhur herë tjera kjo gjë dhe s'duhet ta përsëris. Atëherë, zoti Dule, fjala për ju.

Vangjel Dule:

Faleminderit, zoti Boçi. Unë do të dëshiroja t'u drejtoja zotërinjve të nderuar dy-tre pyetje. Së pari, duke parë statistikën e fundit të Instatit në lidhje me popullsinë më 1 janar 2026, qarku i Vlorës ishte një nga qarqet me të kurrje të popullsisë rezidente. A keni shifra juve në bashkitë respektive se sa ka qenë popullsia rezidente në krye të mandatit tuaj dhe sa është tani në vitin e tretë të ushtrimit të tyre? Pyetja e dytë: në kuadrin ligjor që rregullon marrëdhëniet e pushtetit qendror me pushtetin vendor, cilin konsideroni elementin më pozitiv dhe cilin e cilësoni si elementin më negativ, me qëllim që edhe ne ta kemi parasysh në propozimet tona në kuadër të reformës territoriale? Tre, gjatë dëgjësave në Vlorë, po edhe në kontaktet që kemi apo në imeile që kemi marrë, ka propozime konkrete dhe në hapësirat respektive që juve veproni, si i shikoni për shembull kërkesën që Orikumi të shkëputet nga Bashkia e Vlorës dhe të bëhet bashki më vete, ose Ksamilli të shkëputet nga Bashkia e Sarandës duke u bërë bashki më vete, apo nga Bashkia e Himarës të shkëputet ish-komuna Evranisht? Dhe të nderuar bashkëkryetar, do të dëshiroja që të jemi shumë korrekt në komunikimin me njëri-tjetrin dhe me ligjin në Republikën e Shqipërisë, se këtu nuk mund të vijë gjithsekush dhe të shprehet me mënyrën që dëshiron apo që e imponon injoranca. Në Republikën e Shqipërisë njihen nëntë minoritete zyrtare, midis të cilave nuk ka një minoritet rumun. Nëse dikush identifikohet i përkatësisë etnike

rumune, është i respektuar, po ne në Kuvend ende nuk kemi njohur një minoritet të tillë. Kush ka një ide të tillë, mund ta sjellë si propozim dhe ta trajtojnë organet përkatëse të Kuvendit, por Kuvendi nuk mund të jetë një vatër ku bëhen muhabete me raki duke pjekur gështenja. Faleminderit.

Ardit Bido:

Sa përgjigjeve? Replikë?

Arbjan Mazniku:

Jo, kryetar.

Arbjan Mazniku:

Jo, ka aq çështje si s'ka replikë. Replikë, replikë. Jo, ju lutem, replikë. Replikë? Jo, është replikë. Të lutem, ëh, të lutem, zoti Bido. Njëri replikë. Zot, jo, jo, zoti, zoti, zoti, të drejtën e replikës. Ju lutem, të drejtën e replikës. Të drejtën e replikës. Kryetarët e bashkive, zoti Bido. Zoti Bido, e kërkuj.

Luçiano Boçi:

Po, po, dakord. Jo, jo, nuk bëri fyrje. Nuk bëri fyrje. Nuk bëri njeri. Nuk bëri njeri fyrje. Nuk bëri njeri fyrje. Fjala është kryetarët e bashkive.

Arbjan Mazniku:

Ju lutem, zoti Bido. Ju lutem, zoti Bido. Ju lutem, zoti Bido. Ju lutem, zoti Bido. Ja se ja jap publikun. Zoti Bido, ju lutem. Tani, ëh, kemi lënë një rregull këtu që njerëzit bëjnë pyetjet e veta dhe përgjigjen kryetarët. Po hyjmë ne në diskutim me njëri-tjetrin. S'ka rëndësi. Duke hyrë në një diskutim, nuk ka rëndësi. Tani çështja është që e kemi debatin, po nuk ka rëndësi se ky është debat që nuk zgjidhim gjë duke e bërë këtë debat. Pra, e kemi, e kemi lënë që ne t'i drejtojmë pyetje kryetarëve të bashkive. Këtë dhe kryetarët e bashkive i kemi ftuar që ne t'i bëjmë pyetje, t'i dëgjojmë. Po hyjmë ne në debat. Po hyjmë ne në debate me një. Dakord. Ke drejtë. Ke aty. Ke të drejtë. Në qoftë se do kishte pasur një fyrje personale, të më kisha ndërhyrë. Nuk më duket se u kishte gjë të drejtuar ndaj teje. Ëh, besom, besom që unë e kam, e kam fyrje shumë të madhe, por ëh, t'i japin, t'i japin përgjigje kryetar dhe menjëherë keni. Për ty, e keni për, për, për procedurë. Mund ta marrësh për replike.

Ardit Bido:

Për procedurë, unë besoj se replika duhet të jetë në Kuvend, në komision, sepse përcaktohet në rregullore. Të përdoret një gjuhë joparlamentare nga persona të cilët nuk janë zgjedhur kurrë në këtë Kuvend dhe kanë ardhur me patericë falë marrëveshjeve të arritura pa vota, është e papranueshme dhe kjo është procedurale ndaj jush si bashkëkryetarë që nuk i tërhoqët vëmendjen dhe t'i ndërprisni fjalët para folësit, i cili kap një pesë mandate që vjen në mënyrë të tillë në Kuvendin e Shqipërisë. Dua të saktësoj,

dua të saktësoj, zoti deputet, nga mënyrat se si i ka dalë në. Dua të saktësoj, dua të saktësoj se shoh që ka dashurime së zotit Lajo edhe zotit Dule sot. Zoti Lajo dhe zoti Dule mund ta vijojnë. Dua të saktësoj që si njohësi i mirë i ligjeve të këtij vendi, unë ju referova Regjistrin Kombëtar të Gjendjes së Vjeljeve para vitit 2010, i cili përcaktonte kombësinë rumune. Kuptohet, kjo padija apo injoranca, siç thonë nga të tjerët, është e atij që flet kur nuk e di këtë fakt dhe nuk fola për pakicë rumune në Republikën e Shqipërisë. Fatkeqësisht, deputetët të cilët nuk dinë si kanë ardhur në këtë Kuvend nuk e kuptojnë këtë gjë.

Arbjan Mazniku:

Ok, ëh, kryetar, mos i hyjmë drejt diskutimeve. Të kthehemi te përgjigjet kryetarëve.

Nertil Bellaj:

Po, ne besoj që ne si kryetarë bashkie, po edhe si popull, u dëgjojmë në parlament. Tani sot këtu kemi ardhur të përgatitur. Tani ne nuk e kemi kusur që të dëgjojmë sherret tuaja. Nuk është normale kjo. Tani kemi ardhur, ne kemi një ditë për të folur. Kështu që të lutem, të flasim dhe ne. Atëherë, për t'i përgjigjur pyetjet, ëh, unë po ju them një shifër. Zoti Dule, nga marrja e mandatit të si kryetar bashkie deri sot, ëh, bashkitë rurale, qeveria ka ndryshuar qasjen dhe për rikonstruktionet e shtëpive nuk kërkojnë shumë leje ndërtimi dhe janë thjeshtësuar. Dhe po të jep një shifër: 400 deklarata leje ne kemi dhënë për këto kohë. Kjo tregon dhe njëherë një qasje që kanë për të, për të vazhduar jeta aty, e cila ka një interes këto vitet edhe për shkak të të investimeve, siç është rruga e Lumit të Vlorës dhe investimet që ka bërë qeveria. Dhe kjo është një tregues që tregon që, ëh, popullsia nuk është si ajo që themi gjithmonë që është në të kurrje, në të kurrje, në të kurrje. Kjo shifër tregon që ka një interes për t'i jetuar dhe atje në fshat. Kush ishte, ëh, pjesa që ishte e mirë, mund të themi, ëh, këto vite qeveria, qeveria shqiptare ka pasur një, një, një platformë ku ne mund të, të aplikojmë për bashkëfinancim. Pra, buxheti i bashkisë mund të bashkëfinancojë projekte me qeverinë shqiptare. Dhe unë po jap një shifër vetëm për pesë vjet. Pra, vetëm për pesë vjet, bashkia e Sirenicës ka përfituar nga buxheti i shtetit si bashkëfinancime 6.8 milionë euro dhe ka shpenzuar nga taksat e veta 8.6 milionë euro, që do të thotë rreth 15 milionë euro për pesë vjet, viti 2020-2025. Unë i kam edhe këtu kur të mbaroj, mund t'ua, mund t'ua jap. Pra, kjo është si një, një, një program i cili ka ndihmuar bashkitë dhe është gjë e mirë. Për sa i përket si pikë e dobët, ne e thamë që janë disa pika, për shembull, për transfertën e kushtëzuar, siç janë rrugët rurale, e cila duhet të jetë, duhet të jetë më e lartë. E thamë me 30 milionë lekë të vjetra. S'kemi ç'a bëjmë. Kur s'kemi ç'a bëjmë ne, nuk ka ç'a bëjë dhe dikush tjetër që na i marrë, se nuk shtrohen 200 km rrugë me kaq lekë. Kështu që për çështjen e transfertave sektoriale në pika të ndryshme duhet që të ketë një fokus të veçantë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Çaçi.

Oltion Çaçi:

Po, meqë pyetjet ishin dhe për Sarandën, ndërkohë po mund t'i jap përgjigje për Sarandën. Statistikisht, Saranda, Saranda është një nga vetëm ndoshta qytetet, nga pak krahët e qytetit në Shqipëri, që është me shtim popullsie, që në ulje. Kështu që kjo bisedë kam përshtypjen e merr përgjigjen të thjeshtë. Ëh, pushteti vendor, pushteti qendror, çfarë elementi pozitiv unë mund të them, të paktën në tre vitet e fundit që unë drejtoj bashkinë e Sarandës, investimet që ka ardhur nga qeveria, nga pushteti qendror, ndoshta krahasohen me të 30 vjetët. Le të themi, kjo tregon rëndësinë që ka qyteti i Sarandës për pushtetin qendror dhe të fokusin që ka qeveria qendrore në drejtim të turizmit, dhe kjo është pozitive për Sarandën, por ndoshta dhe për jo vetëm për Sarandën, por dhe për rrethinat, qytetet e tjera që rrethohen. Pyetja e fundit ishte Ksamilli. Tani për Ksamilin, meqë mund të flas statistikisht se tani, ëh, element si ka qenë Ksamilli, si është Ksamilli, si ka qenë Ksamilli kur ishte vetë komunë, apo si është tani, mund të them vetëm statistikisht që, ëh, investimet që janë bërë në Ksamil, të paktën në këto tre vitet e fundit, ëh, nuk po të flas fare për investimet nga pushteti qendror. Janë më shumë se 50 milionë, 60 milionë euro, por po të them nga investimet nga buxheti i bashkisë së Sarandës. Në qoftë se kur komuna e Ksamilit investonte jo më shumë se 300-400 mijë euro në vit investime, sot në Ksamil, vetëm nga buxheti i bashkisë së Sarandës, hidhen mbi 2 milionë euro çdo vit. Për mos të thënë dhe më shumë. Një vit për 10 vjet, dy vjet për 20 vjet, besoj përgjigjen e keni marrë tashmë të qartë, të paktën për këto, ëh, për këto pyetje që juve u drejtuat, sidomos për Ksamilin, meqë ishte problematik për t'u shkëputur. Më besoni, Ksamili, në tre vitet e fundit që unë e drejtoj bashkinë e Sarandës, ka ndryshime rrënjësore. Kjo është edhe si, ëh, në konceptin e zhvillimit turistik, por edhe në infrastrukturën e zonës, që është shumë e rëndësishme për atë destinacion që e mburrin të gjithë. Kështu që përgjigja është.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Ka një përgjigje tjetër, zoti Lajo?

Vasil Llajo:

Faleminderit, zoti kryetar. Duam të hyjmë në Evropë dhe kemi bërë targetin tonë që viti 2030 të na gjejë anëtarë të kësaj familje të madhe europiane. Dhe po ju them që ka një konventë për të mbrojtur, për mbrojtjen e drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Le ta kemi parasysh në diskutimin tonë këtë konventë për të mbrojtur e minoriteteve, dhe kjo i sqaron të gjitha. Dhe e dyta, dua t'ju them që emri Finikas ose Finikum ose Finiqi është përmendur të paktën një tre mijë vjet përpara se të përbëheshin bashkitë e tjera për të cilat këtu u diskutuan. Faleminderit për këtë pjesë. Në lidhje me diskutimet që kemi me reformën territoriale, do të isha shumë dakord me zoti Leskaj që me kryetarët e bashkive të kërkojnë, ose së bashku me ne, me deputetët, që të tëra burimet lokale, të ato që janë pasuri lokale, të shihet mundësia e shpërndarjes së këtyre të ardhurave, siç është në zonën e Sarandës, Syri Kaltër, që është në bashkinë e Finiqit, apo qyteti antik i Butrindit, që është një krenari kombëtare, një krenari, një pasuri e UNESCO-s, që të ketë mundësi të thithen një pjesë e të ardhurave këtyre pasurive lokale, por nga që kalojnë në buxhetin e shtetit, shikohet mundësia për të bërë një rishpërndarje të të ardhurave të këtyre

pasurive lokale. Gjithashtu, do të doja që të institucionalizohet bashkëpunimi ndërbashkiak për qarkun e Vlorës dhe për çdo qark tjetër që bashkitë që kanë më shumë të ardhura të munden të institucionalizuar, të kalojnë ndihmat për bashkitë që janë brenda tyre dhe sidomos të përjashtohen për shtimin e këtyre jo rrogave dhe disa shpenzime të tjera operative të pavleshëm, por të jenë me target ose aty ku i ka bërë dëme natyrore, që janë bërë djegur shkolla apo pasuri social-kulturore apo fetare, nuk e di se si, dhe për investime. Kjo do të ishte. E tjera, do të doja që ndoshta të institucionalizohet dhe kjo të kalohet me ligj, se rreziku i zjarrit është shumë i madh, sidomos në zonat tona që ka pye, të kalohet me ligj pastrimi i territorit, aty ku janë bashkitë ta bëjnë bashkitë dhe aty ku janë individët, ta bëjnë individët, duke minimizuar kështu rrezikun e zjarreve. Dhe e fundit, do të ishte mirë të vazhdohej projekti për qendrën kombëtare të emergjencave civile në zonën e Kranesë, aty ku u mendua që do të dyshin dy qendra, një në veri dhe një në jug, dhe kjo do të sillte një refleksion shumë më të mirë dhe më të sigurt për turistat e huaj që vijnë, dhe duke u dhënë një garanci për të, në qoftë se do të ketë mundësi që emergjencat civile të përballohen shumë më mirë, po të ketë një qendër të organizuar në këtë, në këtë, në këtë zonë e jugut. Kështu që do të ishte mirë që të të diskutohet dhe të rihapet kjo si temë diskutimi. Gjithashtu, do të doja të prekja edhe mundësitë që shteti të rishikojë shtesat e buxhetit për bashkitë që janë që dyfishohen apo trefishohen në periudhat e verës me turizmin, jo vetëm në fushën e infrastrukturës apo dhe të hotelerive, por dhe mundësinë e shërbimeve mjekësore shëndetësore, për arsye se dhe aty është një problem i madh, se dyfishohen vizitat nëpër këto spitale, që nga Vlora me radhë deri në Sarandë, dhe për të parë një mundësi dhe një organizim shumë më të mirë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Ka dikush nga kryetarët një koment? Ok, faleminderit, zonja Zhupa.

Iva Zhupa:

Ëh, faleminderit, zoti kryetar. Ëh, në fakt, unë e kam pyetjet e ndara, po nuk shoh kryetarin e bashkisë së Imarrës, kështu që do ta lë për në fund atë të Imarrës, po uroj që të ketë ardhur ndërkohë, sepse i kam sipas kryetarëve të bashkive. Ëh, dua ta nis me Sarandën, edhe si deputete përfaqësuese e Sarandës, Konispolit, Finiqit dhe Delvinës, por e gjithë qarkut të Vlorës, po më shumë të këtyre që drejtohen politikisht. Ëh, do ta nis me atë që tha zoti Lajo. Ëh, në fakt, zoti Lajo ka të drejtë. Do ishte shumë mirë nëse të ardhurat e Butrindit do t'i merrte shteti shqiptar, ose një pjesë bashkia e Sarandës, apo bashkia e Konispolit. Por dua të risjell në vëmendje të zotit Lajo, edhe të mazhorancës, që të ardhurat e Butrindit nuk i merr dot as shteti shqiptar, asnjë nga bashkitë, sepse kanë vendosur që ta japin me konçension, dhe të ardhurat e Butrindit i merr privati, i merr Fondacioni Shqiptar Amerikan për Zhvillim, dhe me ato të ardhura do ndërtojë një qendër tregtare atje, që pavarësisht se do të duhet që edhe ato të ardhura të ishin, të kishin kontribut e bashkia Sarandë dhe te bashkia Konispol, si bashki kufitare të asaj pasurie publike, prapë nuk marrin asgjë, sepse ka qenë deviza e kësaj mazhorance për t'ia hequr të drejtat, dhe unë e kam çuar dhe në gjykatë kushtetuese që të ishte bashkia Sarandë pjesë e bordit të administrimit, të paktën të Butrindit. Kështu që nëse bashkohemi, mund

të bëni presion edhe tek mazhoranca juaj që ja u ka hequr këto të drejta bashkive. Për sa i përket bashkisë Sarandë, pata mundësinë që të dëgjoja dhe përgjigjet e dhëna deri tani. Në fakt, të gjithë kryetarët nuk përputhen realiteti me atë që thonë, me atë që është realisht gjendja atje. Kështu që dua t'ju pyes konkretisht dhe dua ta filloj me bashkinë Sarandë. Cilët kanë qenë, zoti kryetar, sektorët prioritarë të investimeve gjatë viteve të fundit të bashkisë Sarandë? A ka qenë ndonjëherë për shumë furnizimi me ujë prioritet? Se ne jemi në vitin 2026, ju mburreni për një buxhet të lartë, edhe me të ardhura të mjaftueshme të bashkisë Sarandë, dhe sot bashkia Sarandë nuk ka ujë të pijshëm 24 orë. Ka turizëm me bidona ujë pesë litrosh. Është një qytet që rrethohet nga burime ujore, por nuk ka ujë. A ka qenë ndonjëherë prioritet i bashkisë? Se ka qenë dhe premtim juaj dhe është mungesë funksionaliteti si bashki. Së dyti, ju thatë para pak në përgjigje të njëra kolege për mosdakordësinë tuaj për të qenë Ksamilli bashki, duke marrë parasysh të ardhurat e ish-komunës së Ksamilit, por nuk thatë diçka tjetër. Që Ksamilli i para vitit 2014 nuk është Ksamilli i vitit 2026, sepse Ksamilli i vitit 2026 prodhon 30 fish më shumë të ardhura se ç'prodhonte si ish-komunë, edhe për resortet që janë atje, edhe për numrin e bizneseve që janë atje, edhe për numrin e të punësuarve që janë atje, dhe me një analizë ekonomike është më se efiçente dhe vetëpërbushëse për të qenë bashki, edhe për ta mbajtur veten shumë mirë. Bile s'është një nga furnizuesit kryesorë të bashkisë Sarandë që shkojnë të ardhura për pjesë të tjera, për lagjet e tjera të bashkisë Sarandë, dhe ju mund të na thoni këtu pasqyrën e vitit 2025, sa të ardhura kanë ardhur nga bizneset e Ksamilit dhe sa të ardhura kanë ardhur nga bizneset e qytetit të Sarandës, për të parë krahasimin, se ju thoni vetëm çfarë ka ndodhur para vitit 2014, dhe ne ja u thamë që në fillim që s'jemi për atë këtu. Jemi për atë që është suficienta e të ardhmes. Së dyti, më fal, së treti, se së dyti ishte Ksamilli. Thatë këtu që keni rikonstruktuar të gjitha shkollat dhe kopshtet e Sarandës. Në fakt, harruat të thoshit një të vërtetë të madhe që në Sarandë bëhet mësim me dy turne. Në një qytet të vogël si Saranda, bëhet mësim me dy turne, sepse realisht nuk keni investuar tek shkollat e Sarandës. Dhe një mjedis që ishte përgatitur, ishte dhënë buxhet, kishte nisur që në kohën e ish-deputetit Koço Kokëdhima, dhe u bë propagandë e madhe që Ekokampusi do të bëhej shkollë për qytetarët e Sarandës. Ju e morët, ja dhatë Fondit Shqiptar të Zhvillimit që t'ia japin oligarkut ta bëjë hotel për turizëm. Dhe a e dini ju, si kryetar i bashkisë, që Ekokampusi sot po ndërton paleje ndërtimi? Dhe a ka zë? A duhet të kenë zë bashkitë në këtë drejtim, edhe për për shkollat dhe për destinacionin që duhet të kenë shkollat? Thatë që i keni rikonstruktuar shkollat. Unë kam rastin e shkollave këtu. Të gjitha shkollat janë pa ngrohje. Kam rastin e shkollës "Adem Sheme". Mblidhen prindërit, vënë lekët që të blejnë një kondicioner, edhe flasim pastaj për një bashki efiçente që ka buxhet të mjaftueshëm që mund t'i shërbejë qytetarëve dhe nuk përputhet me me realitetin. Po të shikosh, zoti kryetar, qytete më të vogla, dhe unë prapë i kam të dhënat këtu, qytete që e kanë buxhetin shumë më të vogël, kanë hapësira për investime që kanë bërë për fëmijët, për ambiente sportive, për pallate sporti, për ambiente të cilat shkojnë në drejtim të asaj që duhet të ishte edhe për fëmijët atje, edhe për qytetarët atje, por edhe për turizmin. Ju ku i çoni këto paratë e shumta që paska bashkia Sarandë, që ju thatë pak më parë që janë të të kënaqshme, të mjaftueshme, të rritura, dhe bashki e cila ishte për t'u marrë zili? Nga ana tjetër, unë kam numrin e punonjësve të bashkisë Sarandë. Bashkia Sarandë, me një popullsi 23.000 banorë, ka 450 punonjës, dhe rritja e në mënyrë

eksponenciale e harxhimeve, e shpenzimeve që ju bëni për punonjësit, është disproporcionale me atë që ju bëni për investimet publike. Pra, ju harxhoni më shumë dhe keni një rritje më të madhe tek punonjësit sesa tek investimet publike, dhe kjo është edhe për bashkitë e tjera. Po i kam marrë veç e veç në mënyrë të tillë që mos thoni: "U përgjigj njëri dhe s'do përgjigjet tjetri." Për sa i përket menaxhimit të mbetjeve, sa përqind e mbetjeve urbane riciklohen, nëse riciklohen në bashkinë tuaj, dhe sa përqind dërgohen në incenerim? Dhe cili është bashkëpunimi në këtë rast edhe me bashkinë e Delvinës? Për sa i përket shërbimeve sociale dhe strehimit, sa është numri i familjeve të pastreha në bashkinë e Sarandës, dhe sa fonde janë planifikuar, për shembull, për buxhetin e vitit 2026, për programet e strehimit social, për të kuptuar efikasitetin? Thashë, zoti kryetar, niveli aktual i borxhit dhe sa përqindje e këtij borxhi është shlyer nga të ardhurat e veta të bashkisë, dhe sa është bërë me mbështetjen e qeverisjes qendrore? Për sa i përket bashkisë Sarandë, problemi i fundit të cilin dua ta ta ngrë me ju për të kuptuar edhe efikasitetin tuaj në territor ka të bëjë me parkimet. Në fakt, ju morët dhe zëvendës kryeministren atje me vete që, mbas ë 20 vjetësh, ndërtoat një parkim me 100 vende në hyrje të Sarandës, por nuk thatë se, mbasi të parkojnë atje, si do shkojnë në qytetin e Sarandës për ato 100 vende që u bënë atje, se në Sarandë nuk ka linjë urbane që e bën atë, apo do marrin taksë, apo do marrin një makinë tjetër, do marrin një makinë të rastit që t'i çojë në në qytet. Ndërkohë, parkimet buzë rrugës, se në qytet nuk ka parkime publike, ato që janë buzë rrugës, ato janë zënë në 70% të tyre me makina me qera që parkojnë aty, i vënë atje me motorra që vijnë skicë për të zënë vendin, edhe është e pajetueshme për banorët e Sarandës. Imagjinoni tani për turistët e Sarandës. Dhe për ta mbyllur, shëndet, fjalë e vërtetë, dhe për ta mbyllur me ju, me me pjesën e tuaj, a mendoni, a mendoni që bashkia juaj është e varur, dhe sa e varur është nga grantet e kushtëzuara dhe nga transfertat e pakushtëzuara? Dhe në këtë aspekt, çfarë sugjerimi keni? Dhe a garantoni ju standarde të barabarta shërbimesh, si në lagjen një të Sarandës, si në Çukë, si në Metoq, si në Gjashtë, si në Ksamil? A janë shërbimet e barabarta, apo cilat zona keni më problematike në akses në shërbimet publike që duhet të ofrojë bashkia e Sarandës? Këto janë pyetjet e mia për bashkinë e Sarandës, për bashkinë e Delvinës. Sa të vijë dhe ai i bashkisë i marrës, se bëri shumë batuta dhe iku fare. Pastaj, për bashkinë e Delvinës, do ta nis me zjarrët. Do ta nis me zjarrët, sepse situata e zjarreve në verën që shkoi ishte dramatike. Delvina ishte në kulmin e kësaj situatë dhe nuk është se pashë ndonjë efikasitet, as nga shteti, aq më pak nga bashkia, që aq i ka kapacitetet, edhe aq më pak që të arrijmë në nivelin që ju t'i keni dëmtshpërblyer, apo të mund të kthehen në gjendjen e mëparshme dëmet që janë bërë. Zoti kryetar, cili është raporti aktual i numrit të zjarrfikësve për numrin e banorëve të bashkisë tuaj? Ku është hera e fundit që ju keni investuar si bashki për mjete zjarrfikëse, apo teknologji të reja, të paktën në këto 10 vitet e fundit? A e përmbush standardin kjo bashki për numrin e zjarrfikësve? Pagesat, pagesat e tyre, dhe a patën mundësitë, të paktën që gjatë kësaj vere, kur i pamë edhe ato skenat e netëve të tëra që ishin shtrirë aty, që të merrnin nga bashkia një mbështetje, apo një shpërblim? A e keni këtë mundësi, të paktën që të reagoni në këtë drejtim? Së dyti, unë kam të dhënat të bashkisë Delvinë. Ja u kam thënë në digjesën e Vlorës, po nuk e pranuat. Kështu që po ja u them këtu tani, me fakte dhe me prova. Aktualisht, bashkia Delvinë, ë kryetar, akumulon në vitin më të mirë financiar rreth 30 milionë lekë të ardhura, ndërkohë

që edhe transfertat e pakushtëzuar, e dhënë nga qeveria, është rreth 65 milionë lekë. Shpenzimet e personelit që ju i mohuat janë rreth 70 milionë lekë për të realizuar gjithë veprimtarinë e vetë, pa përfshirë transfertat specifike të shërbimit zjarrfikës, pyjor, mirëmbajtjes së rrugës së arsimit, ujitjes, kullimit. Bashkisë i duhen rreth 120 milionë lekë, duke përfshirë shpenzimet e personelit, shërbimet ndaj komunitetit, pra pastrim, gjelbërim, ndriçim rrugor, mirëmbajtje e shkollave dhe kopshteve, si dhe investimet e duhura. A është ky një shembull? Një bashki që e ka të pamundur të mbajë veten, dhe bashki, siç e ka cilësuar në rankimin që u bëri grupi parlamentar, bashki drejt parlamentit, dhe a mendoni ju që një nga këto zgjidhjet mund të jetë zgjerimi i territorit me fshatra të tjerë, apo mund të jetë zgjerimi i kompetencave dhe institucioneve që duhet të ketë Delvina? Se Delvina, dikur, që ju nuk e përmendët, kishte institucione atje, bëhej kolaudimi i makinave atje, kishte, kishte, ë, kishte, kishte drejtoria arsimore atje, kishte, ë, kishte institucione atje. A jeni ju, si kryetar i bashkisë, i gatshëm të thoni të mbani qëndrimin këtu, që Delvinës duhet, duhet të ketë institucione në mënyrë të tillë që të ketë punësim, në mënyrë të tillë që edhe ju të merrni më shumë, më shumë të ardhura, apo jeni të lumtur kështu siç jeni, ku edhe numri i bizneseve nga 300 që kanë qenë të regjistruara para reformës është rrudhur, sot ka rënë në 200 të tillë, të paktën biznese minimaliste, ë, se biznese të mëdha është harruar që mund të vijnë atje. Pra, e keni ju këtë vizion, apo ju duket mirë kështu siç jeni në deficit buxhetor? S'ka gjë se nuk duhet të dilni nga linja e partisë. Pyetja për, në ndërkohë, numrin e të punësuarve për bashkinë Delvinë, nga një popullsi 6200 banorë, keni 200 të punësuar. Kështu që e kuptojmë se kush është prioriteti i bashkisë. Në lidhje me bashkinë Konispol, dëgjova fjalën e kryetarit të bashkisë, edhe kam mbajtur edhe edhe shënim. Kam edhe disa pyetje. Në fakt, i shkruajta dhe në kohë reale, ë, njerëzve atje, se unë vetë nuk i kisha parë, po thashë mos janë bërë këto mrekulli dhe si kam parë unë. Po, ndërkohë, nuk nuk ishin bërë. Nuk kishim nja 30 bujtina në Murësi, se edhe po të kishim një, do ishte shumë e bukur, një të mirë, edhe me emër. Po 30 bujtina, me thënë të drejtën, nuk e di në qoftë se ju quani dhoma shtëpisë private, bujtina. Të s'e di, po nja 30 bujtina në Murësi do ishte një lajm shumë i mirë kombëtar, por që është e pavërtetë. Ë, zoti kryetar, për sa i përket asaj që ju thatë, kemi garantuar si bashki. Njëherë e them si premisë që jam dakord me qëndrimin tuaj, edhe është edhe qëndrimi i Partisë Demokratike që Konispoli duhet të jetë, të qëndrojë, të vazhdojë të qëndrojë si bashki, si bashki edhe identitare. Kështu që në këtë aspekt jemi dakord me njëri-tjetrin. Po për sa i përket funksionalitetit, financave dhe kompetencave, këtu besoj ndahemi, se ju thatë keni bërë mrekullira. Konispoli thatë ju ka 24 orë drita. Vetëm unë, në këto muajt e fundit, po ta hapësh Facebook-un tim, gjen të paktën 30 denoncime nga 48 orë që ikin dritat. Me shiun e parë që bie në Konispol, me pikat e shiut të parë, jo shi me rrëbeshë, dy të ikin dritat në Konispol. Dhe të vish edhe të flasësh për efikasitet në këtë gjë, ku qytetarët e dinë dhe ku qytetarët ankohen, tregojnë që realisht ose nuk e njeh gjendjen atje, ose do t'ia fshehësh komisionit. Po këtu ne nuk jemi për të fshehur njëri-tjetrit të vërtetë. Po të kërkohen investime, po të kërkohen më shumë para, po të kërkohen më shumë kompetenca, se nuk e kuptoj pse duhet të thoni gjëra që nuk janë të përputhshme me realitetin që jetojnë banorët atje. Aq më tepër që edhe transmetohet, është edhe la. Nuk është për shembull që flasim me njëri-tjetrin edhe ngelet këtu, edhe po e dinë mirë. Për sa i përket asaj që ju thatë për ujitjen, edhe për besoj ju e dini që është prishur kanali i

Janjarit, që është 8 milion euro investim. Keni ju kapacitete ta bëni vetë? Jo, nuk ke. A je i varur nga qeverisja për ta bërë këtë gjë? Dhe meqë jemi këtu, çfarë po bën? Se hyjmë në muajt e verës, që është më shumë se e domosdoshme ky investim që ishte propaganduar me të madhe, që do zgjidhte këtë problem të ujitjes, vaditjes në Konispol. Për sa i përket rrugëve të Konispolit, bëtë ju një panoramë. Thashë unë ku janë këto rrugë, se nuk po i shikoj. Sipas jush, janë ndërtuar të gjithë rrugët e fshatrave, janë ndërtuar rrugët e qyteteve. Jemi, domethënë, në një Konispol turistik të mrekullueshëm. Ndërkohë që po të marrësh makinën edhe do të shkosh në fshatrat, disa në fshatrat vër, nuk shkon dot me makinë normale. Duhet të gjesh një makinë nga ato të lartat, edhe t'i lutesh Zotit që nuk do të çahet goma dhe të nisësh. Tani, hajde të flasim me realitetin për të kërkuar atë që i shërben realisht njerëzve atje. Në qoftë se flasim se jemi mirë me këto buxhete, me këto kompetenca, me këto financa, nuk ju bën mirë as juve, besoj unë, në qoftë se keni dhe ambicie për të kandiduar prapë në bashkinë e Konispolit. Për sa i përket mënyrës se si ndihmohen, apo si është qasja ndaj qytetarëve, dëmet që pësuan fermerët, unë kam qenë atje në protestën e fermerëve, edhe kur doli lumi nga shtrati, edhe nga nga rreshtit, zero janë ndihmuar deri më sot nga nga bashkia. Dhe jo vetëm kaq, po kanalet kulluese nuk janë pastruar. Që ne po do na ikë vera tani, se tani je i lumtur se është verë dhe nuk do të përmbytet, po do na ikë vera, do na fillojnë shirat e shtatorit, do vijë prapë unë për protestë atje, t'i bashkohem banorëve, sepse ju nuk pastroni kanalet, nuk keni fonde, nuk keni vullnet. Kush është problematika që ju i lini të njëjtat siç është sot dhe siç ishte dje, ku u përmbyt? Se minimalisht duhet të jepni një shpjegim në këtë drejtim për të kuptuar dhe ne si mund të ndërhyjmë. Apo doni që kjo kompetencë t'i kalojë qendrës, ta pastrojë qendra, ta pastrojnë emergjencat civile? Se kështu jemi mësuar me emergjencat civile, çdo gjë, edhe efiçenca e zjarreve. Ky vendi jonë nuk ka një... Ka dalë ai që ishte ish-ministër edhe kemi deputet, e keni deputet të qarkut të Vlorës. Tha: "Me kismet do ta blejmë një avion." Ju thoni është efiçente. Poli dhe Tavo e iku tani. Poli është shumë efiçent dhe tha: "Menaxhimi i zjarreve." Po si është efiçente? Një vend që nuk ka një helikopter të vetin, ju që s'keni plotën e duhur atje dhe duhet të kërkon mbështetje, thoni që është efiçente. Domethënë, është komplet të jesh jashtë asaj që është realiteti që jetojnë banorët e atyre zonave. Minimalisht. Ndërkohë, për sa i përket të ardhurave, po keni shumë të drejtë që kur e krahasoni me para 2014-ës, thoni keni më shumë të ardhura. Po, keni më shumë të ardhura sepse keni rritur taksat vendore, keni rritur taksën e ndikimit në infrastrukturë, keni rritur taksën e pasurisë së paluajtshme. Këto janë para që janë marrë qytetarëve. Patjetër që keni më shumë të ardhura. Nuk shpitet rrokën. Po të rrisni dhe taksa tjera, do keni edhe më shumë të ardhura. Po puna është si i përdorni këto të ardhura dhe sa efiçente janë për shërbimet që marrin qytetarët e këtyre bashkive. Ndërkohë, me shpresën që zoti Tavo do të vijë, zoti Mazniku, ë, apo ka ikur? Zoti Mazniku, zoti Tavo do vijë, t'i bëjë pyetje tani, t'i bëjë pastaj, apo u dorëzua ai që bëri dy batuta dhe mund të ikë?

Arbjan Mazniku:

Nuk kam për detyrë të merrem me të.

Iva Zhupa:

Pra, ti nuk garanton pjesëmarrjen këtu deri në fund. T'i themi shlyqyr Zotit që nuk ikën.

Arbjan Mazniku:

Jemi bashkëkryetarë. E kërkoni zotëri Boçi.

Iva Zhupa:

Po ti je përfaqësuesi i mazhorancës. Po të ishin, po të ishin nga bashkitë tona, do...

Luçiano Boçi:

Po thjesht është, po jua kërkon juve, sepse është e tij, e përfaqësuesi i mazhorancës.

Iva Zhupa:

Meqënëse zoti Tavo u dorëzua, meqënëse zoti Tavo u dorëzua dhe i mjaftuan batutat e fillimit, po t'i them zoti Tavo që ato që thotë zoti Tavo që do bëheshin për 500 vjet dhe për 600 vjet, investimet mund të bëheshin edhe për 700 vjet, sepse zoti Tavo nuk thotë një të vërtetë të madhe që i marra sot është kthyer në vendin e investimeve strategjike, ku i merret prona qytetarëve, të jepet oligarkëve dhe shumë nga ato janë procese në SPAK. Sigurisht, po të marrësh investim strategjik, llogarisësh taksën e infrastrukturës që ata dorëzojnë para se të nisin projektin në bashki dhe numrin e popullsisë që ka bashkia. Ju e dini shumë mirë që i marra krahasohet edhe është e dyta në rang republike mbas Tiranës, sepse i keni dhënë që të ndërtojnë atje resortet. Po kjo s'është ndonjë meritë e zotit Tavo, apo ndonjë punë e shkëlqyer e zotit Tavo, se i kanë rrëmbyer pronat njerëzve, apo se janë bërë investime strategjike që sot janë çështje SPAK-u atje. Në qoftë se do kishte një efikasitet që do vinte me biznesin e ndershem, me investimet e banorëve lokalë atje, me bizneset lokale, atëherë po po thuash është arritje e zotit Tavo që merr milionat nga taksa e infrastrukturës, investimeve strategjike. Po të kishte investime strategjike, kishte daljen det, edhe Delvina do t'i merrte, edhe Delvina s'do ishte ndonjë meritë, apo do t'i merrte edhe qytetet tjera. Tani vijnë këtu dhe mburren me atë që në fakt është gropa më e zezë e mënyrës së menaxhimit të territorit, duke u dhënë si copa për oligarkët edhe si plaçkë e tregut të gjallë, ku ata banorët lokalë nuk përfitojnë asgjë, po përfitojnë oligarkët aty. Dhe ky thotë: "Më thoni faleminderit tani që ju vodha tokën, po po ju bëj një copë rrugë." Në fakt, kjo nuk është mënyra se si duhet të të funksiononte shteti dhe bashkitë. Dhe për ta mbyllur, kur është hera e fundit, ë, të nderuar kryetar, dhe kjo është një pyetje e përbashkët, kur është hera e fundit që ju keni bërë dëgjesa, konsultime publike për projekte, sidomos kryetarit të bashkisë së Sarandës, që kanë dhe projekte për projekte të ndryshme zhvillimore, apo për ndërtime, apo për plane për qytetin? Kur është konsulta e fundit që keni bërë? Dhe meqënëse jeni bashki, ë, bregdetare, a e mendoni normale përfshirjen në paketën e maleve dhe çfarë do t'i jepni tjetër Sarandës, mbasi i keni dhënë të gjitha për oligarkët? Kjo ishte pyetja e fundit. Shumë faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, kryetarë dhe bashkie.

Oltion Çaçi:

Po tani, megjithëse deputeti i nderuar është edhe edhe drejtuese politike në zonë, por edhe deputet e Sarandës, në fakt këtu më shumë kishte politikë sesa, sesa le të themi aktualiteti i mbledhjes së sotshme. Ne jashtë këtyre kamerave kemi diskutuar për shumicën e rasteve dhe pyetjeve, e di shumë e qartë për të gjitha. Në fakt, unë marrëdhënien e kam me qytetarët e Sarandës dhe të Ksamilit, të cilët më kanë votuar, ku jam përditë atje, dhe ndoshta deputetja e ka humbur pak realitetin. Nuk është kështu siç thuhet këtu. Megjithatë, unë nuk dua të bëj politikë.

Iva Zhupa:

Shqyrtite e mundur, por po i përgjigju pyetjes së të bëjnë dhe lëre humbjen time të realitetit.

Oltion Çaçi:

Janë 20 pyetje këtu dhe nuk ka lidhje me rastin. Janë politike.

Arbjan Mazniku:

Zonja deputete, ju lutem, 20 pyetje dhe nuk ka lidhje asgjë me rastin. E zonja deputete, ju dëgjojmë të gjithë. Nga fillimi në fund, të gjithë pyetjet dhe komentet tuaja. Tani do japim kohën kryetarëve pa i ndërprerë. Ju lutem, ë, ju lutem, ju siguroj, ju ju lutem, kisha momente që mendoj unë. Mund të kisha...

Oltion Çaçi:

Më fal, më fal. Nuk po ajo më drejtua dhe po i kthehem zonjës deputete.

Iva Zhupa:

Këtu drejtova me pyetje konkrete. Përgjigjet i dua konkrete. Përgjigjet, përgjigjet, përgjigjet në interesin e publikut. Përgjigjet në rastin konkret.

Oltion Çaçi:

Unë e kam marrëdhënien me publikun. E kam dritë për ditë në Sarandë publikun dhe këtu nuk besoj që ka problem.

Luçiano Boçi:

Zoti Çaci, je në komision, je thirrur. Mos jep vlerësime të tilla se ç'lidhje kanë deputetët me realitetin, apo jo? Me realitetin. Se po e bëjmë debat sërish. Po e bëjmë debat. Po e bëjmë tani. Debati është real. E para punës është deputete. E dyta punës, pak me etikë, se është edhe femër, apo jo? Se po ta bëjmë ne një gjë të tillë, e di si na sulen pjesa femërore e juaja. Kurse këtu s'u ndje njeri kur ti stigmatizove dhe folëm në këtë lloj forme. Këtu je për t'i dhënë përgjigje pyetjeve që ka bërë deputetja. Pikë. Kaq. Vazhdo edhe do të vlerësojë dhe publiku ai zgjedhës për këtë gjë. Për këtë që the ti, nuk të vlerëson kaq shumë.

Oltion Çaçi:

Besoj se e dhashë përgjigjen time. Kështu që

Luçiano Boçi:

Kjo është e vërtetë, por dhe me zhvlerësuar, me zhvlerësuar komisionin në këtë lloj forme, kjo është e papranueshme. Që tashi, domethënë, si i dhe ti, s'dua unë, s'dua unë se jam e kam babin, punon në ministri. Ç'është kjo histori? Jam kryetar i Sarandës. Unë e s'jap përgjigjur. Vazhdo, domethënë, pse ti je më superior sesa të tjerët që do japin përgjigje? Ke pyetjet aty, e përgjigje tani.

Oltion Çaçi:

Në rastin konkret, të gjitha pyetjet nuk kanë lidhje me temën për të cilën unë jam thirrur.

Iva Zhupa:

Është informacion.

Luçiano Boçi:

Po si lidhja me temën? Për shembull, pyetja që bëri për raportin banor zjarrfikës nuk është për komisionin, po për mbështetjen sociale, po ujë pishëm. Për çfarë janë ato? Se s'po e kuptoj. Nuk s'ka lidhje me komisionin. Ndoshta ju në bashki serandë merrni vetëm me inteligjencën artificiale dhe s'keni fusha menaxhimi tjera, domethënë, nga këto që i shërbejnë qytetarëve. Tani jep sa përgjigje të domosdoshme.

Oltion Çaçi:

Meqë, meqë po insistoni në përgjigjet, atëherë sektorët prioritarë, ujësjellësi, patjetër që ujësjellësi është prioritet në qytetin e Sarandës. Sot që flasim, janë duke u zhvilluar dy investime të mëdha për ujësjellësin. Është ujësjellësi në gjashtë edhe edhe në në Çuk Berdenesh. Ndërkohë që jemi duke u marrë me projektin për furnizim me ujë të pishëm 24 orë në qytetin e Sarandës. Kjo është procedurë më e gjatë, ndoshta, por edhe me atë jemi duke u marrë. Ëh, tani Ksamilit të ardhurat, meqë jemi tek Ksamili, unë sapo e shpjegova që Ksamili, ë, nuk kemi rritur asnjë të ardhur te bizneset. Thjesht kemi shtuar bazën e atyre që paguanin, që atyre që s'paguanin. Sot, të gjitha të ardhurat që merr Ksamili, investohen po në Ksamil. Po këto janë.

Arbjan Mazniku:

Po, të lutem, zonjë, ju lutem, ju lutem, se folëm shpejt për këtë historinë e zonja Byllukashi. Po, të lutem, të lutem.

Iva Zhupa:

Do ndahet bashkia, apo jo, Ksamili? Kështu që ti s'e kupton lidhjen. E dimë ne lidhjen. Ai ka për detyrë t'i kthejë përgjigje pyetjet. Po s'di të kthejë përgjigje, se e kanë vënë aty dhe e komandojnë me telefon.

Oltion Çaçi:

Nuk e kam detyrë unë të kthej përgjigjen. Nuk e kam detyrë.

Iva Zhupa:

Po e ke detyrë, se për çfarë ke ardhur në komision? Për çfarë ke ardhur në komision? Shikojmë si zonja Zhupa. Mund të tregosh respekt që të kthesh përgjigje. Nuk e kam detyrë. Nuk e njeh bashkinë tënde dhe pret vetëm urdhrat e drejtuesit.

Arbjan Mazniku:

Zonja Zhupa, të lutem, se u çua gjysma, gjysma e grupit t'ju mbështesi për faktin që pse tha ai që s'jeni në prekje me realitetin dhe filluat t'i thoni koleges: "Jo e di, jo s'e di, jo e kupton, jo s'e kupton." Tani çështja është, tani çështja është, është. Jo, jo, është. Tani çështja është, nëse prisni, nëse prisni nga njerëzit t'ju trajtojnë me respekt, nëse prisni nga njerëzit t'ju trajtojnë me respekt, duhet të kërkonit të njëjtin respekt. Kaq, zotëri. Unë nuk mund t'i thoni deputetëve të tjerë: "E di ti, e kupton ti, s'e kupton ti, s'e kupton dot, e kupton dot."

Iva Zhupa:

Zoti Mazniku, unë kam bërë pyetje të cilat janë në përputhje me interesin e opozitës për planin e vet të territorit. Pyetjet tuaja ishin të gjithë këtu dhe i dëgjuam. Cila është, cila është e ardhura që vjen sot nga bashkia Ksamili? Nga nesër, sot është e ndarë, sot është bashkë, por nesër ne e supozojmë që të jetë veç. Ai duhet të thotë: "Ky është raporti dhe pastaj e gjykojmë ne nëse është e mirë apo është e keqe për t'u ndarë bashki." Ai duhet të thotë: "Ku shkojnë paratë e buxhetit të bashkisë së Sarandës?" I ndamë kështu dhe ne duhet të shikojmë a është efiçente apo duhet shtuar më shumë transferta. Pra, pyetjet janë në lidhje me një projekt që ne do dalim për reformën territoriale. Nuk ka nevojë ta kuptojë ai pse bëhet pyetja. Ai ka vetëm detyrë të kthejë përgjigje të informacionit që i kërkohet për bashkinë e vet. Nuk i kërkohet informacion për asgjë tjetër përveçse për bashkinë e vet: shërbimet që jep, funksionin që ka si bashki, kompetencat dhe financat. Kaq. Nuk ju kërkua. Ju kërkua ti mosha, loje, çfarë, kush është hobi i tij? Jo, ju kërkua disa të dhëna mbi investimet. Nuk mund të vijë këtu, zoti Mazniku. Nuk mund të vijë tjetër. Ju keni investuar në shkolla, ndërkohë që bëhet shkolla me dy turne, ndërkohë që shkollat janë pa ngrohje, sepse i bie që po tallesh me qytetarët e Sarandës.

Oltion Çaçi:

Nuk ka asnjë shkollë pa ngrohje në qytetin e Sarandës. Ti po tallesh me, ti po tallesh sot. Po tallesh me qytetarët e Sarandës.

Iva Zhupa:

Prindërit e shkollës, Adem, ç'jeme, mbledhin para dhe blejnë kondicioner vetë. Ti thua s'ka pambrojtje. A jeton me realitetin, apo jo? Zonja Zhupa, për çështje e komunikimit është kaq e thjeshtë. Janë bërë një seri pyetjesh.

Arbjan Mazniku:

Zonja Zhupa, të lutem, tani se domethënë flet mbi çdo njeri, flet mbi çdo njeri. Ore fole, 10 minuta, 20 e ca minuta, fole pa u ndërprerë nga fillimi. Po dhe 200 minuta tani duhet të të heshtni, të merrni përgjigje. Po duhet të heshtni. Nëse nuk heshtni, nuk do merrni dot kurrë përgjigje, sepse dëgjoni vetëm veten tuaj dhe doni të dëgjoni vetëm veten tuaj dhe madje i flisni çdo njeriu sipër.

Iva Zhupa:

Tani ju ndoshta ishit duke u marrë me celular që të keni mundësi të përgjigjeni.

Arbjan Mazniku:

Tani ju jeni, ju jeni përgjegjëse për pyetjet tuaja. Zotëria në fjalë është përgjegjës për pyetjet e përgjigjet e veta. Po jo të thotë nuk ka përgjigje. Po nuk do japi. Si do t'i do japi? Si mendon ai tani? Tani s'mund të bëni dëgjesa të fare në ekran. Mos i lini të japin përgjigjet siç i mendon ai në momentin që juve do heshtni që të jepni kohën. Po pra të japi përgjigje dhe thotë nuk përgjigjen. Ëh, zotëri Çaçi, keni përgjigje të tjera për të dhënë?

Aulona Bylykbashi:

Ëh, zotëri kryetar, më keni dhënë fjalën për procedurë. Faleminderit. Po, pra para së gjithash, ë, para së gjithash në këtë Kuvend bën nder që të gjithë deputetët të respektojnë rregullat e këtij Kuvendi paraprakisht dhe e dyta të funksionojnë mbi bazën e rregullores. Në këtë komision jemi shumë të interesuar të dëgjojmë për procesin e reformës territoriale administrative, të gjitha eksperiencat mbi funksionet, ekonominë, shërbimet që ë do të shpaleshin të gjithë kryetarët e bashkive që janë këtu. Në këtë pikëpamje, ky nuk është një proces nga i cili ne duam të shikojmë eficientë e funksionimit të një bashkie, se si ajo e harxhon buxhetin, ka mekanizma sot ligji dhe shteti shqiptar se si mund të monitorohet kjo për çdo njësi të qeverisjes vendore. Kështu që këtu jemi për një proces krejt tjetër dhe komisionet zakonisht kanë një efekt kryesisht teknik. Padyshim që ne nuk ndahemi dot nga politika sepse jemi përfaqësues të dy anëve të ndryshme, por komisionet përgjithësisht kanë një fokus që është teknik dhe pjesa politike asnjërit nga ne nuk i mungon që ta bëjnë në seancën plenare dhe në çdo vend tjetër. Kështu që do i lutesha kryetarëve të bashkisë të cilët janë në të drejtën e tyre t'i përgjigjen atyre pyetjeve që janë të lidhura vetëm me procesin e reformës territoriale, administrative territoriale dhe jo për pyetje të cilat nuk kanë lidhje me këtë proces dhe që kanë të bëjnë me specifika të posaçme me të cilat ne të gjithë bashkë duam të bëjmë politikë për elektoratin që na shikon jashtë. Faleminderit shumë.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zotëri Çaçi.

Iva Zhupa:

Tani, zoti kryetar për procedurë, të lutem, sepse po flet për mua. Pyetjet e mia ishin specifiku, specifiku për interesin e reformës territoriale dhe unë kur e pyes të ardhurat sipas zonave, shërbimet sipas zonave, sistemi arsimor, sistemi.

Vasil Llajo:

Zonja Zhupa, ka një këshillë bashkiak që mund të drejtonin të minitojnë të tjerat, sepse...

Iva Zhupa:

Kush ju ka mësuar ta merrni fjalën sipas qejfit, apo duke ndenjtur me Arditin, ke marrë abonet e Arditit. Mos rri me Arditin.

Arbjan Mazniku:

Ju, për shembull, që s'keni lënë njeri pa intervistë.

Iva Zhupa:

Jo, me thënë të drejtën, gjithmonë e kam marrë për procedurë. Po ju pëlqen që të flisni ndërkohë që flas unë. Në qoftë se ky komision ka një detyrë, ka pikërisht detyrën të kuptojë si kanë funksionuar bashkitë deri tani, a kanë qenë eficiente për shërbimet dhe për qytetarët, dhe çfarë mund të bëhet më mirë. Dhe të gjitha pyetjet e bëra nga unë, të paktën për bashkinë Sarandë, se po pres edhe bashkitë e tjera, janë pikërisht në këtë temë. Nëse një kryetar bashkie ka të pamundur t'i përgjigjet këtyre pyetjeve, koca rri aty. Koca është kryetar bashkie dhe koca vjen në digjes. Më mirë të kishte shkëlqyer, më mirë të kishte shkëlqyer me mungesën e vet si Bruna, sesa vjen këtu për të tjetër

Arbjan Mazniku:

Kandido ti dhe do fitosh.

Iva Zhupa:

Me thënë të drejtën, nuk e kam fare ambicjen, as do ta kem ndonjëherë për pushtetin lokal. Po të jesh i sigurt që kushdo, kushdo që të kandidojë, Çaçin ose kolegun e tij do ta mundi. Të jesh i sigurt se ka gjysmën e bashkisë sot në arrest edhe në kërkim. Çështjet, të jesh i sigurt, është pak më e sigurt. Edhe me këtë performancë sot këtu është edhe një arsye më shumë për të mos u votuar. Kështu që unë pres, zoti Mazniku, që kryetarët e bashkisë, mirë Çaçi, që aq mundet, aq bën dhe aq di, aq thotë, të paktën kryetarët e bashkisë të tjerë të japin përgjigje, sepse kanë ndoshta pak më shumë integritet për të treguar profesionalizëm para komisionit dhe para qytetarëve që i ndjekin. Nuk kisha pyetje vetëm për zotin SMS, kam pyetje edhe për kryetarët e tjerë të bashkive. Kështu që uroj që kryetarët e tjerë të bashkive të kthehen përgjigje dhe mos marrin shembullin më të keq të një njeriu të importuar aty.

Arbjan Mazniku:

Prisni që ne t'i marrim me zor kryetarët këtu të lidhur që të...

Iva Zhupa:

Po për çfarë kanë ardhur kryetarët? Po s'u përgjigjen. Për çfarë kanë ardhur? Po për të bukur? Ëh, dëshirime dhe gjërat do t'i ashtu të përgjigjen.

Arbjan Mazniku:

Kryetarët kanë ardhur. Ne fillojmë që besojmë realisht tek autonomia vendore, jo vetëm te autonomia vendore, edhe ke... edhe ke...

Iva Zhupa:

Po për çfarë i ke ftuar mua, zoti Mazniku? Po s'u përgjigjen.

Arbjan Mazniku:

Do pushosh një sekondë, të lutem? Po mirë, pusho, se fole. Sa deshe tashi, pushove të një sekondë. Të jap një njeri një fjali. Nuk ke për të marrë asnjëherë në jetë, jo vetëm sot, asnjë përgjigje, nëse nuk ke ndaluar së foluri. Saranda e ka bërë natyrën e saj. Nuk do marrësh kurrë ndonjë përgjigje. Bëhet politikë menjëherë.

Iva Zhupa:

Me thënë të drejtën, përgjigjet. Dhe besoj, zoti Maznik, publikun jo.

Arbjan Mazniku:

Dhe besojmë që elementi, elementi, pika, pika kryesore e dëgjësës në konceptin thelbësor të faktit të dëgjësës është përdorimi i veshëve, që do të thotë vijmë këtu për të dëgjuar. Ëh, zonjë...

Iva Zhupa:

ju s'dëgjoni qytetarët. Kishte një pyetje, zoti Mazniku, kryetarët e tjerë të bashkive më kanë kthyer përgjigje.

Jorida Tabaku:

Ndërhyrje për procedurë. Përpara, përpara se t'i japim kryetarëve përgjigje. Zoti kryetar, unë me shumë durim po pres Tiranën, sepse jam deputete e Tiranës, por besoj që kemi respekt edhe për kohën e gjithë kolegëve. Zonja Zhupa ka gjithë ditën që pret për të dëgjuar kryetarët e bashkive të qarkut të saj. Unë e kuptoj lodhjen, ezaurimin. Kanë qenë ditë të gjata për më tepër për dy bashkëkryetarët që i kanë ndjekur të gjitha seancat. Po të mos çedojmë tani në fund, në qoftë se kryetarët e bashkive nuk kanë përgjigje, është më korrekte të thonë që nuk kanë përgjigje dhe nuk dua. Po këto janë çështjet tona. Ne

politikanë jemi në fund të ditës, zonja Byllëk Bashi. Çështje elektorale diskutojmë këtu. Tani nuk thua dot bëmë politikë, nuk bëmë politikë. Si juve, si unë, votohemi. Politikë është kjo. Uji, në fund të ditës, çështje politike është. Edhe ujësjellës, kanalizimi dhe zjarrfikësi. Çështje politike është, bashkiake është kjo. Tani, në qoftë se kryetarët e bashkive nuk kanë përgjigje, është më korrekte të thuhet për këtë çështje: nuk do përgjigjem. Po ju kërkoj, zoti bashkëkryetar, ta sjellim në shina dhe në binar diskutimin drejt fundit të ditës, sepse ka qenë ditë e gjatë për ju më shumë sesa për ne, dhe të përpiqemi që të gjithë të kemi hapësirë. Unë po pres me shumë durim qytetin tim. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Kërkesa ime sistematike nga fillimi është vetëm një dhe kam një kërkesë të vetme që kur ka filluar komisioni. Dhe e kam tentuar maksimalisht ta ndjek vetë i pari këtë gjënë. I dhamë kohën, zonjë Zhupa, bëri pyetje, parashtrim, 25 minuta. Tani do t'i japim kohën kryetarëve të bashkive të përgjigjen pa u ndërprerë nga asnjëri dhe pa i ndërhyrë. Këtë e mendon kështu, këtë se mendon mirë, këtë madhe e përgjigjen kështu. Kur të mbarojë, kur të mbarojë përgjigjen, kryetari i bashkisë kemi rënë dakord në mënyrë procedurale që personi që ka shtruar pyetjet të ketë drejtën të thotë: "Nuk mora përgjigje për pyetjen një, dy dhe tre. Mund të më japësh përgjigje?" Pas kësaj, kryetari i bashkisë ka drejtën t'i përgjigjet në mënyrën si e mendon ai përgjigjen. Nuk ia ndikojmë dot asnjë njeriu në Republikën e Shqipërisë përgjigjen, sa më pak t'ia ndikojmë kryetarëve të bashkive të zgjedhur nga qytetarët e Shqipërisë. Pra, zoti Çaçi, nëse keni përgjigje, do ju kërkoja me shumë respekt që të paktën të mos ndërpresim kryetarin gjatë kohës që do të përgjigjet. Faleminderit.

Oltion Çaçi:

Patjetër që një pjesë të madhe ne i përgjigju, se kemi gjithë ditën këtu që po komunikojmë. Ëh, një pjesë e një pjesë e pyetjeve janë politike, të cilat nuk mendoj që është vendi për të përgjigjur këtu.

Arbjan Mazniku:

Zoti Dule.

Ergest Dule:

Mirë që iku Dulja tjetër, se do ishte çuar në këmbë. Tani, zonja Zhupa, besoj se në Konispol vjen vetëm kur ka protesta për të bërë ndonjë lajm, për të bërë ndonjë foto. Ehet, a edhe është atje që fermerët janë braktisur, e u ngeli prodhimi në degë, jo për mbitën, e ku di unë. Pse zihen tani, për shembull, që është sezoni dhe i ujitjes dhe i krasitjes dhe i plerimit? Atje ku djersinë ata, hajde bëj një foto tani dhe do të dali dhe fotoja më bukur, se nuk do të dali kaq e zyrtë sa që bën ti. Nëpër festa, edhe atje ju kemi ftuar, s'keni ardhur. Tani, duke e zënë nga kanali i janjarit i dëmtuar sipas ankesave që ju kanë ardhur në celular. Dakord? Është, është një, është një dëmtim. Deri tani, deri tani na përmendte mister CMC.

Arbjan Mazniku:

Tani çdo fjalie e ke ndërhyrë. Le të mbarojë njeriu një fjali.

Ergest Dule:

Më lër ta mbaroj. Kanali i janjarit ka filluar nga puna riparimi dhe vënia në funksion ka të paktën 15 ditë. Nuk është një financim që mund ta mbulojmë ne si bashki. Kemi bërë kërkesën në Ministrinë e Bujqësisë dhe kemi aplikuar njëkohësisht dhe tek AKMC-ja në atë kohë, sepse ishin dëmtime nga shirat e nëntorit. Doli si investim nga Ministria e Bujqësisë. Është tenderuar, është prokuruar dhe ka filluar puna. Por tani çdo lloj njeriu që pyet apo interesohet, nuk më ka pjedhur mua. Mund të më pyesni mua shumë bukur, se që të shkojë njeriu me këmbë atje është 23 km kanal linjë. Nuk shkon njeri me këmbë atje. Dhe ne shkuam për t'u siguruar dhe kemi qenë dhjetorë që merremi me këtë punë dhe nuk merremi sot. Kështu që fermerët që vaditen apo ujitin tokat e tyre si nga lumi, si nga rezervuari i murësisë, ka filluar hapja e portave që pardje. Kështu që kanali i janjarit do të vihet në funksion të plotë, sepse ka filluar nga puna. Do të vonojë një javë apo 10 ditë nga hapja normale e portave të digës, por jemi në kushte që duhet të bëjnë durim të gjithë, sepse nuk është një dëmtim i vogël që mund ta menaxhojë bashkia me sekonda. Siç kemi menaxhuar problematikat e tjera që brenda 24 orëve hyrja e Konispolit, hyrja e Markatit, hyrja e Dishatit u bë e aksesueshme. Deputetët kanë qenë prezentë vetë. Atëherë mund të kishte ardhur ti, zonja Zhupa, dhe të shikoje çfarë bëj. Do shikoje dhe mjetet e bashkisë në punë, edhe njerëzit e bashkisë që janë në punë. Për sa i përket fuqisë punëtore, jemi nën normën mesatare kombëtare. Tani po e bëre pyetjen, prit të përgjigjem, ndaj mos na... Po, dakord. Për sa i përket 24 orëve drita, këtë nuk e thashë. Kam thënë 24 orë furnizim me ujë, por ama kam thënë që në zonën tonë po bëhet një nënstacion 20 për të gjithë zonën, të cilët ju e keni diskutuar gjithandej që shihet se bëhet për oligarkët dhe bëhet dhe për këta milin e ku di unë. Por ne jemi përfitues dhe pesë nga fshatrat tona Vrinë, Shëndlli, Xharë, Murësi dhe Konispol janë dhe me rrjet të brendshëm, dhe kabinat e reja me dy izolacione dhe një 60-vjeç. Pesë nga 13 janë me rrjet të ri të shpërndarës të brendshëm. Këtë mund t'ua konfirmojë Petrit Alimullai, sepse ankohet i pari dhe i vetmi në rrjetet sociale sa herë bie shi fiken dritat në Konispol. Normalisht, këtu dua të shtoja diçka që kryetarët e bashkive duhet të jenë dhe në një pjesë bordi, po them, menaxhimi edhe tek OSHE-ja. Siç jemi dhe ujësjellësi, duhet të jemi dhe te OSHE-ja, sepse ne jemi, jemi si komunarët aty njëherë dhe një kohë dhe merremi me çdo gjë, dhe me defektin, dhe me këtë, dhe me atë. Normalisht, duhet të kemi një lloj përfaqësimi dhe aty, sepse drejtoria rajonale e OSHE-së është në Gjirokastër dhe elektrikisti i fundit është në Konispol. Kështu që do pak angazhim nga edhe nga ana jonë, duke qenë se po e bëjmë këtë punë. Për çështjen e infrastrukturës rrugore, i përmenda që i kemi të gjitha në rregull, përveç se aksit Shalës-Dishat-Vërvë. Nuk më dëgjuat. Këtë e thashë. Do ta bëjmë mandatin e dytë, sepse Konispoli do vazhdojë të ekzistojë. Këtë e pohuat dhe ju. Kështu që e përmenda unë dhe këtu jemi për të përmendur dhe problemet. Për sa i përket bujtinave, nuk thashë që janë bërë bujtinat e reja, por bujtinë do të thotë bujtë brenda, dhe shumica e atyre në Murësi janë dhe me PD, në fakt, dhe më vjen çudi që si s'të kanë bujtur për një vizitë në ato që reklamojnë në Airbnb. Do t'jua sugjeroj kur të shkoj poshtë.

Dhe për rrugën Dishat-Vërvë kemi bërë disa rehabilitime me mundësitë tona, me mjetet tona, por edhe me mjetet e AKMC-së dhe të repartit Xhengos. Kisha thënë një tjetër se nuk besoj në lidhje me taksat e rritura. Nuk janë rritur taksat, sepse taksat janë... Më tregove buxhetin që kanë rritur taksat. Po, dhe janë rritur tarifat, sepse në ish-komunat nuk kishin çatë tarifoni kur nuk ofronin shërbim. Tarifë ndriçimi nuk e ofronin, sepse s'ofronin shërbim. Ne ofrojmë, normalisht do të marrim dhe tarifën: tarifë ujitje, tarifë mirëmbajtje rrugëbujqësore. Normalisht që kanë tarifën e veta. Nuk janë rritur, por janë shtuar shërbimet. Kështu që të ftoj në zonë edhe për ditë me diell, jo vetëm ditë me shi, dhe do dalin dhe fotot më bukur. Për sa i përket protestave, kemi qenë bashkë te Ura e Shkallës ditën e bllokimit të urës së Shkallës. Njëra nga makinat ka qenë imja. Kam qenë dhe në mbledhje të këshillit bashkiak. Kështu që ato që janë për zonën, janë për zonën dhe janë të mira. Dhe edhe të reklamohen dhe të ekspozohen nga të gjitha palët. Këto janë probleme gjithashtu dhe ato.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Dule. Zoti Veljo ose zoti Belbi, keni përgjigje për? Po, eja. Po, vazhdojmë, zoti Veli.

Besmir Veli:

E nisëm me zjarret. Ëh, thatë shpërblimet, mjetet. Ëh, po dua të jeni e vëmendshme të më ndiqni, se për shpërblimet fola edhe në fillim të të asaj çfarë unë thashë edhe e përmenda. Kështu që nuk po e përsëris prapë. Sa për mjetet zjarrfikës, unë kur kam marrë drejtimin e bashkisë në vitin 2023, ëh, ka pasur dy mjete: një në gjendje pune dhe një jo. Sot flota është shtuar me dy, plus dy, katër në total, dhe një në buxhetin e këtij viti, një mjet të vogël pikap që e kemi planifikuar. Përmendët të ardhurat dhe vitin më të mirë dhe thatë ishte 30 milion. Nuk e di cilës periudhë i referoheni. Ja u kthej dhe këtë përgjigje: cilës periudhë? Është ajo e fundvitit, po nuk merrni parasysh të trashëguarat dhe buxheti faktik bëhet në muajin shkurt-mars dhe është 52 milionë të reja. Tani unë po të jap përgjigje për ato që më the. Për sa kemi nevojë, besoj e thamë dhe e thamë dhe më parë dhe mos të bëhemi përsëritës në atë çka kemi thënë. Pra, është 52 milionë të reja. Këto të ardhura nga viti në vit ka pasur tendencë rritjeje. Përmendët për pagat për punonjës: sa përqindje harxhoi për kosto personeli dhe të tjera. Dua t'ju vë në... t'ju theksoj, më falni, në fakt që tek ata punonjës e thatë ishin 200. Jo, nuk janë 200, janë më pak. Hajde, hajde në... hajde në bashkinë e Delvinës të ftoj të vish një ditë edhe ta vizitosh, se s'ke ardhur ndonjëherë dhe kur vjen. Bën dy-tre foto me katër-pesë, me katër-pesë që të janë zoti Beli. Të ftoj të vish. Nuk janë aq. Ti the janë 200. Nuk janë 200. Unë të ftoj të vish, po nuk në bashki dhe të marrësh dhe njëherë pjesë në ato... në ato këshilla bashkiake.

Luçiano Boçi:

Zoti Beli, nuk të kemi ftuar të na ftosh.

Besmir Veli:

E ftoj zonjën Zhupa si deputete. Si deputet e Delvinës, dhe tha ajo më parë, më parë bashkëkryetar, ajo tha që unë përfaqësoj dhe Delvinën. Janë deputetë e Delvinës dhe unë e ftoj të marrësh pjesë në një nga ato, siç kanë ardhur dhe deputetët e tjerë.

Luçiano Boçi:

Edhe njëherë, a do e respektosh? Do e respektosh komisionin, apo jo? Pse habitem me këtë mënyrë arrogante të dhënies së përgjigjeve?

Besmir Veli:

Jo, nuk është aspak arrogante. Unë s'e di ku e patë ju, zoti bashkëkryetar i komisionit.

Luçiano Boçi:

Pashë, pashë arrogancën. Hajdeni, se s'ke ardhur, bën vetëm foto. Nuk je këtu për këtë gjë fare. Edhe njëherë, nuk je.

Besmir Veli:

Nga zonja Zhupa kemi dëgjuar deri tani. Ju nuk ishit pjesë e komisionit. Kemi dëgjuar atij. Nuk dini të përgjigjeni. Tani këto, kjo është përgjigjja e tij. Nuk e mendoj unë.

Luçiano Boçi:

A ka mundësi? A ka mundësi se e drejtojmë ne komisionin? Jo ti, mor burrë! A ka mundësi? Ka mundësi të të dëgjosh? Jo, më përgjigjja jote duhet të jetë në përputhje me pyetjen radhë parë. Dhe kur ti tejkalon përgjigjen, atëherë normal që unë ndërhyj. Dhe kjo nuk është mosdëshira imja për të dhënë, mos dhënë ti përgjigjen, por dëshirë për ta orientuar pyetjen. Dhe ne këtu e kemi për detyrë, po them ne se jemi dy kryetarë, që të bëjmë çdo gjë që komisioni të ketë mbarëvajtje të punës së tij. Dhe këto kapërcimet në akuza, në gjysmë ironi, apo që s'kanë lidhje me temën që diskutojmë, janë të papranueshme. Këtu është komision parlamentar. Gjykojeni këtë. Ju kujtoni se jeni në administratë. Domethënë, e them për ju me respekt për ty, se në këtë rast nuk dua të akuzoj të tjerët. Nuk jemi administratën dhe s'jemi punonjës të administratës tuaj. Jep një përgjigje që e gjykon që është më e drejta dhe kaq, pa komente fare. Deputeti bën komente se është në detyrën për të bërë komente. Bën pyetjet, bën dhe komentet. Pastaj thotë që përgjigjja nuk është e plotë. Duket te përgjigjet të orientuar, jo se po bëjmë komision hetimor. Dhe njëherë, nuk është qëllimi ynë t'ju nxjerrim keq ju para publikut fare. Ne duam të marrim nga ju problemet që duam ndoshta në një formë t'i nxjerrim edhe me grepa, se fshihen, kamuflohen. Duam problemet që t'i reflektojmë, që të dalim konkluzime si duhet bashkia, si duhet territori, çfarë duhet të bëjmë që të shtohen shërbimet, si të rritet përfaqësimi. Se shumë qartazi, në qoftë se ka rrezikim, mund të ketë rrezikim për selenizëm, për Delvinën. Nuk jam shumë i sigurtë nga propozimet që vijnë nga maxhoranca, nga krahu juaj. Ndërkohë që ne dalim në mbrojtje të ekzistencës tuaj, ju silleni sikur jeni... Ne jemi shkaktarët e një situatë që nesër ju dëmton juve në pozicion fare më. Në qoftë se ka aleat më të vërtetë dhe më të sinqertë në punën tuaj në këto

momente që s'janë kaq politike, është opozita. Pra, atë ekzistencën tuaj të bashkive të vogla nuk e kam kështu thjesht për bashkitë e vogla, sepse e kemi mbrojtur këtë ide që në fillim. Kështu që vendosim një normalitet. Është dhe ora e di shumë mirë se gjithë ditën edhe kapërcehet. Po t'ia kursejmë vetes këtë lloj komunikimi të këtillë. Aq më tepër e thashë dhe në rastin e zotit Dule. Zonja Ina Zhupa është zonjë, është dhe deputete. E shih, ta ruajmë pak, domethënë, edhe etikën. Faleminderit. Mund të vazhdoni.

Besmir Veli:

Atëherë unë, unë nuk, nuk e ofendova, nuk e në asnjë moment nuk e, nuk e ofendova në asnjë moment zonjën Zhupa, aq më tepër se është një, është një femër. Ëh, unë dhashë përgjigjen time në lidhje me atë çfarë zonja Zhupa më bëri si pyetje dhe për ta, për ta kundërshtuar. Pak, pak më parë, sapo dhashë përgjigjen time në lidhje me të ardhurat e bashkisë, edhe këtu, ë, këtë gjë e kemi diskutuar me zonjën Zhupa edhe në Vlorë. Aty nuk më dëgjoi. Po ja them përsëri: janë 52 milionë, fakt, 52 milionë të reja, fakt. Ëh, kosto personal. Ju përmendët përqindje. Tani, po t'i kisha përqindjet, do t'i jepja, po të theksoj që në këtë përqindje që ju keni, ne kemi aty dhe punonjës të pastrimit, të gjelbërimit, ku në shifra të tjera që ju mund të keni para mund të jenë me nënkontraktorë, apo ne bëjmë vetë këtë shërbim, e ofrojmë vetë qytetarëve të Delvinës dhe e mbulojmë më së miri mbi 80% të territorit që ne, që ne përfaqësojmë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit.

Nertil Bellaj:

Një, ë, një ndër... Të ndërhyj vetëm për diçka. Kur zonja Zhupa tha që të bëni djersa publike për projektet, ë, patjetër se ato buxhetet nuk kalojnë pa djersa publike, por në çdo rastin të shtoja diçka tjetër që nuk ka lidhje me këtë, por mendoj që është shumë thelbësore. Është kryetari i fshatit. Mendoj që kryetari i fshatit është një, një simbol. Po, po, voton me votë drejtpërdrejtë në bashkisë dhe mund të votojë me votë drejtpërdrejtë kryetarin e fshatit. Kryetari i fshatit, kryetari i fshatit, ë, nuk mund të jetë një person siç... Po, pra, kryetari i fshatit, kryetari i fshatit, ë, mund të zgjidhet dhe nuk mundet të ketë një shpërblim sot simbolik. Kryetari i fshatit është shumë i rëndësishëm. Kryetari i fshatit, ë, mund të jetë një person i cili kryen disa shërbime, kryen disa shërbime dhe duhet të jetë një punonjës me pagesë. Arsyeja që sot nuk shkojnë kryetarë fshattrash është sepse ata marrin një shpërblim të vogël. Deri para një viti e gjysmë ka qenë 60.000 lekë, 70.000 lekë. Sot mund të shkojë pak më shumë sepse është 5% e pagës së kryetarit të bashkisë. Por në qoftë se unë ju siguroj se ne vijmë nga bashki rurale dhe distanca e një fshati me qendrën administrative është të paktën 5 deri në 10 km. Në qoftë se ne e bëjmë me pagesë, pastaj se sa është pagesa, sa paga minimale, apo sa paga e një specialisti, apo mënyra e kriterëve të një kryetari të fshatit, unë them që do të ketë interes një për kryetar fshati, por ai kryetar fshati do të jetë një punonjës në thelb i strukturës së bashkisë dhe shumë prej shërbimeve të vogla mund të jepen aty. Mund të jepen aty sepse ka shumë fshatra që nuk kanë sot një qendër interneti. Pra, ata duhet të shkojnë nga fshati në një

njësi administrative. Kjo shërben si një pikë shumë e mirë dhe një afrim i shërbimeve të vogla direkt aty në fshat. Kështu që unë ju sugjeroj ta shikoni pastaj çështje ligjore se si rregullohen dhe buxhetore. Patjetër që duhen buxhetet sepse vetëm bashkia që unë drejtoj ka 42 fshatra. Kështu që do të duhet nesër ne të zgjedhim 42 kryetarë fshatash, por me buxhet. Buxheti sot është 100.000 lekë. Nesër mund të jetë 500, por mendoj që do të jetë shumë efektive dhe do të vijë shumë në ndihmë kryetarëve të bashkive. Ëh, e dyta, ne si bashki paguajmë TVSH-në. Mendoj që këtë TVSH që ne paguajmë të na kthehet një pjesë. Nuk kthehet 100%, por një pjesë në formë grantesh që mund të na ndihmojnë ne për një barazim i disa bashkive. Pra, bashkitë e mëdha marrin pak, bashkitë e vogla marrin më shumë. Tapi sot është 2%. Mund të rritet. Pra, vendet e rajonit e kanë më lart se 2% dhe kjo është një mundësi që ne si bashki të kemi më shumë autonomi financiare. Për sa i përket çështjes së bujqësisë dhe të fondeve që bën Ministria e Bujqësisë, Ministria e Bujqësisë bën politikën dhe që do marrë kaq subvencione për bakteri, kaq për toka të mbjella, por mendoj dhe besoj që duhet të jetë bashkia që të jetë e integruar bashkë me ministrinë. Në fakt, ne nuk mund të jemi vetëm për të për të mirëmbajtur kanalet. Pra, ne duhet të kemi një lidhje me tokën. Pra, ne duhet të kemi një lidhje me fermerin. Pavarësisht se ne mund ta kemi atë regjistrin në ligjin 139 që është bërë në 2015-ën, na i lejon, por edhe buxhete nuk ka brenda. Kështu që besoj duhet që në reformën që po bëjmë, bashkitë të integrohen me ministrinë, të gjejnë një mënyrë që të jetë prezente, sepse bashkia është më shumë e lidhur me njerëzit, është shumë e lidhur me hallet. Sado një kryetar bashkish, një kryetar bashkie i cili mund të ketë 1.000, i them unë, 1.000 të tjera që nuk shkojnë, por është 100 herë më i përgjegjshëm se një person tjetër që nuk ka lidhje me zonën. Dhe e treta ka të bëjë me dixhitalizimin. Mendojmë që edhe pushteti vendor duhet të ketë një unifikim për dixhitalizimin e shërbimeve. Kjo është një gjë që besoj që duhet të të bashkëveprojë së bashku me qeverinë, edhe është e nevojshme, sepse ne po e shikojmë që Ilbenia po funksionon, shërbimet po funksionojnë, kanë ato të tyre që mosha dhe e treta nuk e bëjnë dot vetë, por ne si bashki, njësi administrative, i kemi vendosur në shërbim edhe të gjithë njerëzit i kemi vendosur në shërbim për të ndihmuar, dhe mendoj që edhe unifikimi i shërbimeve të dixhitale për bashkitë do të jetë një ndihmesë e madhe për të ardhmen. Unë këto kisha.

Arbjan Mazniku:

Po, faleminderit. Zoti Dule, kishte diçka për të shtuar akoma?

Ergest Dule:

Një ndërhyrje të vogël për pjesën e dëmshpërblimit në bujqësi të dëmeve në agrume. E përmendi zonja Zhupa, por më doli nga mendja. Realisht, aty u bë një dëm kolosal. Kur themi kolosal, në shifra pesë deri në 7 milion euro. Një e treta e prodhimit të zonës, por jo për efektet të mospastrimit të kanaleve kulluese. Efektin e kanaleve të pastruara e kanë dhënë në orën 15:00 në një video dron të ngritur nga unë posaçërisht për të dhënë efektin e pasqyrit të punës tonë. Por kjo është tjetër temë dhe tema tjetër prek direkt fermerët. Nuk prek bashkinë, por ju si ligjvënës mund të propozoni diçka. Unë ia kam propozuar ministrit të bujqësisë kur ka ardhur atje dhe ta kopjojmë nga shteti grek. Një ELGA quhet

në Greqi dhe është një organizëm i sigurimeve të prodhimit bujqësor, ku vetë fermerët, bashkë me shtetin, kontribuojnë në sigurimin e prodhimit bujqësor. Dhe në rast fatkeqësie natyrore, qoftë breshër, qoftë ngricë, qoftë dështim në lulëzim, qoftë në përmytje, atëherë nga ky fond kompania ose ky organizatë bën dëshmbëlimin dhe nuk e bën shteti as atje, se thonë në Greqi e bën dëshmbëlimin shteti. Organizata quhet ELGA dhe është kontribut i vetë fermerëve. Pagan një prim të caktuar në bazë të hektarëve dhe në bazë të kulturave. Kështu që as shteti, se sot është PSH-ja, mbështetet, akuzohet PSH-ja, por në 2013-ën është përmytur prapa atje dhe ka rënë breshëri. Dhe vetë ju keni qenë atje për të pajgoritur fermerët dhe nuk zgjidhet me çështje partiake, zgjidhet me mekanizëm. Kështu që të shikohet mundësia për një mekanizëm financiar sigures të prodhimit bujqësor. Faleminderit. Po, faleminderit. Kam vetëm një fjalim pak për përgjigjet. Vlerësoj dhe bie bie dakord shteti, edhe po vlerësoj kryetarët e bashkisë së Konispolit që patën mundësinë t'i përgjigjesh të gjitha pyetjeve dhe kryetarët e bashkisë së Delvinës, pavarësisht se nuk e tha nënën sot, nuk janë 200 punonjës, ndoshta sa është, se ndoshta unë e kam marrë nga ekspertët, them që janë 200 punonjës. Sepse 199 besoj se jemi aty aty. Megjithatë, refuzon dhe më vjen keq që nuk, për ta mbyllur, më vjen keq që nuk garantua dot që dëgjesa t'i mbante kryetarët e bashkisë këtu që të përgjigjeshin, se ne nuk jemi ardhur të presim këtu shtator për t'i bërë pyetje kryetarit të bashkisë së Sarandës për të marrë zero përgjigje se si pëlqejnë pyetjet, se në fakt nuk di çfarë thotë dhe të prisni dhe të ikni. Në të njëjtën mënyrë siç po ikën sot nga komisioni, do iki në prill të vitit të ardhshëm nga bashkia e Sarandës. Shumë faleminderit.

Jorida Tabaku:

Zoti kryetar, së pari sapo informova që dëgjesa për qarkun e Tiranës nuk do zhvillohet tani. Unë nuk i di arsyet, nuk e di se çfarë ka ndodhur, sepse kryetari i bashkisë së Kamzës nuk vjen. Kryetari i bashkisë së Kavajës ishte këtu dhe u largua, dhe sepse kryetarja e deleguar e bashkisë së Tiranës nuk vjen. Është në gjykimin tim një mungesë edhe përgjegjësie, edhe përgjegjshmërie, por edhe autoriteti i rëndë i këtij komisioni që ajo që sot drejton një të tretën e popullsisë së Shqipërisë të mos vijë në këtë komision për të na raportuar. Unë kisha nxjerrë një sërë pyetjesh dhe një sërë shqetësimesh, edhe në emër dhe të forcës politike që unë përfaqësoj. Unë kisha bërë dhe disa propozime që dëgjesat nuk janë të nevojshme vetëm për bashkinë e Tiranës, por janë të nevojshme për t'u kryer edhe me komunat, potencialisht sipas propozimeve që ne kemi bërë me zonën e Kasharit, që ka përqendrimë më të mëdha të biznesit, me zonën e Dajtit, që ka përqendrimë më të mëdha të ndërtimeve të reja, me zonën e Petrelës, të Paskuqanit, që neve gjykojmë që duhet të jenë qendra të reja dhe ka nevojë për një debat. Tani, kryetarja e deleguar e Tiranës, e cila ka marrë përgjegjësinë të administrojë qytetin e Tiranës, nuk vjen dhe të raportojë këtu në komision. Ju keni qenë vetë zëvendëskryetar bashkie e Tiranës. Unë kam qenë zëvendëskryetar i bashkisë së Tiranës. Në vitin 2015, Tirana ka pasur 5.000 punonjës. Sot ka 9.200 punonjës. Po, minimumi duhet të vijë këtu dhe të na flasë, të na raportojë se çfarë ka ndodhur me reformën territoriale. Çfarë po ndodh sot me qytetin e Tiranës, që ka vetëm ndërtime dhe nuk ka investime? Çfarë po ndodh sot me periferinë? Tirana nuk është vetëm sheshi Skënderbej. Tirana sot duhet të ishte policentrike, dhe këtu mungesa e zonjës për të raportuar për një të tretën e popullsisë të Shqipërisë, në gjykimin

tim, është edhe mungesë, edhe arrogancë, edhe mungesë respekti ndaj këtij komisioni. Së pari, njëherë ka nevojë që ne në këtë komision të kuptojmë a ka një qytet tjetër europian që ka një të tretën e popullsisë së vendit përqendruar në një qytet të vetëm. A i ofrohen këtyre qytetarëve të zallherit e zallbastarit shërbimet bashkiake, apo administratori atje është vetëm për të marrë lejen e gurores e për të ikur në shtëpi? A ka sot bashkia e Tiranës një përgjigje për sa i përket shërbimeve që ofrohen dhe nuk ofrohen në pjesën më të madhe të rasteve? Ju keni deputetë tuaj të Tiranës që ankohen që Tirana, dhe jo sot, dhe jo mbasi kryetari i bashkisë së Tiranës është përpara drejtësisë, por për vite me radhë që nuk ofrohen shërbime në qytetin e Tiranës, sepse Tirana është e pamenaxhueshme, është bërë e pajetueshme. Tirana është një nga qytetet më të korruptuara në vendimmarrje. Të mos nisë me lejet e ndërtimit dhe të përfundojë me inceneratorët. Unë ndihem e fyer sot. Ndhem sinqerisht e fyer, dhe ju si bashkëkryetarë që keni shpenzuar më shumë kohë se ne të tjerët këtu, sepse unë e di se çfarë peshe ka që të drejtosh një komision, dhe e vlerësoj edhe durimin, edhe punën që ju të dy po bëni, por ndihem e ofenduar që një zonjë që ka përgjegjësi për të drejtuar një të tretën e popullsisë së Shqipërisë sot nuk vjen këtu. Na sfidon të gjithëve, dhe kjo nuk është një çështje që kryetari i bashkisë është përpara drejtësisë, sepse përpara drejtësisë sot Partia Socialiste ka 40 kryetarë bashkie. 40 kryetarë bashkie sot i keni on hetimo me akuza. Në qoftë se zonja nuk e drejton dot bashkinë e Tiranës, të ikin në shtëpi. Në qoftë se Partia Socialiste është e paaftë që ta drejtojë bashkinë e Tiranës, le ta lërë bashkinë e Tiranës, por që të mbash peng një të tretën e popullsisë të vendit me një pozicion atje të komanduar, për mua është jashtë çdo logjike. Një sërë pyetjesh që ne kishim përgatitur bashkë dhe me kolegë të tjerë të Partisë Demokratike për qytetin e Tiranës, që kanë nevojë që të shohim se si u krye reforma territoriale e 10 vite më përparë. A ishin të drejta vendimet për t'i lënë për të krijuar pabarazi? Po, zoti Mazniku,

Arbjan Mazniku:

Jo, ju ndërpres vetëm për një arsye. Jeni duke folur për pikën tjetër që kemi, ndërkohë që kemi akoma kryetarët e bashkive. Bëjmë dakord?

Jorida Tabaku:

Ti, unë ju pyeta për kryetarët e bashkive dhe më thanë: "Përfundua me Vlorën për pikën tjetër."

Arbjan Mazniku:

Jo, përfunduan pyetjet, po jo seancat. T'i kërkojmë, po që atëherë t'i falenderojmë dhe t'i kërkojmë në qoftë se s'ka pyetje të tjera. Ju kërkoj ndjesë, unë po prisja për Tiranën, se ju kërkoj ndjesë. Atëherë, shumë faleminderit kryetarëve. Futin dhe për gjithë kohën dhe për durimin.

Luçiano Boçi:

Po, faleminderit për gjithçka.

Jorida Tabaku:

Për pabarazinë që krijoi reforma e shkuar territoriale nga periferia në qendër, për mënyrën se si ndikoi në shërbime, për faktin që sot 70% e të gjithë investimeve janë të përqendruara në qendrën urbane, ndërkohë që qytetarët e të gjithë ish-komunave janë pothuajse pas një shërbimi. Zyrtarisht, zoti Mazniku, zoti Boçi, ju kam nisur një propozim për dëgjesa për katër-pesë dëgjesa për ish-komunat, dhe kemi nevojë që ne të kemi një diskutim për Tiranën. Kemi nevojë për të pasur një diskutim për qendrën më të madhe urbane të vendit. Kemi nevojë për të pasur një diskutim se si taksa e arsimit që u krijua si një taksë e përkohshme është kthyer në një taksë përhershme. A ia vlejti kjo? A u ndërtuan më shumë shkolla? Kemi nevojë për të diskutuar për shumë elementë për qytetin e Tiranës, dhe ne nuk mund ta emohoni këtë debat. Nuk mund t'ia mohoni as qytetarëve. Kështu që, zoti Mazniku, edhe njëherë unë përsëris kërkesën për të bërë një dëgjese me kryetaren e bashkisë së Tiranës, të deleguar, të komanduar, quajeni si doni, në qoftë se zonja nuk di ta bëjë atë punë, ta lërë, mos ta mbajë peng. Po, kjo gjëja që ta mbajnë peng bashkinë e Tiranës, sepse i qeverisi një njeri i vetëm që jep lejet e ndërtimit, që jep lejet e inceneratorëve dhe që bën çdo gjë, për mua është pa logjikë. Sot, qytetarët e Tiranës, prej vitesh, dhe jo mbasi kryetari i bashkisë ka shkuar përpara drejtësisë, por prej vitesh janë të paqeverisur. Nuk kanë një administrator të qytetit. Tirana është konsideruar si një vend ku ipen leje ndërtimi, është kthyer në një fjetore të madhe e merret ajo taksa e ndikimit në infrastrukturë. Kemi nevojë që të kemi një diskutim edhe për impaktin për ish-komunat që unë përmenda, sepse kanë një aktivitet ekonomik, kanë qytetarë që jetojnë atje, kanë nevojë për t'u qeverisur. Dhe ato, ju keni shëtitur atje, unë kam shkuar atje, jemi të gjithë njerëz që jemi përballur me nevojat që kanë ish-komunat. Kështu që, zoti Mazniku, edhe njëherë, për mua, ne jemi duke i lënë mangut këtij komisioni një të tretës së popullsisë së vendit llogaridhënien për atë që ndodhi me reformën territoriale të 10 viteve më parë. Si mund ta bëjmë Tiranën më të mirë? Si mund të përpiqemi që t'i tërheqim potencialin edhe kulturor edhe turistik që ajo ka? Si mundemi që ta konceptojmë atë policentrike, ashtu siç shumë kryetarë bashkisë që kanë ikur e kanë ardhur, kanë premtuar me kohë? Dhe si mundemi që ta bëjmë këtë qytet të jetueshëm në fund të ditës? Unë jam borxhlije e qytetarëve të Tiranës, sepse më kanë votuar kësaj radhe më shumë se çdo herë tjetër. Ju besoj jeni borxhlije se keni qenë atje zëvendëskryetar bashkie, por kjo përtej llogarive tona elektorale dhe personale ka edhe një farë llogarie, edhe si shërbyes publik, se ne shërbyes publik jemi në fund të ditës. Ne e kemi të nevojshme të diskutojmë për Tiranën. Nuk mund të fshihet as zonja, nuk mund të fshihet as Partia Socialiste, nuk mund të fshihet askush përpara faktit që sot këtu nuk vijnë dhe nuk është bashkia e vetme që nuk vjen. Edhe Elbasani e sfidoi këtë komision, edhe Shkodra e sfidoi këtë komision, dhe kryetarja e bashkisë së Vlorës e sfidoi këtë komision. Dy kryetarë bashkish, ndërkohë që ne ishim këtu si deputetë, u larguan. Besoj që minimumi i respektit, edhe si koleg të forcave të ndryshme politike, po të bashkëjetesës që kemi këtu në parlament, duhet të ekzistonte. Zoti Mazniku, pyetjet ne i kemi përgatitur që nga shërbimi me ujë për të dhënat financiare të bashkisë së Tiranës, për administrimin dhe menaxhimin, deri tek shërbimet. Është mos të ndalem pastaj te çështja e inceneratorit, se ndoshta jeni lodhur dhe ju me mua që flas për vite me radhë me atë çështje, por është e nevojshme që parlamenti i

Shqipërisë t'i marri, t'i thresi, duke nisur nga bashkia e Tiranës, por edhe këto të tjerët që i kanë sfiduar komisionin, që të vijjnë dhe të raportojnë këtu. Ne nuk po e kryejmë këtë ushtrim për të mbyllur sytë. Nuk e besoj dhe juve, edhe zoti Boçi, e kryeni këtë ushtrim që të mbyllim sytë dhe hajde bëjmë vizatojmë një hartë të re. Po duhet ta dinë qytetarët e Tiranës se si ai zallbastari të zallherit që janë aq larg që do dy orë për të shkuar, shkon më herët në Durrës, janë bashkuar bashkisë së Tiranës. Njëra prej tyre nuk lidhet fizikisht me territorin e Tiranës dhe është pjesë e qarkut të Tiranës. Kryetari i bashkisë së Kavajës erdhi këtu për të folur për vështirësitë dhe ne e kthym mbrapsht kryetarin e bashkisë së Kavajës, sepse nuk kishin kryetarët e tjerë të qarqeve. Tani, unë e kuptoj e mirëkuptoj shumë edhe ngarkesën tuaj, sepse ju, ndryshe nga të gjithë të tjerët, i keni ndjekur të gjitha takimet, por kjo reformë është e paplotë në qoftë se kjo ndodh pa dëgjuar Tiranën dhe pa diskutuar për Tiranën, pa bërë dëgjesa dhe nëpër komuna, me një propozim që ka një muaj që ja kam dorëzuar zyrtarisht dy bashkëkryetarëve dhe që pres që neve ta zbatojmë. Unë ja kam borxh qytetarëve të Tiranës. Ne, si forcë politike, ja kemi borxh qytetarëve të Tiranës. Besoj që është momenti, kemi kohë për ta organizuar. Ne pyetjet i kemi këtu në çdo moment. Jemi gati kushdo që të vijë nga bashkia e Tiranës, qoftë edhe juve, në qoftë se juve mendoni që mund t'i përgjigjeni këtyre pyetjeve, ja bëjmë juve. Po dikush të vijë këtu, dikush të vijë edhe të flasi, se nuk mund të jetë bashkia e Tiranës vetëm për të dhënë leje ndërtimi, edhe për të punësuar njerëz. Bashkia e Tiranës është bashkia më e madhe në vend dhe duhet patjetër, patjetër që këtu të vijë dikush që të na raportojë se çfarë po ndodh. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Atëherë, faleminderit zonja Tabaku, meqënëse zoti Mazniku s'kishte një përgjigje. Jo, kam, kam, po e hap mikrofonin. Po, po, sigurisht, domethënë kam përgjigje. Ti s'ke lutuar, domethënë, ta tolerosh këtë gjë dhe tani po të bën përshtypje. Edhe vazhdo, por ose përgjigje kam. Jo, se ke qejf gjithmonë ta marrësh ti fjalën e parë dhe pastaj edhe të duket çuditshme. Mos më duk fare çuditshëm. Fjalën vazhdo. Në këtë rast, po zonja Tabaku, keni shumë të drejtë. Domethënë, kjo mënyrë sjellje që unë e kam cilësuar arrogante, mos përkthyes nga ana e disa kryetarëve të bashkive, ëh, kulmon me mosardhjen e përfaqësueses së bashkisë së Tiranës. Dhe ne duhet patjetër që të përfundojmë të gjitha dëgjesat me të gjitha bashkitë, për të vijuar më pas edhe me pjesën tjetër të mbetur të axhendës së komisionit për dëgjesat që janë planifikuar që në fillim. Kështu që unë propozoj që, pa përfunduar dëgjesat me kryetarët e bashkive, ne s'mund të vijojmë me dëgjesat, qoftë karakterit tematik apo të natyrave tjera. Në raport me propozimin tuaj, ëh, ne do t'i bëjmë dëgjesat sipas edhe vendimit të komisionit përbashkët në terren, në të gjitha njësitë administrative që dikur kanë qenë edhe komuna dhe të mëdha biles, dhe të marrim mendimin bruto të qytetarëve. Madje, propozimi im është që ne të fillojmë me dëgjesat në publik nga Tirana dhe jo Tiranën ta lëmë në fund, sepse është e vërtetë, është një e treta e popullsisë. Ndeshmëria është e publikut më e madhe dhe interesi ynë si komision i përafrohet kësaj ndeshmërie dhe ajo është, edhe interesi ynë është i madh në këtë rast. Dhe për mungesat e tjera apo për ikjet e kryetarëve të bashkive, kjo është hera e parë që na ndodh. Vetëm me Vlorën na ndodhi që kryetarët e bashkive largohen kur seanca dëgjimore nuk ka përfunduar. Edhe zoti Tavo është larguar dhe zoti Çaçi është

larguar. Ndërsa mungesat e përsëritura të mos mendojnë që do ja na shkalojnë, meqënëse që e ka set dëshirash e kryetarëve të bashkive. Jo, është detyrim parlamentar. Duhet të vijë para këtij komisioni dhe t'i përgjigjen interesit të komisionit, por edhe pyetjes së pyetjeve të deputetëve. Tiranën ta skedulojmë dhe njëherë. Të kërkojmë javës që vjen një seancë dëgjimore në mënyrë të posaçme për Tiranën dhe t'ia kushtojmë gjithë ditën sa të zgjasi dëgjesa, mendoj, Tiranës, pikërisht për këtë rëndësi që ka. Kryetarja në detyrë mund të vijë edhe bashkë me zëvendës, zëvendësit e saj dhe të përgjigjen për të gjitha ato pyetje që ne do të parashtrijmë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Atëherë, t'i përgjigjem unë, zonjë Tabaku. Ëh, unë jam dakord me parashtrimin tuaj në raport me, ëh, nevojën që ne të dëgjojmë dhe Tiranën. Ëh, besoj se një reformë territoriale administrative, ëh, do ishte e paklotë nëse dhe Tirana s'do kishte mundësi t'i thoshte zërin e saj. Një nga arsyet pse vendosëm ta shtyjmë bashkë me bashkëkryetarin takimin është sepse përveç Tiranës nuk kishim sot as Kamzën, çka bënte që nga qarku të kishim vetëm Kavajën dhe Vlorën. Do të ishte shumë e udhës që Tirana të kishte një dëgjese të qëndrueshme si të gjithë të tjerat. Unë jam gjithashtu dakord me faktin që dhe kam shprehur në mënyrë sistematike që kryetarët e bashkive që nuk kanë pasur mundësi të jenë prezentë për arsye të caktuara të ftohen në një dëgjese tjetër të posaçme, të jenë dhe të thonë mendimin e tyre në raport me reformën, në mënyrë që të kemi mundësi ta strukturojmë. Kam thënë gjithashtu dhe mendoj që ne duhet të thërrasim në mënyrë formale në një dëgjese të posaçme, ëh, përveç kryetarëve të bashkive, siç i keni thirrur në rolin e kryetarëve të bashkive respektive, do të thërrasim shoqatën e bashkive dhe, ëh, një përfaqësi të bashkive që të vijë në formë shoqate dhe të sjellin këtu shqetësimet e shoqatës të unifikuara, jo, ëh, Elbasanit vetat, ëh, Konispolit vetat. Me të drejtë se këto pjesë i dëgjuam, por të kenë dhe një moment ku bashkitë, në mënyrë të unifikuar, sjellin shqetësimet e të koordinuarat të bashkive. Përsa i përket Tiranës, ëh, unë mendoj që ne duhet të thërrasim në dëgjese kryetarin e bashkisë së Tiranës. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka marrë një vendim për këtë çështje, e cila ka thënë që kryetari i bashkisë është në kryetar bashkie dhe t'i drejtohem institucioneve përkatëse, t'i kërkojmë kryetarit të bashkisë që të vijë dhe të thotë mendimin e tij këtu dhe në vend që të hyjmë në diskutimet që mund të flasë ai ky apo ai, t'i kërkojmë kryetarit të bashkisë së Tiranës, i cili, si në përputhje me vendimin e gjykatës kushtetuese, është kryetar i bashkisë së Tiranës, të vijë dhe të thotë shqetësimet e shqetësimet, mendimet, diskutimet, dhe ta bëjmë diskutimin me kryetarin e zgjedhur të bashkisë së Tiranës, ëh, i cili, si gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Shqipërisë, gëzon të drejtën e prezumimit të pafajësisë, ëh, deri në një moment ku ka një vendim gjykate. Kështu që për këtë arsye, unë besoj që gjëja që bën sens për të bërë për këtë komision është që, në vend që të ngrejmë kasus si ky apo ai, të thërrasim kryetarin e bashkisë së Tiranës.

Jorida Tabaku:

Zoti Mazniku, unë nuk kam asnjë problem të përballim me zotin Veliaj. Ju e dini shumë mirë historikun e përballjes time me zotin Veliaj për orë të gjata në shumë debate të

ndryshme që kanë kulmuar me komisionin hetimor të inceneratorëve. Unë kam përshtypjen që po na fusni në një ngërç për të mos ta bërë debatin, sepse nuk është në dorën tonë vjen apo jo këtu zoti Veliaj. Ne duam të përballemi me dikë. Po le të vijë dhe vetë Edi Rama po deshi, se ai sot e drejton bashkinë e Tiranës. Ai i thretë pas rusit në takim. Po le të vijë dhe Olgerta Tamana Sëliu, që pa u zgjedhur kryetar i bashkisë, e thretë drejtorët. Po dikush le të vijë. Nuk mundet që të lëmë pa debat një të tretën e Tiranës. Por ka një zonjë që sot e ka të deleguar këtë kompetencë. Ne nuk po themi nuk është kryetar bashkie Erion Veliaj, nuk është kryetar bashkie Arbër Mazniku, nuk është Anuela Aristani. Ne po themi që sot ja keni deleguar kompetencat dhe detyrat asaj zonjës atje. Dikush duhet të vijë dhe të raportojë këtu. Mos më thuaj që në një të tretën e popullsisë së Tiranës nuk paska një përgjegjës. Po të jap unë katër emra që sot marrin vendimet për Tiranën. Katër emra po të jap unë. Po dikush duhet të vijë. Nuk mund ta lëmë dot pas një debati një të tretën e popullsisë së Tiranës.

Arbjan Mazniku:

Jam dakord me këtë.

Klevis Jahaj:

Po, ëh, në fakt, edhe ne ishim dakord kur në dëgjesat që ishin thirrur dhe për qarqet kishte përfaqësues si në kryetar bashkie për shkak të angazhimeve që kishin kryetarët e bashkive dhe me dakordësi të komisionit nuk është pranuar që të kryejë dëgjesa derisa të ishte e mundur që kryetari i bashkisë të ishte disponibël për të kryer dhe për të dhënë fjalën e vet. Kështu që besoj që edhe arsytimi i dhënë në lidhje dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me Tiranën, por edhe me mundësinë për t'i dhënë edhe kryetarëve të tjerë të bashkive që mund të kenë një hapësirë më vete për të dëgjuar edhe shprehur opinionet e tyre, patjetër që mund të jenë këtu. Dhe besoj që ky standard që kemi krijuar, patjetër që duhet ta kemi dhe për Tiranën dhe përkundrazi për Tiranën, që është bashkia kryesore, e cila është ajo të cilën përcakton dhe thelbin e të gjithë reformës administrative territoriale dhe prek numrin më të madh të popullsisë që kemi në territorin e vendit tonë. Kështu që diskutimi është i tillë dhe ne duhet të mbajmë të njëjtin qëndrim dhe nuk mund të bëjmë për Tiranën një zgjedhje tjetër, për një bashki një zgjedhje tjetër, apo jo? Këtu kemi qenë edhe me bashkëkryetarin kur kemi ngritur ose nuk i kemi lënë fjalën personave të tjerë që përfaqësonin bashkitë si të Gjirokastrës e të gjitha me radhë, që mos merrnin pjesë në komision, sepse nuk duhet dhe nuk është kryetari i bashkisë. Kështu që në këto kushte nuk shoh ndonjë çudi në lidhje me këtë.

Luçiano Boçi:

Tani, ëh, tani nuk është se ka një refuzim nga ana e zonjës Tabaku apo nga ana ime si bashkëkryetare për të pasur një debat në lidhje me reformën. Po pra, ose dëgjes, po debat ose dëgjes, nuk ka rëndësi. Por fakti që ju i vendosët në pjesë të barabarta nënkryetarët me të emëruarën zyrtare të bashkisë së Tiranës nuk shkon, se nuk janë të barabarta. Një nënkryetar është nënkryetar. Zonja në fjalë nuk është nënkryetare, por është e komanduar në postin e drejtueses së bashkisë dhe madje ka një, ka një kohë të gjatë, ka një kohë të

gjatë që e ushtron këtë lloj detyre. Ndërsa zoti Veliaj ka një kohë po kaq të gjatë, po kaq të gjatë që nuk e drejton bashkinë e Tiranës. Dhe shqetësimi i zonjës Tabaku është shumë i drejtë. Domethënë, futet në ngërç komisioni. Do presim ne të hyjmë në kalenda gjykatash, lejesh, ditësh dhe se do shtyhet në pafundësi, se po themi që pa mbaruar dhe kështu e kemi vendosur e s'mund të dalim mbi vendimin e komisionit që do mbarojmë dëgjesat me kryetarët e bashkive dhe do vijojmë me dëgjesat tematike dhe dëgjesat e komuniteteve sipas kërkesës së tyre. Pra, në qoftë se ne vazhdojmë të insistojmë që duhet kjo edhe nuk realizohet, komisioni shtyn pafund punën e tij. Ndërkohë që ishit ju që keni ngjallur debatin e kohës së mbarimit të punës së komisionit. Keni vendosur një kufi, madje na keni quajtur dhe sabotatorë për atë pjesën e kërkesave që kishim, që në fakt u realizuan në një pjesë të madhe të tyre dhe duhet të realizohen, sepse i shërbejnë kësaj dëgjese dhe ndërkohë jeni po ju që e fusni komisionin në një ngërç kohor, sepse zgjatet pafundësisht në mënyrë artificiale. Ndërkohë themi që duam problemet, duam dëgjesat, duam të marrim sa më shumë opinione nga drejtuesit e bashkive. Ja ku është rasti që ne ta realizojmë një gjë të tillë, pa pasur thashë asnjë lloj objeksioni ndaj mundësisë që të vijë, të jetë dhe paraqitet pranë komisionit. Për këtë se kemi në dorë ne. Është drejtësia ajo që e ka vendosur edhe është atje ku është.

Arbjan Mazniku:

Po bëjmë politika të panevojshme. Jemi të gjithë dakord që duhet, jemi të gjithë dakord që dëgjesa me Tiranën duhet të kryhet. Ëh, dhe besoj që jemi të gjithashtu të gjithë dakord që të dëgjojmë, nëse është e mundur nga institucionet përkatëse, ëh, kryetarin e zgjedhur të bashkisë së Tiranës. Kështu që vijojmë, tentojmë këtë, më pas pastaj të shohim zgjedhjet e tjera. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Tek një sqarim, tek dëgjesat me shoqatat e bashkive, besoj do jenë të dyja shoqatat dhe ajo e bashkive të majta dhe ajo e bashkive të djathta.

Arbjan Mazniku:

Shoqatat janë bashkuar.

Luçiano Boçi:

Nuk, jo, jo, nuk janë të bashkuara shoqatat. Bashkitë e djathta kanë shoqatën e tyre, ndërsa bashkitë e majta kanë shoqatën e tyre. Kështu që ato do i thërrasim, se s'mundet. Po, po, edhe ftesa vjen për të dyja shoqatat. Nuk janë bashkuar. Ne do i thërrasim në mënyrë të ndarë nga njëri-tjetri dhe të jenë pjesë e dëgjesave. I presim me shumë kënaqësi. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit.